



DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE

Raport nga hulumtimi

DISKRIMINIMI
NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE
RAPORT NGA HULUMTIMI

Shkup, dhjetor, viti 2010

Publikimi: Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike

Person përgjegjës: Zhaneta Poposka

Autorë: Aleksandar Kërzhhalovski, Elena Andreevska, Veton Latifi, Rexhep Ali Çupi, Mabera Kamberi, Vlladimir Misev

Mbështetje ekipit të autorëve: Bekim Kadriu, Gramoz Shabani, Emill Mahmutoviq (MCMS)

Perktheu: Tairi Neihim, Ermira Kuclar

Redakoti: Edita Jashari

Disenji, redaktimi dhe botoi: Polyesterday, Shkup

Tirazhi: 150 kopje

CIP – Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.647.82-054(497.7)“2010”(047.31)

342.724(497.7) “2010”(047.31)

DISKRIMINIMI në bazë të përkatësisë etnike : raport nga hulumtimi / Aleksandar Kërzhhalovski ... [и др.]; perktheu: Tairi Neihim, Ermira Kuclar]. - Shkup : OSCE, 2010. – 98 стр. : табели ; 21 см

Превод на делото: Дискриминација по основ на етничка припадност : извештај од истражување / Александар Кржаловски ... [и др.]. – фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 96-98

ISBN 978-608-4630-19-7

1. Krzalovski, Aleksandar [автор]

а) Дискриминација брз етничка основа – Македонија – 2010 - Истражувања COBISS.MK-ID 86332170

Ky publikim u përpilua nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) me përkrahje financiare të OSBE-së dhe me bashkëpunim me Sekretariatin për Implementim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIMKO) pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Botues:



Përmbytja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Resyme	7
Metodologjia.....	12
1. RREGULLATIVA LIGJORE MBI KUNDËR-DISKRIMINIMIN	17
1.1. Instrumentet juridike ndërkombëtare	20
1.2. Dispozitat kushtetuese dhe dispozitat tjera elementare	24
1.3. Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi	25
1.4. Ligje të posaçme që përmbajnë dispozita për kundër-diskriminimin ..	27
1.5. Institucionet për mbrojtje nga diskriminimi.....	29
1.6. Sjellja e zyrtarëve.....	31
1.7. Përfundime dhe rekomandime për rregullativën ligjore	31
2. DISKRIMINIMI NË SFERA TË NDRYSHME.....	35
2.1. Gjatë punësimeve.....	38
2.2. Në Arsim	49
2.3. Mallrat dhe shërbimet	65
2.4. Mbrojtja sociale dhe shëndetësia	70
2.5. Mediumet	89
3. ASPEKTE TJERA TË DISKRIMINIMIT	105
3.1. Bashkësitë më të vogla etnike.....	105
3.2. Diskriminimi fetar.....	111
3.3. Diskriminimi i shumëfishtë	114
3.4. Përfundime dhe rekomandime nga ndalimi i diskriminimit	115
3.5. Përfundime dhe rekomandime	116
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	119

Shtojca125

1. Anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës	125
2. Shqyrtimi i personave të intervistuar	126
3. Llojet e mbrojtjes sociale	127
4. Pyetësi për sondazh të shfrytëzuesve të ndihmës sociale.....	129
5. Pyetësor për intervista me aktorë relevant në sferën sociale.....	131
6. Pyetësor për sondazh të popullatës mbi diskriminimin etnik.....	132
7. Pyetësor për anketë me përfaqësuesit/redaktorët e medimeve.....	138
8. Pyetësor për drejtorët/arsimtarët dhe prindërit e fëmijëve në shkolla ..	139
9. Pasqyrë e të punësuarve në administratën shtetërore sipas përkatësisë etnike	143

Lista e shkurtesave	146
----------------------------------	------------

Bibliografia	147
---------------------------	------------

PARATHËNIE

Të nderuar,

Ua prezantojmë hulumtimin “Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike”, të cilin e realizoi Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në kuadër të Projektit të përbashkët të Misionit Vëzhgues të OSBE-së dhe Sekretariatit për Implementim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Pas miratimit të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi në prill të këtij viti dhe në pritje të përvjetorit të dhjetë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ky hulumtim ka për qëllim të jep një pasqyrë të thellë mbi diskriminimin më të përfaqësuar në Maqedoni – në bazë të përkatësisë etnike.

Përmes aplikimit të metodave të ndryshme (sondazheve, analizave të të dhënave statistikore, intervistave, ndjekjeve të artikujve të mediave, etj), një grup nga pesë ekspertësh me përvojë të ndryshme profesionale, si dhe me përkatësi të ndryshme etnike, tentoi të bënte një analizë të gjendjes në disa sfera në të cilat mendohet të jetë i pranishëm ky lloj diskriminimi – punësimet, arsimi, mallrat dhe shërbimet, mbrojtja sociale dhe mediat.

Si tentim i parë për një analizë të këtillë, dhe duke pasur parasysh edhe numrin e ulët të rasteve të paraqitura lidhur me diskriminimin, ekipi hulumtues u ballafaqua me mungesë të madhe në të dhënat dhe statistikatat relevante për një vlerësim më të qëndrueshëm të gjendjes. Prandaj, ambicja e këtij dokumenti është përcaktimi i realiteteve nga aspekti i të dhënave të disponueshme, komentimi i dukurive të rastësishme për të cilat ka ekzistuar perceptimi në opinion, për diskriminim në baza etnike dhe nxjerrja në pah të fushave të mundshme për diskriminim të mundshëm, të cilave duhet kushtuar vëmendje në të ardhmen.

Shpresojmë se ky hulumtim po hap një hapësirë të re dhe jep kornizë për një ndjekje më sistematike të dukurisë së diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike.

Aleksandar Kërzhallovski
Koordinator i Ekipit të Autorëve

RESYME

Ky publikim e hulumton **gjendjen e diskriminimit në Republikën e Maqedonisë në bazë të përkatësisë etnike**. Hulumtimi, përkatësisht analiza e gjendjes, është kryer në gjysmën e dytë të vitit 2010, MCMS-ja, me iniciativë të OSBE-së, kurse me mbështetje edhe nga Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIMKO).

Sfidë që të hulumtohet diskriminimi etnik, ishte perceptimi mbi praninë e saj të gjerë në shoqëri, implementimi dhjetëvjeçar i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit – si një lloj strategjie i Republikës së Maqedonisë për ballafaqim edhe me këtë lloj të diskriminimit, si dhe rrumbullakësimi i rregullativës ligjore dhe vendosjes institucionale në këtë vit.

Arsyetimi për një hulumtim të këtillë u vërtetua, sepse përqindja më e madhe e rasteve të paraqitura ka të bëjë pikërisht me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, por edhe për qytetarët e anketuar pas përkatësisë partiake, kjo është baza më e shpeshtë e diskriminimit (67%) dhe mendojnë se është shpeshtuar në raport me vitin e kaluar. Në vazhdim, janë identifikuar më se 200 artikuj në media, të cilat mund të klasifikohen në të njëjtin grup. Këto tre burime (rastet, anketa, mediumet), si dhe hulumtimet paraprake në tema të ngjashme ishin bazë për analizën e përmbajtur në këtë publikim.

Duke marrë parasysh se ky është përpjekje e parë për këtë lloj analize të diskriminimit etnik, ekipi hulumtues u ballafaqua me **mungesë të dhënave dhe statistika relevante** për vlerësim më të qëndrueshëm të gjendjes. Kjo kryesisht ka të bëjë me numrin e vogël të rasteve të paraqitura – asnjë nga gjykatat, ndërsa vetëm 50 raste për tre vjet te Avokati i Popullit, prej të cilave në 25% është vërtetuar diskriminimi. Kjo duhet të merret parasysh gjatë komentimit të rezultateve nga hulumtimi dhe përgjithësimi i konstatimeve dhe përfundimeve të caktuara.

Për realizimin e hulumtimit, u shfrytëzua një **metodologji** e cila kombinonte: shqyrtimin e literaturës/dokumenteve, sondazheve (opinionit publik i përgjithshëm dhe faktorët relevantë), dhe ilustrimin e rasteve.

Nga hulumtimi mund të veçohen **përfundimet e përgjithshme** në vijim:

- 1.1. Marrëveshja Kornizë e Ohrit shërbeu si një **Strategji e Republikës së Maqedonisë për marrëdhënie ndëretnike**, gjegjësisht çështja e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike kontribuoi në përmirësimin e gjendjes në këtë çështje;
- 1.2. përveç ndërlidhjes me MKO dhe përfaqësimit të drejtë, **vetëdija për ekzistimin e diskriminimit është në nivel shumë të ulët**;
- 1.3. **ekziston një numër i ulët i rasteve të paraqitura për diskriminim** – nuk ka asnjë nëpër gjykatat, kurse janë evidentuar gjithsej 47 raste te Avokati i Popullit. Edhe në anketat, 20% të anketuarve kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. **Baza më e shpeshtë për diskriminim është pikërisht përkatësia etnike, kurse sfera më e shpeshtë – punësimi.** Shumë më i ulët është numri i rasteve të konstatuara të diskriminimit – 25% nga rastet e paraqitura;
- 1.4. **nuk ekziston një evidence e mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse për përkatësinë etnike** të shfrytëzuesve të disa benefiteve shoqërore, gjë kjo e cila e vështirëson analizën e gjendjes. Problem plotësues lidhur me evidencën është çështja e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e së drejtës për mosdeklarim të përkatësisë etnike;
- 1.5. **në Maqedoni nuk vërehet diskriminim nga sistemi** (është arritur numri i punësimeve në 25% të bashkësive joshumicë etnike në administratën shtetërore; arsimim në gjuhën amtare për të gjithë bashkësitë; subvencione në bujqësi; dominim të bashkësive për nga shfrytëzimi i ndihmës sociale);
- 1.6. **ekzistojnë raste diskriminimi**, shpeshherë në bazë të përkatësisë etnike edhe në sektorin publik por edhe në sektorin privat ka tendencë rritjeje. Ka potencial edhe për diskriminim drejtpërdrejtë, sidomos në projektet e mëdha qeveritare (subvencione, banesa sociale, etj).
- 1.7. Ka edhe potencial për diskriminim indirekt, veçanërisht në projektet më të mëdha (subvencione, banesa sociale etj.) ku edhe pse sigurohet përfaqësim i barabartë, grupet thellë të marginalizuara (p.sh. romët) nuk kanë mundësi të barabarta për plotësimin e kushteve.

Sipas **sferave** të hulumtimit, përfundimet kryesore janë:

- 2.1. **Punësimi:** Paraqet sferën më e shpesh të diskriminimit, mirëpo në masë të konsiderueshme është përmirësuar përfaqësimi i bashkësive etnike në administratën shtetërore (në vitin 2009, arriti nivelin nga 25%) Ekziston perceptim (47%) në favorizimin e disa bashkësive etnike gjatë punësimit (veçanërisht në sektorin publik), ndërsa shumica e madhe (81%) nuk e arsyetojnë këtë;
- 2.2. **Arsimi:** U mundësua qasje e barabartë në arsimim për të gjithë bashkësitë. Ekzistojnë lëshime në realizimin (mungesa e librave për disa bashkësi). Është e pranishme tendenca e ndarjes të nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike (duke përfshirë këtu dhe disa nga intervenimet e MASH-it).
- 2.3. **Mallrat dhe shërbimet:** Ekzistojnë shumë shembuj në media dhe sidomos në sektorin privat, por nuk krijohet përshtypje për diskriminim sistematik (p.sh. shfrytëzues nga të gjithë bashkësitë të projekteve më të mëdha shtetërore, siç janë subvencionet në bujqësi). Ka potencial dhe për diskrimin të tërthortë;
- 2.4. **Mbrojtja sociale dhe shëndetësia:** 70% të shfrytëzuesve janë nga bashkësitë etnike jo shumicë. Gratë që u takojnë bashkësive pakicë shpeshherë janë të lëndueshme ndaj varfërisë dhe mospërfshirjes sociale. Në përgjithësi, Romët kanë qasje më të vështirë në shërbimet shëndetësore;
- 2.5. **Medumet:** Shumica e redaksive janë “etnikisht të pastra”, gjë kjo që ndikon në politikën redaktuese, në shkallën e mbylljes dhe ksenofobisë ndaj bashkësive tjera. Prapeseprap ekziston senzibiliteti i caktuar për këtë çështje dhe ballafaqimi relativisht imirë gjatë lajmërimeve.

Në mënyrë plotësuese, janë hulumtuar edhe **rregullativa ligjore dhe disa aspekte specifike** të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike:

- 3.1. **Rregullativa ligjore: Ekziston mbrojtja e mirë nga diskriminimi në legjislacion dhe në strukturën institucionale.** Prioritet për periudhën e ardhshme është implementimi i Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe themelimi dhe funksionimi dhe Komisioni efikas për Mbrojtje nga Diskriminimi, përkundër ndryshimeve të reja në rregullativën ligjore;
- 3.2. **Aspektet specifike: Romët edhe më tej janë bashkësia etnike më e marginalizuar dhe më e diskriminuar në Maqedoni.** Bashkësitë më të vogla etnike gjithashtu duhet të përfitojnë më shumë hapësirë dhe mundësi për realizimin e të drejtave të tyre dhe zhvillimin e bashkësisë së vet.

- 3.3 **Përputhshmëria e madhe e religjionit me përkatësinë etnike** aq më tepër ndikon në perceptimin e diskriminimit, duke favorizuar religjionet shumicë.
- 3.4 Republika e Maqedonisë, me ndihmën e MKO-së dhe **mekanizmave tjerë ka aplikuar një sistem të masave afirmative për arritjen e barazisë faktike** të bashkësive etnike (duke përfshirë këtu dhe përfaqësimin e drejtë në administratën shtetërore), të cilat në thelb janë përjashtime nga diskriminimi dhe si të tilla duhet të zbatohen deri në momentin e arritjes së baraspeshës përkatëse.

Në pajtim me këtë, autorët veçojnë disa **rekomandime**:

- 4.1. **Nevojitet analizë gjithëpërfshirëse të implementimit të MKO-së** gjatë dhjetë viteve të fundit, që nga nënshkrimi i saj, si bazë për formulimin e aktiviteteve në sferën e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike në periudhën e ardhshme afatmesme;
- 4.2. Përqendrimi në **aftësimin dhe funksionimin efikas të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi**, i cili duhet të funksionojë në drejtim të avancimit të barazisë dhe çështjes së jo diskriminimit, nxitjen e paraqitjes së rasteve të diskriminimit (dhe zgjidhjen e tyre), trajnim të institucioneve tjera për ballafaqim me këtë çështje, si pjesë përbërëse e Strategjisë Nacionale për jo diskriminim, kurse në fazën vijuese të propozohen ndryshime të rregullativës ligjore;
- 4.3. Nevojitet që edhe më tej të bëhet **inkurajimi për paraqitje të rasteve të diskriminimit** (edhe nga organizatat qytetare, por dhe nga institucionet kompetente), si dhe përmirësimi i evidencës mbi përkatësinë etnike (me mbrojtje përkatëse të të dhënave personale), duke përfshirë këtu dhe aspektin cilësor (p.sh. nivelin e funksioneve udhëheqëse gjatë punësimit);
- 4.4. **Masat aktuale pohuese (p.sh. përfaqësimi i drejtë) duhet të vazhdojnë** të aplikohen deri në arritjen e një baraspeshë të mjaftueshme të barazisë faktike të bashkësive etnike (duke përfshirë edhe funksionet udhëheqëse), dhe pastaj (si përjashtime nga diskriminimi) ato duhet të revokohen;
- 4.5. **Ndarja e pranishme nëpër shkollat duhet të tejkalohe**t, sidomos me realizimin e Strategjisë së sapa miratuar për arsim të integruar;
- 4.6. Në projektet më të mëdha, **duhet të bëhet një vlerësim paraprak për diskriminim të mundshëm indirekt**;
- 4.1. **Sfidë për mediumet është të qasin tek anëtarët e bashkësive tjera etnike** si publikë heterogjene;

- 4.8. Në gjysmën e kohës së paraparë për zbatimin e Dekadës së Romëve, ndërsa duke patur parasysh rezultatet e deritanishme, **duhet të dyfishohen përpjekjet për inkuadrim social të kësaj bashkësie etnike në shoqëri** (posaçërisht në arsim, punësim, banim dhe shëndetësi). Vëmendje e posaçme duhet t'u kushtohet dhe bashkësive më të vogla etnike. Ngjashëm me bashkësitë fetare, ku plotësueshëm – primar duhet të jetë parimi i sekularitetit, gjegjësisht shteti duhet t'i shmanget përkrahjes direkte të aktiviteteve fetare (duke përfshirë këtu edhe ndërtimin e godinave), si dhe nga inkuadrimi i personave fetarë vetëm të religjioneve shumicë në aktivitetet e tij.

METODOLOGJIA

HYRJE

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), në kuadër të Projektit të OSBE-së, dhe në bashkëpunim me Sekretariatit për Implementim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIMKO), në gjysmën e dytë të vitit 2010 realizoi një hulumtim mbi gjendjen me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Hulumtimin e realizoi një ekip nga pesë ekspertë të pavarur dhe një Koordinator i MCMS-së.

Ekipi u përbë nga: Aleksandar Kërzhalovski (MCMS, Koordinator i hulumtimit dhe autor i lëmi *Mallra dhe Shërbime* dhe një pjesë të kapitullit *Aspekte tjera të Diskriminimit*), Elena Andreevska (autore e Kapitullit *Rregullativat ligjore*), Veton Latifi (lëmi *Punësimi*), Rexhep Ali Çupi (Kapitulli *Arsimi* dhe lëmi *Bashkësitë më të vogla etnike*), Mabera Kamberi (Kapitulli *Mbrojtja sociale*), Vladimir Misev (pjesën e *Mediave dhe të diskriminimit fetar*). Autorët kishin përkrahje plotësuese edhe nga ekipi operativ i MCMS-së.

Për zbatimin e hulumtimit, u shfrytëzua një metodologji e cila kombinonte: shqyrtim të literaturës/dokumenteve, sondazhe (opinionit i gjerë dhe faktorët relevant), si dhe ilustrimi i rasteve. Realizimin e mbikëqyrte Komiteti Këshilldhënës (shihni shtojcën 1).

AKTIVITETET

a) Shqyrtimi i literaturës / dokumenteve

Në fazën e parë të hulumtimit, ekipi i ekspertëve me përkrahje të ekipit operativ të MCMS-së, bëri shqyrtim të literaturës që kishte të bëjë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, duke përfshirë këtu edhe hulumtime paraprake në këtë temë, si dhe baza të të dhënave në institucionet relevante, si SIMKO, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe MASH-i. Për përpilimin e

këtij hulumtimi u konsultuan edhe organizatat qytetare të cilat e ndjekin çështjen e diskriminimit dhe faktorët tjerë relevant.

Gjithashtu, me ndihmën e kërkimit në internet (përmes www.time.mk, me fjalën kyçe “diskriminim”) u bë shqyrtimi i informacioneve relevante të mediave (tituj, artikuj, raste të ndjekura), të shpallura në mediat e shtypura dhe ato elektronike gjatë tre viteve të fundit.

b) Sondazhi i popullatës

Duke patur parasysh informacionet e pakta për këtë çështje, u bë sondazhi i popullsisë me pyetjen kryesore të hulumtimit – diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike (pyetëtori është dhënë në shtojcë), kurse u shfrytëzuan edhe të dhënat e Barometrit për Mundësi të Barabarta, hulumtim ky i kryer në vitin 2009 në bazë të pyetësorit standard, të cilin e shfrytëzon Evrostati për hulumtimin e diskriminimit në Bashkimin Evropian, në të cilin përfshihet edhe diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike. Sondazhi u krye me një ekzemplar reprezentues nga 1.100 persona, me përfaqësim përkatës etnik, gjinor dhe rajonal.

c) Intervista me faktorë relevant

Duke patur parasysh vetëdijen e ulët për diskriminimin në esencë, dhe mbase si pasojë e konfliktit, pak flitet për diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike dhe shumë rrallë lajmërohen rastet e diskriminimit. Nga ana tjetër – çdo qytetar ka mendimin dhe vlerësimin e vet për shkallën e diskriminimit në atë bazë.

Që të bëhet një vlerësim i perceptimit për këtë lloj diskriminimi, përveç sondazhit të popullatës, u bënë edhe intervista me faktorë dhe ekspertë relevant lidhur me perceptimin dhe vlerësimin e tyre të gjendjes. Kjo më së shumti zbatohet në sferën e arsimit, mbrojtjes sociale dhe mediave. Me intervistat u përfshinë edhe më shumë sektorë të shoqërisë, gjegjësisht pati intervista me persona kyç nga: Kuvendi; Qeveria (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, etj); Avokati i Popullit; mediat; sipas nevojave të dala hulumtimi për sqarimin e ndonjë pjese të gjetjeve.

ç) Përgatitja e ilustrimit të rasteve

Ilustrimet e rasteve në mënyrë cilësore i plotësojnë tre metodat paraprake dhe mundësuan realizimin e analizës praktike të çështjeve apo aspekteve

konkrete. Për këtë pjesë të hulumtimit u vështruan rastet tanimë të dokumentuara të mediave, praktika e organizatave qytetare dhe Avokatit të Popullit. Ekspertët vetë i zgjodhën rastet të cilat do t'i përpunojnë.

d) Analiza e të dhënave dhe përgatitja e skicë-raportit hulumtues

Të dhënat e grumbulluara nga dokumentacioni në dispozicion, sondazhet e bëra, ilustrimet e rasteve dhe aktivitetet tjera u analizuan dhe u inkorporuan në skicën e këtij raporti.

Gjetjet dhe përfundimet e para i shqyrtoi Komiteti Këshilldhënës (edhe në funksion të grupit të fokusit), në tetor të vitit 2010, pas së cilës filloi përpilimi i raportit.

Raporti përmban edhe një përmbledhje politike, kushtuar krijuesve të politikave dhe opinionit publik të gjerë, në të cilin janë prezantuar zbulimet kryesore, arritjet dhe dobësitë, si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes aktuale.

dh) Takimet e Komisionit Këshilldhënës

Gjatë kohëzgjatjes së këtij Projekti u organizuan dy takime të Komitetit Këshilldhënës (KK). Qëllimi i takimit të parë me KK-në ishte të bëhet shqyrtimi i metodologjisë dhe i aktiviteteve të planifikuara, si dhe të jepen drejtime për ndonjë nga ato. KK-ja kontribuoi edhe për seleksionimin e ekspertëve.

Takimi i dytë u mbajt pas grumbullimit të të dhënave, përkatësisht pas përfundimit të aktiviteteve. Qëllimi i këtij takimi ishte të prezantohen zbulimet nga hulumtimi, të komentohen dhe debatohen përfundimet dhe të kontribuohet për formulimin e rekomandimeve.

Në fazën përfundimtare, u bënë edhe konsultime bilaterale plotësuese me një pjesë të anëtarëve të Komisionit Këshilldhënës.

1. RREGULLATIVA LIGJORE PËR KUNDËR-DISKRIMINIMIN

Diskriminimi mund të shprehet në mënyra të ndryshme, por edhe kuptimi i kësaj çështjeje nga njerëzit mund të jetë i ndryshëm. Nëse diçka do të kuptohet si diskriminim apo jo – është një çështje e ndjenjës personale dhe subjektive dhe varet nga botëkuptimet personale të çdo njeriu. Fakt është sesot çdo njeri në këtë apo atë menyrë goditet nga diskriminimi, pasi, në përgjithësi, kultura përbëhet nga sisteme të ndryshme të interpretimit dhe përcaktimeve, të cilat po bëjnë gërshetim të ndërsjellë, kështuqë një person mund t'u takoj më shumë kulturave. Parashtrohet pyetja, pse sot gjithnjë e më tepër po flitet për diskriminimin? Në esencë, lidhur me hulumtimin tonë, ekzistojnë dy arsye themelore:

1. karakteri i theksuarshumëetnik, shumëgjuhësor, shumëkulturor dhe shumëreligjioz në vendet e Evropës;¹ dhe
2. fakti se më nuk ekziston një formë të diskriminimit më të theksuar juridikisht (i përmbajtur në ligj), tani më për herë të parë vijnë në shprehje format jo-formale të diskriminimit.²

1. Siç ka theksuar Romano Prodi (Hungarian News Agency, 15 April 2001) "Evropa është Evropë e pakicave" (Europe is the Europe of minorities). Domethënë, në pajtim me Pan dhe Pfeil, çdo vend evropian i cili ka më shumë se një milion banorë ka grupe të pakicave; vetëm "mini vendet" si Luksemburgu, Malta, San Marino, etj., nuk kanë pakica. Përqindja e njerëzve të cilët bëjnë pjesë në pakicë në vendete BE-së (BE nga 15 vende) ndryshon nga 1% në Gjermani, deri në 20% në Spanjë. Pastaj, Belgjika me tre bashkësi gjuhësore, segmenti i pakicave është 90%. Numri më i madh i vendeve kanë ndërmjet tre dhe gjashtë grupe, kurse në Itali ka dymbëdhjetë. Madje edhe Franca dhe Greqia, të cilat në masë të madhe e mohojnë ekzistimin e pakicave në territorin e tyre, kanë shtatë grupe. Dymbëdhjetë vendet e reja që u bënë anëtare të BE-së në vitin 2004 dhe 2007, me përjashtim të Maltës dhe Qipros kanë se paku katër grupe pakicash, por shumica e tyre kanë shtatë. Disa vendelindore janë vende relativisht homogjene, si Polonia dhe Hungaria, në të cilat përqindja e njerëzve që u takojnë pakicave është vetëm 3-4%, por në vendet tjera kjo përqindje është nga 10-12%, kurse Estonia dhe Letonia kanë 30-40%.
2. Parandalimi i diskriminimit në grupe të ndryshme shoqërore paraqet temë interesi për shumë organe dhe institucione ndërkombëtare të cilat duke u bazuar në vlerësimin e vet të gjendjeve dhe propozimeve për rregullimin normativ të disa sferave të caktuara japin mendime dhe rekomandime për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të perceptuara. Kjo sidomos ka të bëjë me OSBE-në dhe bashkëpunimin e shprehur me ndihmën e raporteve të ndryshme dhe vlerësimit të gjendjes, pastaj rekomandimet e Komitetit për shfuqizimin e të gjitha formave të diskriminimit racor pranë KB-së dhe Komisionit Evropian kundër racizmit dhe tolerancës pranë Këshillit të Evropës. Këto rekomandime, të sjella në bazë të raporteve për gjendjen e të drejtave njerëzore në Republikën e Maqedonisë do të merren parasysh lidhur me përcaktimin e gjendjes në disa sfera të veçanta, si dhe lidhur me propozimin e masave të nevojshme për rregullativën ligjore. Shih Andreevska, E., International Law and Human Rights (SEE-University, Tetovë, 2005).

Instrumentet ndërkombëtare, si dhe legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, nuk e definojnë nocionin e diskriminimit në të njëjtën mënyrë. Në bazë të dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat e ndalojnë diskriminimin, atë mund t'a definojmë si dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie përparësi të një individi, në ndonjë bazë (të përkatësise racore, gjinore, etnike, politike, të moshës, hendikepit, etj.), dhe që ka për qëllim ose pasojë çrregullimin apo uljen e njohjes, ushtrimit dhe kryerjen, nën kushte të njëjta të të drejtave dhe lirive të njeriut në sferën politike, ekonomike, kulturore, sociale ose në çfarëdo sferë tjetër të jetës shoqërore.³

Dispozitat më të reja që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin, dhe ato të së drejtës ndërkombëtare, por edhe dispozitat nacionale, bëjnë dallim midis-diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Prandaj, diskriminimi i drejtpërdrejtë ekziston në rast kur një person vihet në pozitë më pak të volitshme në krahasim me një person tjetër, në situata identike, dhe për ndonjë arsye të mbrojtur diskriminuese. Në pajtim me këtë definicion, që të ekzistojë diskriminimi i drejtpërdrejtë patjetër duhet të vërtetohet ekzistimi i një trajtimi më të keq, apo më pak i volitshëm; së dyti, ky trajtim më pak i volitshëm vërtetohet duke krahasuar situatën me ndonjë person tjetër në situata identike; e treta, trajtimi më pak i volitshëm bëhet për ndonjë arsye të mbrojtur diskriminuese; dhe e katërta, duhet të ekzistojë një situatë e njëjtë për të dy personat që krahasohen. Kjo e fundit është rezultat i asaj se çka është e arsyeshme të ekzistojë trajtimi i ndryshëm (më pak i volitshëm) nëse situatat janë të ndryshme.⁴

Nga ana tjetër, veprimet që kanë rezultat diskriminues pa qëllim diskriminues njihen si diskriminim i tërthortë. Diskriminimi i tërthortë shfaqet në rastet kur “ndonjë dispozitë, kriter apo praktikë gjoja neutrale, , i vë pjesëtarët” e ndonjë grupi të caktuar (në baza diskriminuese) “në një pozitë më pak të volitshme të posaçme në krahasim me të tjerët, vetëm nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar objektivisht për ndonjë qëllim legjitim ose masa të përshtatshme dhe të nevojshme për arritjen e atij qëllimi”.⁵ Që të vërtetohet diskriminimi i tërthortë duhet, para së gjithash, të ekzistojë ndonjë

3. Shih Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (CERD), Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme e KB-ve 2106 (XX) e21 dhjetorit të vitit 1965, në fuqi nga 4 janari i vitit 1969, neni 1; shih gjithashtu, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, e 18 dhjetorit të vitit 1979, në fuqi nga 3 shtatori i vitit 1981; shih dhe, Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Komenti i përgjithshëm 18, Mosdiskriminimi, 11/10/1989, par. 6.

4. Shih, Udhëzime për institucionet për implementimin e Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, (autorë Tanja Temellkovska Milenkoviq dhe Bekim Kadriu), 2010.

5. Council Directive 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin, O.J. L 180 , 19/07/2000, P.0022 – 0026), mund ta gjeni në web-faqen <http://eur-lex.europa.eu/> [në tekstin e mëposhtëm “BE Direktiva racore“], neni 2.2.6.

rregull,, kriter ose praktikë e caktuar neutrale (d.m.th rregull i cili nuk i trajton individët në mënyrë të pavolitshme vetvetiu); elementi i dytë është më kryesori, gjegjësisht, kërkohet që këto rregulla ose masa neutrale të rezultojnë në “përjashtim joproporcional (më të madh) të pjesëtarëve të ndonjë grupi të caktuar (në baza diskriminuese) nga mundësia që të shfrytëzohen me të drejtë“. Në fund, kërkohet që këto rregulla të mos jenë të domosdoshme dhe të arsyeshme në marrëdhëniet në të cilat përdoren.⁶

Veç diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, në sistemet juridike nacionale dhe në BE ndalohet edhe shqetësimi, viktimizimi dhenitja e diskriminimit. Shqetësimi paraqitet në ato raste kur ndonjë sjellje e caktuar në baza diskriminuese, ka për qëllim ose pasojë cënimin e dinjitetit të ndonjë personi ose krijimin e ambientit ofendues, armiqësor, të frikshëm ose degradues.⁷ Viktimizimi shfaqet në rastet kur një subjekt ndërmerr aktivitete negative ndaj një personi tjetër i cili ka ndërmarr veprime për vërtetimin e ekzistimit të diskriminimit, qofte ndonjë procedurë ligjore, ka dëshmuar kundër diskriminuesit të supozuar ose ka paraqitur një diskriminim. Për nxitje të diskriminimit vlejné rregullat e përgjithshme të nxitjes. Kuptimi thelbësor është se nxitja e diskriminimit barazohet me vetë diskriminimin.⁸

Kur flasim për mbrojtje nga diskriminimi, miratimi i rregullativës ligjore paraqitet si parakusht i parë për luftën efikase dhe të sukseshme kundër diskriminimit. Natyrisht, legjislacioni i miratuar për (mos)diskriminimin duhet të përputhet me kushtet që mbizotërojnë në një shoqëri të caktuar, me qëllim që rregullativa të mund të zbatohet me efikasitet. Në vazhdim, lufta kundër diskriminimit nuk bëhet vetëm në nivel të miratimit të legjislacionit, por edhe në sfera tjera, si në sferën e zhvillimit të vetëdijes për ekzistimin e diskriminimit dhe përforcimin e kapaciteteve të institucioneve që t'i bëjnë ballë diskriminimit.

Rregullativën ligjore për mbrojtje nga diskriminimi çdoherë e kemi analizuar në nivele të ndryshme. Para së gjithash, analizohen ligjet ekzistuese, por me analizë plotësuese të dispozitave kushtetuese dhe të së drejtës ndërkombëtare që ka të bëjë me sferën e caktuar. Edhe këtu do ta ndjekim rrugën e njëjtë të analizës.

⁶ Udhëzime për institucionet për implementimin e Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, (autorë Tanja Temelkowska Milenković dhe Bekim Kadriu), 2010.

⁷ Definicion të ngjashëm përmban dhe Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 50/2010, nga 13.04.2010, neni 7. Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi duhet të zbatohet nga 1 janari i vitit 2011.

⁸ Ibid., nenet 9 dhe 10.

1.1. INSTRUMENTET JURIDIKE NDËRKOMBËTARE

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar një numër të madh marrëveshesh ndërkombëtare nëpërmjet të cilave merr obligim t'i mbrojtë nga diskriminimi (në baza të ndryshme) personat nën jurisdikcionin e saj. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, marrëveshjet e nënshkuara dhe të ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën, paraqesin një pjesë të rendit të brendshëm juridik.⁹ Në këtë mënyrë, Republika e Maqedonisë duhet në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i zbatojë dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare të cilat e ndalojnë diskriminimin. Kur flasim për mbrojtje nga diskriminimi etnik, para së gjithash mendojmë për Konventën Ndërkombëtare për shfuqizimin e të gjithë formave të diskriminimit racor (KEDR),¹⁰ Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike (PNDQK),¹¹ Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK),¹² Konventa për të drejtat e fëmijëve,¹³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ),¹⁴ Protokoli 12 i KEDR-it,¹⁵ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale¹⁶ dhe, në kuadër të BE-së, Direktiva për implementimin e parimit për trajtim të barabartë midis njerëzve pavarësisht nga përkatësia e tyre racore ose etnike.¹⁷

1.1.1. Instrumentet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)

Si instrumente më të rëndësishme të miratuara në kuadër të OKB-së janë Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racor (KEDR), Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike (PNDQK) dhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK). KEDR-i ka të bëjë vetëm me diskriminimin racor, i cili sipas definicionit, e përfshin dhe diskriminimin në bazë të prejardhjes etnike dhe nacionale.¹⁸ Në këtë Konventë definohet diskriminimi, parashihen detyrime për shtetet që të ndër-marrin masa për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit racor në të gjithë sferat e jetës shoqërore dhe të marrin masa për veprime pohuese.¹⁹

PNDQK dhe PNDESK parashohin një numër të madh të të drejtave, por i obligojnë shtetet me anë të marrëveshjeve që të gjitha të drejtat të sigurohen në

⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 52/1991, prej 22.11.1991, neni 118.

¹⁰ CERD, cituar më lartë në fusnotën 3.

¹¹ Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, 16 dhjetor 1966, UNTS 999.

¹² Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, 16 dhjetor 1966, UNTS 993.

¹³ Konventa për të drejtat e fëmijëve, 20 nëntor 1989, UNTS 1577.

¹⁴ Konventa ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale, 4 nëntor 1950, CETS No. 005.

¹⁵ Protokoli 12 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, 4 nëntor 2000, CETS No 177.

¹⁶ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, 1 shkurt 1995, CETS No. 157,

¹⁷ Direktiva racore e BE-së, shih më lartë fusnota 5.

¹⁸ CERD, shih më lartë fusnota 3, neni 1.

¹⁹ Ibid., nenet 1-7.

mënyrë të barabartë nën jurisdiksionin e tyre, pa diskriminim. Në fakt, këto marrëveshje përmbajnë klauzula anti-diskriminuese ku ndalohet diskriminimi për realizimin e të drejtave, duke përfshirë këtu edhe përkatësinë etnike.²⁰ Specifike është edhe dispozita e nenit 26 të PNDQK në të cilën ekziston një klauzulë plotësuese anti-diskriminuese, por e cila nuk ka të bëjë vetëm me të drejtat e theksuara në marrëveshje, por me të gjitha të drejtat të cilat një sistem juridik ua garanton individëve (duke përfshirë këtu edhe të drejtën e vendit).²¹

Në kuadër të raportimit të rregullt të organeve kompetente të OKB-së për zbatimin e marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare në lidhje me përcaktimin e masave për luftimin e diskriminimit, shumë të rëndësishme janë Rekomandimet e Komitetit për shfuqizimin e diskriminimit racor (KEDR, ang. CERD) të miratuara me rastin e raportit të 4-të dhe 7-të. *Raporti për Republikën e Maqedonisë për zbatimin e KEDR i vitit 2007.*²² Rekomandimet pohojnë disa dukuri të cilat Komiteti i vlerëson si problematike dhe jep drejttime parimore për harmonizimin e gjendjes me obligimet që rrjedhin nga KEDR-ja.²³

1.1.2. Instrumentet e Këshillit të Evropës

Instrumentet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut të cilat drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me parandalimin dhe ndalimin e diskriminimit etnik janë KEDNJ, Protokoli 12 i KEDNJ dhe Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale e Këshillit të Evropës (neni 12 dhe 14). Me nenin 14 të KEDNJ përcaktohet se respektimi i të drejtave dhe lirive të njohura me Konventën duhet të bëhet pa asnjë diskriminim në çfarëdo baze, siç janë gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, religjioni, bindja politike, prejardhja nacionale ose shoqërore, përkatësia e pakicave nacionale, pronësia, lindja ose simbolet tjera. Duke patur parasysh se neni 14 e ndalon vetëm diskriminimin e të drejtave të parapara në KEDNJ, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi protokoli 12 i KEDNJ i cili përmban ndalimin e të përgjithshëm të diskriminimit, i ngjashëm me nenin 26 të PNDQK. Maqedonia është njëra nga 17 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (me status qysh në tetor 2010) e cila e ka ratifikuar Protokolin 12.²⁴

²⁰ Shih PNDQK dhe PNDESK, cituar më lartë në fusnotën 11 dhe 12, neni 2.

²¹ Shih më gjërësisht në Manfred Nowak, UN Covenant on Civil and Political Rights: CCPR Commentary (Kehl: N. P. Engel). 1993, faq. 466-478. Shih edhe qëndrimin e Komitetit për të drejtat e njeriut tek komunikimi F.H. Zwaan-de Vries v the Netherlands, Communication No 182/1984 od 16 april 1987, CCPR/C/29/D/182/1984.

²² UN Doc. CERD/C/MKD/CO/713 June 2007.

²³ Ibid. Përmbajtja në pjesën 9 deri 25. Në masë të madhe janë identike me rekomandimet e EKRN-së të dhëna në Raportin e katërt për Republikën e Maqedonisë (Shih dok. CRI(2010)19).

²⁴ Për listën e shteteve të cilat ekanë ratifikuar Protokolin 12 të KEDNJ, shih web-faqen <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=177&CM=1&DF=10/02/2010&CL=ENG>

Republika e Maqedonisë ishte ndër vendet e para që e ratifikoi edhe Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale të Këshillit të Evropës në të cilën, në pajtim me nenin 4, palët obligohen që pjesëtarëve të pakicave nacionale t'u garantojnë barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë juridike. Lidhur me këtë, ndalohet çfarëdo lloj diskriminimi i cili bazohet në përkatësinë e pakicës nacionale.

Këshilli i Evropës ka themeluar Komisionin Evropian për luftimin e racizmit dhe jotolerancës (KERJ ang. ECRI), si organ i pavarur për mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut, i specializuar për çështje të lidhura me racizmin dhe jotolerancën.²⁵ Në kuadër të aktiviteteve të tij statutore, KERJ kryen mbikëqyrje veçanërisht për secilin vend, nëpërmjet të cilit e analizon situatën lidhur me racizmin dhe jotolerancën në secilin vend anëtar të Këshillit të Evropës dhe jep sugjerime dhe propozime se si do të zgjidhen problemet e identifikuar. Ky Komision, në vitin 2010, e dorëzoi Raportin e katërt për Republikën e Maqedonisë me propozimet dhe rekomandimet e veta. Propozimet dhe rekomandimet nuk e obligojnë shtetin, por paraqesin drejtime për bërjen e përpjekjeve plotësuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

1.1.3. Obligimet gjatë procesit të anëtarësimit në BE

Përveç obligimeve për luftimin e diskriminimit të, cilat i imponuan anëtarët e Këshillit të Evropës dhe OKB-ja, si vend kandidat për anëtarësim në BE, Republika e Maqedonisë është e obliguar të harmonizojë legjislacionin e saj me sistemin juridik të BE-së, i cili gjithashtu parasheh ndalimin e diskriminimit.

Parimi i ndalimit të diskriminimit paraqet një parim fundamental të Marrëveshjes për BE-në,²⁶ i cili në preambulën e vet e thekson lidhshmërinë drejt parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, si dhe sundimin e së drejtës. Në pajtim me këto dispozita, në nenin 2, par. 6., gjatë numërimit të qëllimeve të Bashkimit, theks i veçantë vihet në zhvillimin e Bashkimit si një hapësirë për liri, siguri dhe drejtësi, kurse në nenin 2 theksohet edhe avancimi i barazisë gjinore, si një nga detyrat e bashkësive Me marrëveshjen për BE-në, në nenin 7 parashihet edhe një klauzulë për suspendim, e cila mundëson kufizimin e disa të drejtave të caktuara për vendet anëtare të BE-së në raste të cënimeve të rënda dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, si dhe sanksione në raste të shkeljes së parimeve fundamentale nga ana e vendeve anëtare. Neni 13 i Marrëveshjes për Bashkësitë

^{25.} Vendimi për themelimin e KERJ u miratua në Konferencën e parë botërore të mbajtur në Vjenë më 9 tetor 1993. Statuti i KERJ u miratua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 13 qershor 2002.

^{26.} Marrëveshja për themelim të BE-së, nënshkruar më 7 shkurt 1992, në fuqi prej 1 nëntor 1993.

evropiane siguron kompetenca për BE-në kundrejt shteteve anëtare në sferën e luftës kundër diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, racës, religjionit, invaliditetit, moshës ose orientimit seksual.

Karta e BE-së për të drejtat fundamentale përmban një sërë të drejtash qytetare, ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët dhe personat me vendqëndrim në BE. Karta e BE-së, mes tjerash, parasheh edhe barazi për të gjithë njerëzit para ligjit,²⁷ e ndalon diskriminimin në bazë të çfarëdo lloj përkatësie, duke përfshirë këtu edhe përkatësinë e pakicave nacionale,²⁸ kurse njëkohësisht Bashkimi obligohet për respektimin e dallimeve kulturore, fetare dhe gjuhësore.²⁹

Mbrojtja e plotë e të drejtave të njeriut paraqet një qëllim për çdo politikë. Edhe përkundër rregullimit të tyre me ligj, implementimi i suksesshëm i politikës antidiskriminuese kontribuon për rritjen e vetëdijes publike rreth rrezikut shoqëror nga diskriminimi dhe dobinë që secili do ta ketë duke i respektuar të drejtat e tjetrit. Pastaj, duhet të largohen të gjitha veprimet nënçmuese të mundshme dhe marginalizimi i grupeve të ndjeshme shoqërore dhe të sigurohet mbrojtja e plotë e tyre.

Burimi më i rëndësishëm për të drejtat në BE i cili ka të bëjë vetëm me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike ose racore është Direktiva për implementimin e parimit për trajtim të barabartë midis njerëzve pa marr parasysh përkatësinë e tyre etnike ose racore (Direktiva racore e BE-së).³⁰ Kjo Direktivë e ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, vitkimizimin dhe shqetësimin në bazë të prejardhjes etnike ose racore, edhe atë në marrëdhëniet e punës, mbrojtjen sociale, sigurimin social, shëndetësinë, arsimin, qasjen në mallra dhe shërbime dhe banimin.³¹ Direktiva parasheh mundësi për ndërmarrjen e veprimeve pohuese (neni 5), kurse me rëndësi për Republikën e Maqedonisë është se përmban edhe obligime për themelimin e organit të barazisë (neni 13).

Në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2009 lidhur me përparimin e Republikës së Maqedonisë në procedurën e anëtarësimit në BE, përpjekjet e Republikës së Maqedonisë vlerësohen pozitive për parandalimin e diskriminimit në disa sfera të caktuara, por përmendet edhe nevoja për miratimin e legjislationit dhe amandamenteve të posaçme nga ajo që është, me të cilat do të rrumbullakësohet sistemi i masave për parandalimin e diskriminimit.³² Njëherit,

^{27.} Karta e BE-së për të drejtat fundamentale, neni 20.

^{28.} Ibid, neni 21.

^{29.} Ibid, neni 22.

^{30.} Direktiva racore e BE-së është cituar më lartë, në fusnotën 5

^{31.} Ibid, neni 3.

^{32.} Ibid, fq. 115-19.

në të njëjtin Raport të Komisionit Evropian, theksohet obligimi i Maqedonisë për implementimin e *acquis* në disa politika të caktuara të BE-së, dhe nga këtu, duke iu referuar kornizës së saktë juridike të BE-së lidhur me luftën për-mosdiskriminim të Romëve, rekomandon implementimin e plotë të saj. Në raportin për vitin 2010, përshëndetet miratimi i Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (LPMD), por kërkohet që ai të harmonizohet plotësisht me atë të BE-së.

1.1.4. Dokumente tjera

Në dokumentin për iniciativën e Evropës së Mesme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale,³³ anëtare e të cilit është edhe Republika e Maqedonisë, në nenin 6 konstatohet se vendet anëtare do të marrin masa me qëllim të sigurimit të mbrojtjes nga çfarëdo veprimi me të cilën nxitet dhuna kundër personave ose grupeve, të cilat bazohen në diskriminimin nacional, racor, etnik ose religjioz, armisëqi ose urrejtje, duke përfshirë këtu dhe antisemitizmin. Dispozita të këtij lloji janë përfshirë dhe në Kodin Penal.³⁴ Në nenin 7 vërtetohet obligimi i shteteve anëtare për ndërmarrjen e masave të posaçme me qëllim të lehtësimit të integritimit në shoqëri të pjesëtarëve të pakicës nacionale Rome, me qëllim të shmangies së të gjitha formave të jotolerancës ndaj pjesëtarëve të këtij grupi etnik.

1.2. DISPOZITAT KUSHTETUESE DHE DISPOZITA TJERA THEMELORE

Parimi i barazisë në sistemin juridik të RM-së rrjedh nga vetë Kushtetuta e RM-së. Në fakt, neni 9 i Kushtetutës parasheh se “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë për sa u përket lirive dhe të drejtave pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja nacionale dhe sociale, bindja politike ose fetare, pozita shoqërore ose pronësore”.³⁵ Kjo dispozitë kushtetuese, edhe pse paraqet një bazë të mjaftueshme juridike për miratimin e legjislacionit plotësues dhe më të hollësishëm për mbrojtje nga diskriminimi, prapëseprap, ka disa mungesa në vete. Para së gjithash, e njëjta ka të bëjë vetëm me qytetarët e Republikës së Maqedonisë, dhe me këtë i lë pa mbrojtje juridike të huajtë dhe personat pa nënshtetësi.³⁶ Në vazhdim, dispozita kushtetuese tekson vetëm një numër të kufizuar të bazave diskriminuese.³⁷ Poashtu, edhe lista e bazave të theksuara diskriminuese është e mbyllur. Në fund, kjo dispozitë

³³ Udhëzime për përdorimin e gjuhës së pakicave në mediat elektronike, 25 tetor, 2003.

³⁴ Akademiku Vllado Kambovski, Komete dhe udhëzues në dispozitat për urrejtje në Kodin Penal, 2010

³⁵ Kushtetuta e RM-së, shih më lartë në fusnotën 9, neni 9.

³⁶ Shih Rekomandimin e përgjithshëm të Komisionit Evropian për luftë kundër racizmit dhe jotolerancës (ECRI) nr. 7: National legislation to combat racism and racial discrimination, December 2002, CRI(2003)8.

³⁷ Mungojnë shumë baza aktuale, siç janë hendikepi, orientimi seksual dhe mosha

kushtetuese nuk ka të bëjë me personat juridik, të cilët Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi drejtpërsë drejti i numëron.³⁸

Për shkak të këtyre mungesave, ekzistojnë mendime se dispozita kushtetuese për barazi duhet të përpunohet edhe më tej me qëllim të ndjekjes së dispozitave bashkëkohore të mosdiskriminimit. Ky argument vërtetohet edhe nga vetë fakti se Maqedonia ka marr obligime ndërkombëtare (përmes marrëveshjeve) të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë individëve nën jurisdiksionin e saj, edhe për baza më të gjera se sa ato të parapara në vetë dispozitën kushtetuese të nenit 9. Vetëm do t'i përmendim dispozitat e nenit 26 të PNDQK dhe nenin 1 nga Protokoli 12 të KEDNJ. Këto klauzula të përgjithshme për mosdiskriminim e obligojnë Maqedoninë të sigurojë mosdiskriminim në hapësirë më të gjerë sesa nga interpretimi restriktiv që mund të del nga neni 9 i Kushtetutës.³⁹ Nga ana tjetër, marrëveshjet e këtilla janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme dhe kanë prioritet mbi të drejtën nacionale. Më tej, edhe pse dispozitat kushtetuese janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme, nuk ka procedurë të evidentuar për një rast individual të diskriminimit në të cilën dikush ka arritur t'i referohet nenit 9, ose Protokolit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁴⁰

1.3. LIGJI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Dispozita kushtetuese për barazi, sido që të jetë, paraqet bazë juridike për miratimin e Ligji të ri për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (LPMD). Ky ligj përmban dispozita me të cilat ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë jo vetëm në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, gjuhës, nënshtrësisë, religjionit apo bindjes fetare, por edhe në bazë të gjinisë, përkatësisë së ndonjë grupi të marginalizuar, prejardhjes sociale, arsimit, përkatësisë politike, bindjeve tjera, statusit personal, shoqëror, familjar apo martesor, pengesave psikike apo fizike, moshës, statusit pronësor dhe gjendjes shëndetësore, si dhe në çfarëdo baze tjetër e përcaktuar me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.⁴¹ Poashtu, Ligji përfshin edhe veprime të inkurajimit, nxitjes dhe ndihmesës së diskriminimit dhe posaçërisht veprime të shqetësimit, viktimizimit dhe segregimit gjegjësisht ndarjes.⁴²

³⁸ LPMD, shih më lartë në fusnotën 7, neni 2.

³⁹ Udhëzime për institucionet për implementimin e Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, (autorë Tanja Temellkowska Milenkoviç dhe Bekim Kadriu), 2010

⁴⁰ Shih ECRI Doc. CRI(2010)19, faq. 13-14.

⁴¹ LPMD, cituar më lartë në fusnotën 7, neni 4 dhe 6.

⁴² Ibid., neni 3.

Ligji përmban edhe një numër të madh të dispozitave procesuese, duke përfshirë edhe dispozita për transferimin e ngarkesës së të vërtetuarit dhe jo vetëm mundësinë e intervenimeve të organizatave të specializuara joqeveritare, si palë e tretë, në procedurë, por në disa raste të paraqitën si paditës dhe bashkëpaditës.⁴³ Ligji poashtu parasheh themelimin e organeve për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.⁴⁴

Ajo që LPMD-në e bën jashtëzakonisht të rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë është fakti se paraqet ligjin e parë që, në mënyrë të përgjithshme, e ndalon diskriminimin. Aspekti i përgjithshëm i LPMD-së rrjedh nga dy karakteristika të saja. E para, LPMD-ja ka të bëjë me një numër të madh të bazave diskriminuese, kurse krahas kësaj parasheh edhe listën e hapur, që nënkupton se asnjë karakteristikë e individit (e lindur apo e përfitur) nuk duhet të shërben si bazë për përjashtim ose kufizim të pajustificuar të të drejtave të tij. Mes bazave diskriminuese në mënyrë decide theksohet përkatësia etnike. Nga ana tjetër, LPMD-ja përfshinë edhe sfera të gjëra të jetës shoqërore. Kështu, sipas nenit 4, LPMD-ja aplikohet në marrëdhënie pune, arsim, shkencë dhe sport, mbrojtje sociale, sigurim penzional dhe invalidor, sigurim dhe mbrojtje shëndetësore, jurisprudencë dhe menaxhment, banim, qasja në komoditete dhe shërbime, etj. Në këtë mënyrë, LPMD-ja garanton një mundësi të madhe të aplikimit, që është preçedencë pozitive në sistemin juridik të RM-së.

Krahas aspektit të përgjithshëm të LPMD-së, duke pasur parasysh se i njejti përmban dispozita të kompletuara për (mos)diskriminim (baza diskriminuese, definicione, përjashtime të diskriminimeve, etj), LPMD-ja paraqet edhe model aplikimi të dispozitave të ngjashme të këtilla të cilat ekzistojnë në ligje tjera të veçanta. Në fakt, duke pasur parasysh qasjen jokonzistente të ligjeve të veçanta për çështjen e (mos)diskriminimit, LPMD-ja paraqet tregues të mirë sesi ato terme dhe institucione duhet të sqarohen dhe zbatohen.

LPMD-ja është i rëndësishëm edhe për dy arsye themelore. E para, LPMD-ja parasheh themelimin e një organi për barazi i cili quhet Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi.⁴⁵ Ky organ është i pari i këtij lloji në Republikën e Maqedonisë, kurse themelohet pikërisht për shkak të obligimit të RM-së për harmonizimin e legjislacionit të saj me atë të BE-së. Konkretisht, themelimi i një organi të

^{43.} Ibid, neni 19 deri 21 dhe 34.

^{44.} Ibid., neni 11 deri 15. Duhet theksuar se gjatë miratimit të Ligjit nuk u morrën parasysh vërejtjet e Komisionit Evropian, e sidomos vërejtjet e Komisionit Venecian të Këshillit të Evropës (Shih Mendimin për propozim-ligjin e 19 dhjetorit të vitit 2008. CDL-AD (2008)042).

^{45.} Ibid., neni 1, par. 2.

këtu për barazi parashihet pikërisht në Direktivën racore të BE-së, në nenin 13. Nga ana tjetër, LPMD-ja poashtu për herë të parë parasheh procedurë të posaçme gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi.⁴⁶ E njehta parashihet si procedurë kontestimore dhe urgjente. Në procedurën e paditësit, jo vetëm që mund të kërkon vërtetimin e ekzistimit të diskriminimit, por mund të kërkon edhe dëmshpërblim dhe shqiptim të aktvendimit (në raste konkrete).⁴⁷ Në fund, LPMD-ja parasheh edhe dispozita kundërvajtjeje për diskriminimin e kryer.⁴⁸

1.4. LIGJE TË POSAÇME QË PËRMBAJNË DISPOZITA PËR KUNDËR-DISKRIMINIMIN

Përveç LPMD-së, dhe para miratimit të tij, në Republikën e Maqedonisë ekzistonin shumë ligje të cilat përmbanin dispozita lidhur me (mos)diskriminimin. Këto ligje janë të sferave të ndryshme, dhe mund të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë mund të hyjnë ligjet që e ndalojnë diskriminimin në sfera të caktuara, të cilat sfera i rregullojnë këto ligje. Ligjet e tilla janë Ligji për marrëdhënie pune,⁴⁹ Ligji për mbrojtje sociale,⁵⁰ Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve,⁵¹ Ligji për arsimin fillor,⁵² Ligji për arsimin e mesëm,⁵³ Ligji për arsimin e lartë,⁵⁴ Ligji për vullnetarizëm,⁵⁵ Ligji për shëndetësi publike,⁵⁶ Ligji për gjykatat.⁵⁷ Në të gjithë këto ligje ekzistojnë dispozita të detajuara apo vetëm “modeste” të cilat e trajtojnë (mos)diskriminimin. Në përgjithësi, këto ligje nuk kanë qasje konzistente në çështjen e (mos)diskriminimit. Prapëseprap, ajo çka është me rëndësi është se të gjitha këto mungesa tani i plotëson Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. LPMD-ja paraqet një model për atë se si duhet të interpretohen dhe dispozitat e këtyre ligjeve të posaçme.

Ligji për shoqatat dhe fondacionet dhe Ligji për partitë politike veç e veç parashohin se në programet e tyre, statutët dhe aktet e brendshme, si dhe në kuadër të aktiviteteve të tyre të përgjithshme, të gjitha ato organizata nuk do të nxisin urrejtje ose jotolerancë racore ose fetare, kurse në rast të kundërt, ato mund të ndalohen me vendim të gjykatës.⁵⁸

46. Ibid., neni 34.

47. Ibid., neni 36.

48. Ibid., nenet 42-45.

49. Ligji për marrëdhënie pune, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 62/2005, nenet 6-8.

50. Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 79/2009, neni 20.

51. Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82/2008, neni 5.

52. Ligji për arsim fillor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 103/2008, neni 2.

53. Ligji për arsim të mesëm, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 52/2002, neni 3.

54. Ligji për arsim të lartë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, neni 108(4);

55. Ligji për vullnetarizëm, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 85/2007, neni 9.

56. Ligji për shëndet publik, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 22/2010, neni 16, pika 5.

57. Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 58/2006, neni 3.

58. Diskriminimi i Romëve në procesin e arsimit – Standarde dhe praktika ndërkombëtare dhe të brendshme, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni, Shkup, fq. 14-16.

Në grupin e dytë të ligjeve hyjnë ato të cilët kanë të bëjnë me vepra penale ose kundërvajtje për ndonjë diskriminim të kryer; ose ligjet që kanë të bëjnë me procedurën; ose ligjet që kanë të bëjnë me institucionet të cilat kanë kompetenca të caktuara në sferën e (mos)diskriminimit. Këtu sidomos i referohemi Kodit Penal, Ligjit për Kundërvajtje, Ligjit për procedurë kontestimore dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

Në Kodin Penal ekzistojnë disa pjesë të cilat kanë të bëjnë pikërisht me këtë ndalim të diskriminimit etnik. Veprat e tilla janë shkelja e barazisë së qytetarëve (neni 137), shkelja e barazisë gjatë kryerjes së veprimtarisë afariste (neni 282), diskriminimi racor dhe diskriminime tjera (neni 417),⁵⁹ shkaktimi i urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarja dhe jotoleranca (neni 319),⁶⁰ Nënçmimet përmes sistemit kompjuterik të pjesëtarëve në bazë fetare, racore, etnike, ose ngjyrës së lëkurës së ndonjë grup (neni 173, alinea 2) dhe shpërndarja e materialeve raciste dhe ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 394-g).⁶¹ Edhe pse ka vërejtje se duhet ndryshuar thelbin e disa prej këtyre veprave,⁶² prapseprap të gjithë ata, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi i mbrojnë nga diskriminimi i mundshëm pjesëtarët e bashkësive etnike në RM. Me ndryshimet e Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë në nenin 39 është shtuar alinea pesë, në të cilin thuhet se gjatë shqiptimit të dënimit, gjykata penale, atje ku është e zbatueshme, do të merr parasysh faktin se vepra ka qenë e motivuar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në baza nacionale ose sociale, në baza të bindjeve politike ose fetare, gjinisë, racës ose ngjyrës së lëkurës të personit ose grupit të personave kundër të cilëve është kryer ajo veprë.⁶³

Ligji për Kundërvajtjet është i rëndësishëm sepse ai zbatohet gjatë identifikimit të kundërvajtjeve të përmbajtura në LPMD, si dhe për përcaktimin e lartësisë së gjobës. Në fakt, LPMD-ja parasheh kundërvajtje të posaçme për nxitjen, thirrjen apo ndihmën e diskriminimit, për shqetësime dhe viktimizim.⁶⁴ Për kundërvajtje të mundshme, organet kompetente do ta rregullojnë procedurën sipas Ligjit për Kundërvajtje (në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për Procedurë Penale).

⁵⁹ Kodi Penal (teksti i rafinuar), Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 19/2004 prej 30.03.2004.

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Ligji për plotësim dhe ndryshim të Kodit Penal, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 114/09 nga 14.09.2009, neni 40 dhe 113.

⁶² Udhëzime për institucionet për implementimin e Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, (autorë Tanja Temellkovska Milenkoviç dhe Bekim Kadriu), 2010.

⁶³ Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 19/04 prej 30.03.2004 dhe ndryshimet e miratuara më 14 shtator 2009, në fuqi prej 15 mars 2010.

⁶⁴ LPMD, shih më lartë në fusnotën 7, neni 34.

Ligji për Procedurë Kontestimore gjithashtu është i rëndësishëm sepse pikërisht procedura për identifikimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimit, sipas LPMD-së është paraparë si procedurë kontestimore. Të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar me LPMD-në do të rregullohen me Ligjin për Procedurë Kontestimore.

Në fund, Ligji për Avokatin e Popullit është shumë i rëndësishëm për mbrojtje nga diskriminimi etnik. Në realitet, me Ligjin e ri për Avokatin e Popullit, kompetencat e Avokatit të Popullit zgjerohen pikërisht në pjesën e mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit, si dhe të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe përkatës të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit publik.⁶⁵ Të dyja këto parime janë të rëndësishme për mbrojtje nga diskriminimi etnik, nga të cilat e para e ndalon diskriminimin, kurse e dyta lejon marrjen e masave pohuese në sferën e punësimit në pushtetin publik. Më gjerësisht për kompetencat e Avokatit të Popullit flitet në pjesën në vijim.

1.5. INSTITUCIONET PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Korniza institucionale për mbrojtje nga diskriminimi, si në nivelin nacional, ashtu dhe në atë ndërkombëtar është e ndarë në kornizë gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore. Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë, mbrojtja gjyqësore lidhur me ndalimin e diskriminimit është në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë,⁶⁶ gjykatat e rregullta të cilat funksionojnë në procedurat civile, ndëshkimore dhe administrative, si dhe Avokati i Popullit janë organe jashtë-gjyqësore dhe jashtë-administrative. Në kuadër të organizatave ndërkombëtare në pjesën e mbrojtjes nga diskriminimi, si organ gjyqësor më i rëndësishëm është Gjykata për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës, Gjykata Evropiane për Drejtësi e BE-së, si dhe organet e tyre ndihmëse të cilat kanë për detyrë të ndjekin gjendjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin në të gjitha bazat.

Qysh në vitin 1997, në Maqedoni ekziston Avokati i Popullit (AP), kompetencat e të cilit, të përcaktuara me dispozitat kushtetuese, janë që t'i mbrojë "të drejtat ligjore dhe kushtetuese të qytetarëve në rast të shkeljes së tyre nga ana e organeve shtetërore". Ajo çka është me rëndësi për diskriminimin etnik janë kompetencat e Avokatit të Popullit për sigurimin e respektimit të parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë të bashkësive etnike në

⁶⁵ Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 60/2003 nga 22.09.2003, neni 2.

⁶⁶ Shih Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese (neni 51 dhe 56).

kuadër të organeve të pushtetit publik.⁶⁷ Në këtë drejtim, Avokati i Popullit pranon ankesa individuale për ndonjë diskriminim të supozuar, me të cilën ka mundësi të rekomandojë mënyra për largimin e pasojave nga diskriminimi, mund të propozojë përsëritje të procedurës në të cilën ka ndodhur diskriminimi (për shembull, konkurs), si dhe mund të iniciojë përgjegjësi disiplinore dhe ndëshkuese.⁶⁸ Formimi i një departamenti të posaçëm në kuadër të AP-së është në proces e sipër, i cili do t'i përpunojë vetëm rastet e diskriminimit.

Ajo çka e kufizon AP-në në ndërmarrjen e masave efektive për mbrojtjen e diskriminimit etnik është fakti se kompetencat e tij nuk e përfshijnë sektorin privat, dhe fakti se rekomandimet e tij nuk kanë karakter obligues. Këto mungesa të AP-së në sferën e mbrojtjes së diskriminimit etnik pritet të eliminohen kur do të fillojë me punë efektive Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi (Komisioni). Komisioni themelohet me Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga diskriminimi, dhe ka mandat të gjerë për marrjen e masave me qëllim të avancimit të barazisë dhe parandalimit të diskriminimit. Komisioni ka një numër të madh kompetencash të cilat mund të grupohen në disa kategori. Në fakt, para së gjithash vijnë parasysh kompetencat në drejtim të ndihmës dhe mbështetjes së viktimave të diskriminimit (përmes zgjidhjes së rasteve individuale të paraqitura), kompetencat promotive dhe këshilldhënëse (ngritjen e vetëdijës për diskriminimin dhe për mekanizmat mbrojtëse, etj.), kompetencat hulumtuese dhe analitike (grumbullon të dhëna statistikore, formon baza të të dhënave, zbaton studime, hulumtime dhe trajnime për diskriminimin), etj.⁶⁹ Sipas pozitës që ka dhe kompetencat e tij, Komisioni në masë të madhe i plotëson kriteret e parimeve të Parisit për mënyrën e formimit dhe funksionimit të organeve kombëtare të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.⁷⁰

Veç AP-së dhe Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, për diskriminimin etnik është me rëndësi edhe Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Bashkësive, e themeluar në pajtim me Ligjin për Avancim dhe Mbrojtje të të Drejtave të Pjesëtarëve të Bashkësive të cilët janë më pak se 20% nga popullsia e Republikës së Maqedonisë.⁷¹ Agjencia kujdeset për realizimin e parimeve themelore që rrjedhin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit (dhe Kushtetuta), të cilat kanë të

⁶⁷ Ligji për Avokatin e Popullit, shih më lartë në fusnotën 64, neni 2.

⁶⁸ Ibid, neni 32.

⁶⁹ Kompetencat e Komisionit të përcaktuara në neni n 24 të LPMD-së.

⁷⁰ Parimet e Parisit që kanë të bëjnë me Statusin e Institucioneve Nacionale, mund të shihen në web-faqen <http://www2.ohchr.org/english/law/parisprinciples.htm>. Një kompetencë të cilën Komisioni nuk e ka, kurse është pjesë e parimeve të Parisit është të funksionojë si ndërmjetësues dhe të arrijë një të ashtuquajtur, marrëveshje miqësore midis palëve në procedurë.

⁷¹ Ligji për Avancimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Pjesëtarëve të Bashkësive të cilat bëjnë më pak se 20% nga popullsia e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 92/2008 prej 22.07.2008.

bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të bashkësive më të vogla etnike (ndër 20%). Agjencia sidomos kujdeset për zbatimin konzistent të parimit për përfaqësim përkatës dhe proporcional, përpilimin e planeve të veprimit të nevojshme për realizimin e Programit për punë të Agjencisë, kryen punë analitike, siguron dhe realizon mjete financiare të nevojshme për realizimin e detyrimeve nga Programi i saj, i dërgon Raport Qeverisë së RM-së për realizimin e Programit, etj.⁷²

1.6. SJELLJA E NËPUNËSVE SHTETËRORË

Nëpunësit shtetërorë çdoherë veprojnë në pajtim me dispozitat juridike të aktit më të lartë – Kushtetutës, përmes ligjeve, akteve nënligjore, madje edhe akteve të cilat bëjnë pjesë në të ashtuquajturën “e drejta e butë”. Kjo nënkupton se personat zyrtarë, gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre patjetër duhet të respektojnë parimin e barazisë së qytetarëve, përkatësisht nuk guxojnë t’i diskriminojnë në asnjë bazë, e as në bazë etnike. Obligimi që personat zyrtarë do të respektojnë parimin e barazisë rrjedh jo vetëm nga LPMD-ja, por edhe nga ligjet themelore të cilat e rregullojnë këtë çështje. Një ligj i tillë është edhe Ligji për gjykatat i cili parasheh se një nga qëllimet kryesore të pushtetit gjyqësor është edhe “sigurimi i barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit në asnjë mënyrë”.⁷³ Nga ana tjetër, Kodi Etik për nëpunësit shtetëror është të sigurojë “trajtim të barabartë të qytetarëve dhe personave juridik gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”.⁷⁴

1.7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundimet

- 1.1. Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) mund të konsiderohet si një lloj strategjie e Republikës së Maqedonisë për marrëdhëniet midis bashkësive etnike, përkatësisht për ballafaqimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike dhe për aplikimin e parimit të përfaqësimit të barabartë të bashkësive etnike. Në bazë të dispozitave të MKO-së, por në pajtim edhe me rregullativën voluminoze ndërkombëtare, janë sjellur edhe më shumë zgjidhje ligjore me të cilat ndalohet diskriminimi dhe avancohet parimi i barazisë (duke përfshirë këtu edhe përfaqësimin e drejtë të bashkësive). Me këtë është arritur edhe një përfshirje e madhe e legjislacionit ndërkombëtar.
- 1.2. Për t’u përshëndetur është edhe zhvillimi i legjislacionit anti-diskriminues dhe miratimi i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (LPMD)

⁷² Ibid, neni 13.

⁷³ Ligji për Gjykatat, shih më lartë në fusnotën 56, neni 3.

⁷⁴ Kodi Etik për nëpunësit shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 96/2001, neni 2, pika 2.

këtë vit. Hapi i ardhshëm duhet të jetë edhe miratimi i një plani veprimi/strategjie të posaçme në nivelin nacional. Gjithashtu, ekziston hapësirë edhe për avancimin e mëtejshëm të rregullativës ligjore (duke filluar nga ratifikimi i disa marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare deri në harmonizimin e ligjeve tjera me LPMD-në sapo të miratuar).

- 1.3. LPMD-ja parashih formimin e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe kjo është një sfidë e veçantë në periudhën e ardhshme. Aftësimi i tij, si edhe përforcimi i institucioneve tjera relevante për ballafaqim me diskriminimin duhet të jenë në rend të parë.

Rekomandimet

- 1.1. Republika e Maqedonisë duhet të miratojë një plan/strategji nacional/e për luftimin e diskriminimit (dhe në funksion të harmonizimit të kapitujve 19 dhe 23 nga Partneriteti parahyrës në BE, si dhe me marrëveshjen e Lisbonës) në drejtim të: plotësimit të dokumenteve ekzistuese nacionale dhe rregullativës ligjore me përfundimet nga Konferencës Ndërkombëtare kundër racizmit, diskriminimit racor, ksenofobisë dhe formave të ngjashme të jotolerancës, Rekomandimet e Komitetit të OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, si dhe Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës. Gjithashtu, duhet të bëhet ratifikimi i Kartës Sociale të Evropës dhe Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave, të cilat janë të reviduara, si edhe të nënshkruhen dhe ratifikohen Konventa për pjesëmarrje të huajve në jetën publike në nivelin lokal dhe Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtorëve sezonal.
- 1.2. Përveç rasteve të kontestimit të disa dispozitave si diskriminuese në disa ligje, deri më tani askush nuk i është referuar nenit 9 të Kushtetutës, madje as edhe Protokolit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për ndonjë rast individual të diskriminimit. Deri më tani arsyeja për këtë gjendje nuk është vështruar, hulumtuar, madje as edhe analizuar nga ana e organeve në Maqedoni, e as nga Avokati i Popullit.⁷⁵ Nga këtu, del edhe rekomandimi për identifikimin e arsyeve se pse deri më tani askush nuk i është referuar Kushtetutës për raste të diskriminimit, e as mekanizmave tjera të themeluara në kuadër të BE-së dhe OKB-së, të cilët janë kompetentë për këtë çështje.⁷⁶

^{75.} Roli i tij në këtë proces shumë të rëndësishëm duke marr parasysh autorizimet ligjore që i ka dhe mundësitë dhe mekanizmat që i ka në dispozicion.

^{76.} KERJ pas dy raporteve të fundit (i treti dhe i katërti) i rekomandon pushtetit që ta zgjidh këtë çështje. Në mungesë të të dhënave valide, mbetet supozimi se bëhet fjalë për mosnjohjen e të drejtave dhe procedurave të vendosura, nga ana e qytetarëve, si dhe (mos)funksionimi i shërbimeve për dhënie falas të ndihmës juridike.

- 1.6. Nevojitet bashkëpunimi më i rritur midis të gjithë organeve të aparatit shtetëror dhe Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili duhet të formohet me LPMD-në e re, me qëllim për të pasur përgjigje përkatëse dhe me kohë për kërkesat dhe rekomandimet e tyre, dhe sigurimin e pavarësisë së tyre strukturale.
- 1.4. Neni 14 i Ligjit për Nënshetësi duhet të zbatohet në mënyrë më liberale, nëse mundet, për personat të cilët qëndrojnë gjatë kohë në vend, si dhe të sigurojnë se zbatimi i asaj dispozite të mos kete veprime diskriminuese mbi cilëndo qoftë bashkësi joshumicë dhe të ndërmerren hapa adekuate për informimin e atyre grupeve të cilat kanë interesim të posaçëm për këtë çështje.⁷⁷
- 1.5. Duhet të vazhdohet edhe me konsolidimin e dispozitave juridiko-penale lidhur me racizmin dhe jotolerancën, veçanarisht të respektohet Rekomandimi i përgjithshëm i KERJ-së nr. 7 (Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës)⁷⁸ me legjislacionin e brendshëm për luftën kundër racizmit dhe jotolerancës. Pastaj, duhet të përmirësohet sistemi i grumbullimit të të dhënave relevante, si dhe të merret një spektër i gjerë masash në të gjitha nivelet në sistemin e mbrojtjes juridiko-penale me qëllim të përmirësimit të zbatimit të dispozitave juridiko-penale që kanë të bëjnë me racizmin dhe diskriminimin, duke përfshirë këtu edhe masa për ngritjen e vetëdijes të drejtuarah policia, prokurorët dhe gjykatësit.

⁷⁷ Deri në dhjetor të vitit 2009, rreth 5.000 nga përafërsisht 5.500 persona të cilët kanë dorëzuar fletëkërkesa në bazë të nenit 14, kanë marr nënshetësi; 160 kërkesa janë ende në procedurë e sipër dhe rreth 360 kërkesa janë refuzuar për shkak se personat nuk kanë patur qëndrim të pandërprerë; 10 % për shkak të mosnjohjes së gjuhës maqedonase. Shih Ibid, Supra 15, fq. 14.

⁷⁸ KERJ dok. 2002, CRI(2003)8.

2. DISKRIMINIMI NË SFERA TË NDRYSHME

Në këtë Kapitull shqyrtohet diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike në Maqedoni, në sfera individuale, si punësimi, arsimit, mallrat dhe shërbimet, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, mediat.

Secila nga këto sfera është strukturuar në mënyrë të ngjashme, duke iu referuar rregullativës konkrete ligjore për atë sferë, ilustrimeve eventuale të rasteve dhe një pjese të përfundimeve dhe rekomandimeve për sferën konkrete.

Për vlerësimin e gjendjes dhe ilustrimin e rasteve, autorët i morrën parasysh rastet e evidentuara të diskriminimit (te Avokatit të Popullit), si dhe rastet e diskriminimit të supozuar në bazë të përkatësisë etnike të shpallura në media.

Për sa u përket rasteve të evidentuara, burimi kryesor ishte zyra e Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë, ku janë paraqitur raste të ndryshme gjatë tre viteve të fundit. Në Gjykatën Kushtetuese ka parashtrës të cilat kanë të bëjnë me dispozitat diskriminuese në disa ligje të caktuara, por nuk është vërejtur ndonjë rast individual i diskriminimit. Gjithashtu, sipas Raportit Vjetor të AP-së për vitin 2009, nuk ka asnjë rast të paraqitur as në gjykatat kompetente.

Gjatë tre viteve të fundit (2007-2009), te Avokati i Popullit janë paraqitur gjithsej 47 raste (6, 21 dhe 20 për tre vitet pasuese). Numri i paraqitjeve individuale është 43. Duhet theksuar se kjo është sipas klasifikimit të vetë institucionit, kurse gjatë paraqitjes, qytetarët shpeshherë janë drejtuar për mbrojtje nga diskriminimi, por gjatë pranimit të rastit dhe bisedës me qytetarin, është konstatuar se bëhet fjalë për diskriminim (jashtë 47 rasteve të përmendura) dhe mandej rasti përpunohet në baza tjera. Nga ai numër, deri në fund të viti 2009, janë zgjidhur 37 raste (10 janë transferuar për vitin 2010). Në zyrën e Avokatit të Popullit janë bërë klasifikime të 40 rasteve sipas bazës dhe sferës së diskriminimit (janë treguar në tabelat e mëposhtme).

Karakteristikë tjetër është se gjatë paraqitjes së rasteve, qytetarët rrallë herë vendosin ta deklarojnë përkatësinë e tyre etnike. Në fakt, vetëm në 9 nga rastet e përmendura është deklaruar përkatësia etnike, edhe atë dy nga paraqitësit janë deklaruar si Maqedonas etnik, tre si Shqiptarë etnik, kurse nga një si pjesëtarë të bashkësisë Rome, Turke, Vllehe ose ndonjë bashkësie tjetër. Nga këtu, është reduktuar mundësia për vlerësimin e diskriminimit sipas përkatësisë etnike (jo vetëm si bazë).

Në vazhdim, pavarësisht nga deklarimi i përkatësisë etnike, nuk janë të gjitha rastet diskriminuese sipas kësaj bazë. Domethënë, AP për herë të parë në raportin e vitit 2009 bëri njëfarë klasifikimi sipas bazave të diskriminimit dhe për atë vit, 9 nga 20 rastet e paraqitura kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Për të tre vitet së bashku, numri i përgjithshëm i rasteve (nga 40 të klasifikuara) sipas kësaj baze është 23, ose 57.5%, që e vërteton tezën se kjo është një nga bazat më të përfaqësuara të diskriminimit tek ne dhe e arsyeton këtë hulumtim. E madhe është edhe përqindja e rasteve (27,5%) për të cilat ende nuk është përcaktuar baza e diskriminimit.

Dhe në fund, nga gjithsej 47 raste, janë zgjidhur 37 dhe vetëm për 9 raste (ose 24%) është konstatuar shkelje e ndonjë të drejte, përkatësisht diskriminim. Përsëri, nga 9 rastet, vetëm në 6 bëhet fjalë për diskriminim në bazë të përkatësisë etnike.

Në çdo rast, numri i vogël i rasteve të evidentuara dhe të zgjidhura e redukton relevancën e vlerësimit dhe e pamundëson sjelljen e përfundimeve me një rëndësi më të përgjithshme.

Shqyrtimi i rasteve të paraqitura në Zyrën e AP-së (2007-2009), në baza diskriminuese

Baza:	2007	2008	2009	Gjithsej	Shkelje
- gjinia	1	2	1	4	1
- mosha					
- hendikepi			1	1	1
- religjioni/besimi					
- përkatësia etnike	3	11	9	23	6
- orientimi seksual					
- përkatësia partiake					
- të tjera	1	8	2	11	1
- statusi social	1			1	
Gjithsej	6	21	13	40	9

Siç shihet, edhe pse gjatë hulumtimeve të mendimit të opinionit publik dominon përkatësia partiake (90%), kurse përkatësia etnike është në vend të dytë (67%), në realitet – rastet në praktikë tregojnë se përkatësia etnike është baza më e shpesh edhe në rastet e paraqitura edhe në rastet ku është konstatuar ekzistimi i diskriminimit.

Zyra e AP-së bëri ndarje edhe sipas sferave të diskriminimit, të grupuara sipas sferave të analizuar në këtë hulumtim (duke e futur shëndetësinë në sferën e mbrojtjes sociale, kurse grupi mallrat dhe shërbimet (në zyrën e AP-së) ndahet në: zgjedhje dhe emërimet, gjyqësi dhe polici).

Shqyrtimi i rasteve të paraqitura në Zyrën e AP-së (2007-2009), sipas sferës së diskriminimit

Sferat:	2007	2008	2009	Gjithsej	Shkelje
- punësimi	2	15	5	22	5
- arsimit					1
- mbrojtja sociale		1	2	3	
- shëndetësia		1		1	
- mallrat dhe shërbimet	3		1	4	1
- zgjedhjet dhe emërimet		1	1	2	
- gjyqësia	1	1		2	
- policia			1	1	
- mediat			2	2	2
- të tjera		2	1	3	
Gjithsej	6	21	13	40	9

Siç shihet në tabelë, sfera më e shpesh e diskriminimit është punësimi (22 nga 40 raste të paraqitura), si dhe 5 nga 9 raste, ose 55%, në të cilat është konstatuar diskriminimi.

Në vazhdim është analizuar një pjesë e këtyre rasteve në sfera të ndryshme, por për shkak të numrit të vogël të rasteve të denoncuara, janë theksuar edhe raste tjera të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike (sidomos ato të ekspozuara në media), si dhe procedura dhe gjendja në të cilat është perceptuar gjendja e diskriminimit. Përndryshe edhe anketa e vërteton dallimin e madh të perceptimit (67%) nga diskriminimi real (20% të qytetarëve mendojnë se kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të sjelljes diskriminuese)

2.1. PUNËSIMI

Mbrojtja nga diskriminimi në sferën e punësimit (dhe profesionit) është sfera më e gjerë e mbulimit me ligj. Në realitet, në atë sferë edhe më së shpeshti paraqitet diskriminimi dhe kjo paraqet bazë të mjaftueshme për rregullimin e diskriminimit me ligj.⁷⁹ Gjatë historisë kanë ekzistuar më shumë shembuj për format e këtilla të diskriminimit. Shpeshherë sjelljet diskriminuese në bazë racore, etnike ose fetare kanë çuar drejt tensioneve në shoqëri. Kështu, diskriminimi i gjatë i Afroamerikanëve në SHBA lindi lëvizjen e të drejtave të njeriut në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar; pastaj rasti me Irlandezët, pjesëtarë të besimit katolik në Irlandën e Veriut, të cilët nuk punësoheshin nga pronarët protestantë të firmave, në vitet e 60-ta e sjell konfliktin në Irlandën e Veriut. Përfaqësimi (jo) i drejtë i Shqiptarëve gjatë punësimit në institucionet shtetërore dhe publike në Republikën e Maqedonisë, pjesërisht përmendej edhe si një nga arsyeve të konfliktit të vitit 2001.

Për arsye të dukurisë së shpesh të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike gjatë punësimit dhe marrëdhënieve të punës,⁸⁰ si dhe pasojat e mundshme nga ekzistimi i tij, udhëzojnë për rregullim më të përpiktë të ligjit për këtë sferë, evitimin e arsyeve për këtë dukuri dhe krijimin e klimës pozitive shoqërore në të cilën mosdiskriminimi, barazia dhe përfaqësimi i drejtë janë parime dhe forma të pranueshme të sjelljes.

Mirëpo, edhe pse çështja e diskriminimit në sferën e punësimit është rregulluar me disa dispozita ligjore në Republikën e Maqedonisë, prapëseprapë në praktikë nuk njihen raste për ngritjen e procedurave gjyqësore para gjykatave të rregullta në vend për përcaktimin e sjelljes diskriminuese.

Bashkimi Evropian këmbëngul në ndalimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike dhe në sferën e marrëdhënieve të punës. Kjo rrjedh nga Direktiva Racore e BE-së,⁸¹ ku në mënyrë decide ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, shqetësimi, viktimizimi dhe nxitja e diskriminimit në bazë të racës dhe përkatësisë etnike në marrëdhëniet e punës.⁸² Gjithashtu, kjo Direktivë u mundëson shteteve anëtare të marrin masa për veprime pohuese, me qëllim të arritjes së barazisë së plotë (reale) në praktikë.⁸³ Me këtë arrihet përparimi

^{79.} Violeta Petroska Beshka dhe Mirjana Najčevska, Raporti hulumtues – Barometri për mundësi të barabarta, Shkup, fq. 37

^{80.} Ibid.

^{81.} Direktiva racore e BE-së, cituar më lartë në fusnotën 5.

^{82.} Ibid, neni 3, par.1, pika a,b,c,d.

^{83.} Ibid., neni 5.

në formulimin e legjislacionit anti-diskriminues duke i respektuar standardet e njëjta.

2.1.1. Rregullativa ligjore

Analiza e rregullativës ligjore për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës gjithashtu paraqitet në më shumë nivele. Nga aspekti i obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, patjetër duhet përmendur Konventën 111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) e cila ka të bëjë me diskriminimin në punësime dhe profesione.⁸⁴ Kjo Konventë e definon diskriminimin në mënyrë të përgjithshme, pa bërë dallim midis diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.⁸⁵ Konventa e ndalon diskriminimin në qasjen në trajnime dhe ritrajnime të cilat janë të nevojshme për punësim, në qasjen e disa punësimeve të caktuara dhe profesioneve, si dhe kushtet e punësimit dhe të drejtat dhe obligimet nga marrëdhëniet e punës.⁸⁶

I rëndësishëm për ndalesën dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sferën e marrëdhënieve të punës është edhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK).⁸⁷ Ky Pakt e garanton të drejtën për punë, të drejtën për të drejtat e veçanta të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, si dhe të drejtën e shoqërimit të punëtorëve.⁸⁸ Nga ana tjetër, duke patur parasysh klauzulën anti-diskriminuese të këtij Pakti, më saktë nenin 2, vendet anëtare obligohen që këto të drejta t'i sigurojnë pa diskriminim (duke përfshirë këtu edhe bazën e përkatësisë etnike) për të gjithë individët nën jurisdikcionin e tyre.⁸⁹

Rregullativa Evropiane gjithashtu siguron mbrojtje nga diskriminimi në sferën e punësimit dhe profesionit me Direktivën e Këshillit 2000/78/EC e 27 nëntorit të vitit 2000 për themelimin e kornizës së përgjithshme për trajtim të barabartë në punësime dhe profesione.⁹⁰ Prapëseprap, duke patur parasysh se kjo Direktivë nuk ka të bëjë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, për hulumtimin tonë më e rëndësishme është Direktiva Racore e BE-së. Kjo Direktivë (Direktiva Racore e BE-së) mbron nga diskriminimi vetëm në bazë të përkatësisë etnike dhe racore, ndërsa ka të bëjë edhe me qasjen në ndonjë punësim dhe profesion, qasjen në disa trajnime dhe rikualifikime të nevojshme për punësim, duke përfshirë këtu edhe punën praktike, kriteret për seleksionimi e kandidatëve

⁸⁴ C 111 Discrimination (Employment and Occupation) Convention, 1958, miratuar më 25.06.1958 në Konferencën e 42 të përgjithshme të ONP-së. Konventa ka hyrë në fuqi më 15.06.1960.

⁸⁵ Ibid., neni 1, para. 1.

⁸⁶ Ibid., neni 1, pika 3.

⁸⁷ PNDESK e cituar më lartë në fusnotën 12.

⁸⁸ Ibid., neni 6, 7 dhe 8.

⁸⁹ Klauzula anti-diskriminuese është paraparë në nenin 2 të PNDESK.

⁹⁰ Direktiva e BE-së për trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punës, cituar më lartë në fusnotën 33:

dhe vetë seleksionimi, kushtet e punësimit dhe të drejtat e marrëdhënies të punës, duke përfshirë edhe kompensimin (rrogën) dhe largimin nga puna, si dhe anëtarësimin në organizatat e punëtorëve (sindikata) dhe beneficinet të cilat dalin nga anëtarësimi i këtyllë.⁹¹

Në rregullativën tonë ligjore, çështja e mbrojtjes nga diskriminimi etnik në sferën e marrëdhënies të punës së pari është trajtuar në Ligjin për Marrëdhënie Pune në vitin 2005.⁹² Pjesërisht çështja e (mos)diskriminimit në mënyrë të tërthortë është rregulluar edhe në Ligjin për Nëpunës Shtetëror. Gjithashtu, kjo sferë është përfshirë edhe në Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i miratuar në prill të këtij viti. Përfshirja e diskriminimit në sferën e punësimit ekziston edhe në disa ligje tjera.⁹³

Deri në miratimin e LPMD-së në prill të vitit 2010, Ligji për Marrëdhënie Pune (LMP) i vitit 2005 ishte një nga ligjet e rralla në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndalon diskriminimin. Kështu, në alinenë 1 të nenit 6 të këtij akti juridik thuhet se "punëdhënësi nuk guxon personin që kërkon punë, kandidatin për punësim ose punëtorin, ta vendos në pozitë të pabarabartë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore, përkatësisht invaliditetit, bindjes fetare, politike ose ndonjë bindjeje tjetër, anëtarësimit në sindikata, prejardhjes nacionale ose shoqërore, statusit familjar, pozitës pronësore, orientimit seksual ose për rrethana tjera personale".⁹⁴

Ky ligj e përcakton dhe ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe shqetësimin. Definicionet përputhen me definicionet e pranuar nga ligjet e BE-së.⁹⁵ Gjithashtu, LMP-ja parasheh edhe mundësi për mbrojtje dhe të drejtë për dëmshpërblim sipas Ligjit për Marrëdhënie Obligative, nëse përcaktohet se një person i caktuar është diskriminuar.⁹⁶ Ngjashëm me Direktivën Racore të BE-së, ndalimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në LMP-në ka të bëjë me "kushtet e punësimit, duke përfshirë këtu dhe kriteret

⁹¹ Direktiva racore e BE, cituar më lartë në fusnotën 5, neni 3, alin 1, pika a,b,c,d.

⁹² Ligji për Marrëdhënie Pune është cituar më lartë në fusnotën 48.

⁹³ Ligji për vullnetarizëm, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 85 nga 09.07.2007, neni 9; Ligji për Shërbim në Ushtri ne RM, Gazeta Zyrtare, nr. 36 nga 15.03.2010; Ligji për Punësim dhe Sigurim në rast të papunësisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 50/2010, neni 1a.

⁹⁴ Ibid, neni 6. Specifike për këtë nen është se përkatësia etnike nuk përmendet në mënyrë decide. Prapsepap, lista e bazave të ndaluara diskriminuese është e hapur, kurse nga ana tjetër, mënyra e definimit të racës në të drejtën ndërkombëtare na lë të konstatojmë se përkatësia etnike është përfshirë në këtë definicion.

⁹⁵ Ibid, neni 7.2, 7.3. 9 dhe 9(a).

⁹⁶ Ibid, neni 10.

dhe kushtet e seleksionimit të kandidatëve për kryerjen e ndonjë pune të caktuar, në cilëndo qoftë degë, përkatësisht departament, në pajtueshmëri me Klasifikimin nacional të veprimtarive dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale; avancimin në punë; qasjen në të gjitha llojet dhe shkallët e trajnimit personal, rikualifikimin dhe kualifikimin plotësues; kushtet për punë dhe të gjitha të drejtat e marrëdhënieve të punës, duke përfshirë këtu dhe barazi në rroga; anulimin e kontratës së punës dhe të drejtat e anëtarëve dhe veprimtaria e tyre në shoqatat e punëtorëve ose në çfarëdo organizatë tjetër profesionale, duke përfshirë këtu dhe beneficionet që dalin nga ky anëtarësim⁹⁷.

Ashtu siç u theksua edhe në pjesën e parë, me LPMD-në, mes tjerash, sigurohet edhe mbrojtja nga diskriminimi në sferën e punësimit. Neni 4 i këtij ligji thotë: “Ky ligj zbatohet nga të gjithë organet shtetërore, organet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, personat juridik me kompetenca juridiko-publike dhe personat juridik dhe fizik në sferën e: 1. Punës dhe marrëdhënieve të punës;...”⁹⁸ LPMD-ja e ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, shqetësimin dhe viktimizimin. Gjithashtu, ky ligj rregullon edhe një procedurë të posaçme për mbrojtjen nga diskriminimi. Si ligj i përgjithshëm, LPMD-ja do të zbatohet në rastet e diskriminimit etnik gjatë marrëdhënieve të punës për ato çështje të cilat nuk janë rregulluar me LMP-në ose kur LMP-ja ofron mbrojtje më të ulët.

Pjesërisht kjo materje është përfshirë edhe në rregullativën ligjore në Ligjin për Nëpunës Shtetëror, ku në mënyrë të tërthortë ndalohet diskriminimi në bazë të prejardhjes nacionale dhe fetare. Kështu, në nenin 12 të këtij ligji thuhet “Punësimi në shërbimin shtetëror kryhet me një procedurë transparente, në bazë të kriterëve të aftësisë dhe profesionalizmit dhe me zbatimin e parimit për përfaqësim përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive.”⁹⁹

Ky ligj promovon qasje të drejtë për vendet e punës në sektorin qeveritar dhe seleksionim në bazë të aftësive. Gjithashtu, sistemi i rrogave dhe kompensimeve i rregulluar me këtë ligj bazohet në parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, parashikueshmërisë dhe proporcionalitetit.

Ajo çka është me rëndësi për diskriminimin etnik dhe që ka të bëjë me punësimin është mundësia e marrjes së masave për veprime pohuese me qëllim të arritjes së barazisë reale në këtë sferë. Në sistemin juridik të RM-së këto masa, në sferën e punësimit rrjedhin nga parimi kushtetues për përfaqësim të drejtë

⁹⁷ Ibid, neni 7.4.

⁹⁸ LPMD, cituar më lartë në fusnotën 5.

⁹⁹ Ligji për Nëpunës Shtetëror (Teksti i refinaruar), Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/2010, neni 12.

dhe të barabartë të të gjithë bashkësive etnike në administratën publike. Ky parim është pasojë e amandamenteve të Kushtetutës në vitin 2001, ku i njëjti parim paraqet vlerë rrënjësore të rendit kushtetues në RM.¹⁰⁰ Ky parim më tej implementohet edhe në shumë ligje tjera, si Ligji për Nëpunës Shtetëror,¹⁰¹ Ligji për Gjykatat,¹⁰² Ligji për Nëpunës Publik¹⁰³ etj. Avokati i Popullit ka kompetenca decide që ta ndjek respektimin e këtij parimi nga ana e organeve, organizatave, ndërmarrjeve dhe institucioneve tjera të cilat janë të obliguara ta respektojnë këtë parim dhe të propozojnë masa për implementimin më të suksesshëm të po të njejtit parim.^{104 105}

2.1.2. Vlerësimi i gjendjes

Statistika e varfër për gjendjen e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike në sferën e punësimit paraqet gjoja një pasqyrë të mirë për këtë çështje. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave (shtojcë) për numrin e të punësuarve në institucionet të cilat janë shfrytëzuese të mjeteve buxhetore të shtetit, në qershor të vitit 2010, në nivelin qendror ka pasur 78.1% të punësuar me përkatësi etnike maqedonase, 16.9% të punësuar me përkatësi etnike shqiptare, 1.3% me përkatësi etnike turke, 1.6% Serbë, 0.6% Vllahë, dhe 0.6% Romë dhe 0.3% Boshnjakë. Kurse në nivelin lokal, 70.3% Maqedonas, 24.4% Shqiptarë, 2.2% Turq, 1.5% Serb, 0.5% Romë, 0.4% Vllahë dhe 0.3% Boshnjakë, kurse 0.8% të punësuar janë me përkatësi tjetër etnike. Të dhënat kanë të bëjnë me numrin e të punësuarve, por jo dhe me shpërndarjen e tyre sipas funksioneve drejtuese. Mirëpo, artikujt dhe tekstet e publikuara në mediat e shtypura dhe elektronike në vendin tonë, paraqesin një gjendje më të ndryshme nga e cila sjellja diskriminuese ekziston në shumicën e sferave, duke përfshirë këtu dhe rastet e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike në fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësimit, si dhe mosrespektimi i parimit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë.

¹⁰⁰ Amandamenti VI i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 91/2001 nga 20.11.2001.

¹⁰¹ Ligji për Nëpunës Shtetëror, cituar më lartë në fusnotën 98, neni 12.

¹⁰² Ligji për Gjykatat, cituar më lartë në fusnotën 56, neni 101, alin. 3.

¹⁰³ Ligji për Nëpunës Publik, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 52/2010 neni 6.

¹⁰⁴ Ligji për Avokatin e Popullit, cituar më lartë në fusnotën 64, nenet 2, 11, 31, 32.

¹⁰⁵ Punësimi i pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike në administratën publike nëpërmjet parimit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, në mënyrë të tërthortë po i përjashton nga mundësia e konkurimit pjesëtarët e bashkësive etnike shumicë. Kjo formë paraqet distinkcion në bazë të përkatësisë etnike, që është parakusht themelor për ekzistimin e diskriminimit. Shih për shembull rastin Kalanke case, C 450/93, 12 tetor 1995 [1995], ECR I-351. Në këtë rast, dhënie të përparësisë kandidatit femër gjatë avancimit në punë, në sektor ku femrat janë më pak të përfaqësuara, sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, paraqet diskriminim në bazë të gjinisë. Prapsepër këtë rregull nuk mund ta zbatojmë në RM, sidomos në kushtet të përfaqësimit të ulët të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike, dhe për arsye të diskriminimit sistematik të pjesëtarëve të këtyre grupeve në të kaluarën (dhe sot). Prapsepër, në të ardhmen do të jetë sfidë zbatimi i përpiktë i parimit "përfaqësimi idrejtë dhe i barabartë".

Për sa u përket personave të papunësuar, sipas të dhënave të fundit (gusht 2010), nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, në numrin e përgjithshëm nga 326,154 personave, sipas përkatësisë etnike (përveç Romëve) papunësia është si vijon: 63% Maqedonas, 24% Shqiptarë, 4% Turq, 5% Romë, 1% Serbë dhe të tjerët me më pak se 1%. Tek Romët papunësia arrin 72%.

Gjithashtu, diskriminimi mund të paraqitet edhe në forma të fshehura, jo vetëm në forma qartë të shprehura dhe agresive të sjelljeve diskriminuese. Ndonjëherë edhe vetë viktima e diskriminimit nuk është në dijeni për veprimet diskriminuese që bëhen ndaj saj. Shpeshherë, veprimet e sjelljes diskriminuese nuk mund të njihen, kurse qytetarët nuk janë mjaft të vetëdijesuar dhe nuk kanë guxim për “luftë” juridike kundër formave të diskriminimit. Arsye për këtë mund të jetë edhe informimi i pamjaftueshëm i tyre për të drejtat e qytetarëve të përcaktuara në disa dispozita ligjore, si dhe për mundësitë për mbrojtje nga diskriminimi. Natyrisht, pjesërisht “faji” mbetet edhe në mosekzistimin e gjatë të një ligji të posaçëm anti-diskriminues.

Në pajtim me pozitën kushtetuese në sistemin juridik, Avokati i Popullit, si organ kompetent për mbrojtjen e të drejtave të garantuara, mes tjerash, merr masa edhe për realizimin e parimit të mosdiskriminimit që përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm dhe nga aktet ndërkombëtare. Sipas Raportit Vjetor mbi punën e Avokatit të Popullit, në vitin 2009, vitin e kaluar janë dorëzuar 20 parashtresa për diskriminim. Nga parashtresat është evidente se dukuritë e sjelljeve diskriminuese më të përhapura janë në sferat të cilat janë posaçërisht të rëndësishme dhe të ndjeshme për realizimin e të drejtave të qytetarëve, gjegjësisht ankesat në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me punësimin dhe të drejtat që dalin nga marrëdhëniet e punës ose përkatësisë etnike.

Duke vepruar sipas lëndëve individuale në të cilat qytetarët kanë paraqitur shkelje të parimit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë për realizimin e të drejtave të marrëdhënieve të punës, Avokati i Popullit u ka dorëzuar rekomandime organeve përkatëse se duhet të veprojnë në pajtim me Amendamentin VI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Në të, si vlerë rrënjësore e rendit kushtetues është paraparë edhe përfaqësimi i drejtë dhe i barabartë i qytetarëve të gjithë bashkësive, në organet e pushtetit shtetëror edhe në institucionet tjera publike në të gjitha nivelet.

Ashtu siç konstatohet edhe në vetë Raportin e AP-së, numri i lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi është i ulët. Avokati i Popullit konsideron se kjo ndodh kështu sepse qytetarët edhe pse ndiejnë se janë të diskriminuar, këtë e përmendin edhe në parashtrësat e tyre, ende nuk kanë guxim të kërkojnë që procedurat e rasteve të këtilla të drejtohen si baza diskriminimi, por është edhe vështirë të vërtetohen. Për këto arsye, gjegjësisht insistimet e qytetarëve, Avokati i Popullit procedurat për rastet e këtilla i drejton në sfera në të cilat të drejtat e qytetarëve janë të cënuara në mënyrë direkte. Në realitet, siç është theksuar në Raport, diskriminimi mund të jetë fshehur pas shkeljeve të disa të drejtave të caktuara.

Statistika për numrin e vogël të parashtrësave të dorëzuara nga lëmia e diskriminimit, interpretohet edhe me sqarimin se mund të bëhet fjalë për mungesë të plotë të vetëdijes së qytetarëve për problemin e diskriminimit, mungesë të njohurisë nga qytetarët për mundësinë e dorëzimit të këtyre kërkesave te Avokati i Popullit, mosbesimi i qytetarëve në këtë institucion kur bëhet fjalë për rastet e diskriminimit, ose thjeshtë, mungesa e mirëbesimit se ky institucion mund të bëjë diçka për zgjidhjen e problemit.¹⁰⁶

Përveç Gjykatës Kushtetues dhe Avokatit të Popullit, mekanizma tjera mbrojtëse tek të cilat mund të ngrihet çështja e diskriminimit janë edhe Komisioni Permanent Anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, Komisioni për Mundësi të Barabarta për femrat dhe meshkujt dhe Komiteti për Marrëdhënie midis Bashkësive, Përfaqësuesi për Barazi midis femrave dhe meshkujve pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, si dhe gjykatat.

Megjithatë, për fat të keq, deri më tani edhe përkundër asaj se ekzistojnë disa mekanizma juridike për mbrojtje nga diskriminimi, e gjithashtu një pjesë e kësaj materie pjesërisht është rregulluar dhe në disa dispozita të ligjeve të lartpërmendura (sidomos në Ligjin për Marrëdhënie Pune), prapëseprapë, deri më tani në praktikën gjyqësore nuk është vërejtur ndonjë rast në vendin tonë në të cilin është ngritur ndonjë procedurë gjyqësore për përcaktimin e diskriminimit ose sjelljes diskriminuese.

Një nga vlerat fundamentale të rendit kushtetues në vendin tonë, e theksuar në Amendamentin VI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë,¹⁰⁷ është edhe respektimi i parimit për përfaqësim të drejtë dhe barabartë. Në funksion

¹⁰⁶ <http://www.mcms.org.mk/images/docs/2010/analiza-na-megjunarodnite-standardi-i-najdobri-praktiki-2010.pdf>

¹⁰⁷ Kushtetuta e RM-së, cituat më lartë në fusnotën 9.

të mbikëqyrjes së gjendjeve me përfaqësim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë bashkësitë dhe barazia gjinore, Avokati i Popullit në analizën e të dhënave për vitin 2009 thekson se mund të vërehet një përparim i vogël në pjesën e realizimit të parimit për përfaqësim të drejtë dhe barabartë, por përsëri mbetet konstatimi se shumica e institucioneve ende nuk e kanë arritur nivelin e duhur të përfaqësimit.¹⁰⁸

Gjithashtu, është konstatuar se organet e aparatit shtetëror e realizojnë këtë parim më intensivisht për dallim nga ndërmarrjet publike ku përfaqësimi në përqindje i pjesëtarëve të bashkësive me vite të tëra nuk përputhet me parimin e garantuar me Kushtetutë. Kështu, Avokati i Popullit si shembull negativ e thekson Ministrinë e Shoqërisë Informatike, në të cilën vetëm 5% të punësuarve u takojnë bashkësive jo shumicë në Maqedoni.¹⁰⁹ Gjithashtu, kjo gjendje ekziston edhe në një numër të madh të organeve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike, si dhe në Komisionin për Letra me vlerë, Agjencia për Përkrahje Financiare të Bujqësinë dhe të Zhvillimit Rural, Ndërmarrja Publike Strezhevë Manastir, Ndërmarrja Publike Studençica-Shkup, NP Zletovica-Probishtip.¹¹⁰ Në nivel të pakënaqshëm është përfaqësimi i pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike edhe në organet e jurisprudencës, kurse më të goditur janë pjesëtarët e bashkësive më të vogla, si Romët dhe Turqit.¹¹¹

Sipas Avokatit të Popullit, parimi i garantuar me Kushtetutë për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë ende nuk është mjaft i afirmuar, gjegjësisht duhet të merren masa dhe veprime të vazhdueshme për implementimin e plotë të tij në organet e aparatit shtetëror dhe në institucionet tjera publike.

Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e mbështet Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për realizimin e prioritetit strategjik lidhur me obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja Kornizë, por sidomos për sigurimin e përfaqësimit të drejtë të qytetarëve nga të gjithë bashkësitë, në organet e pushtetit qendror dhe në institucionet tjera publike. Por, prapëseprapë, statusi, kompetencat dhe roli i këtij Sekretariati mbeten të paqarta dhe duhet të nxitet veprimi dhe definimi më konkret për punët, për shkak të evitimit të diskriminimit të mundshëm, si etnik ashtu dhe politik.

¹⁰⁸ Raporti Vjetor i AP-së për vitin 2009, cituar më lartë në fusnotën 105.

¹⁰⁹ Avokati i Popullit Informacione për mbikëqyrjen e zbatimit të parimit për përfaqësim të drejtë dhe përkatës dhe mosdiskriminimi, Shkup, 2010, faq. 21.

¹¹⁰ Ibid.

¹¹¹ Ibid.

Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmerr aktivitete të vazhdueshme për realizimin e parimit për përfaqësim të drejtë dhe barabartë të pjesëtarëve të bashkësive, por i çuditshëm është fati dhe statusi i shumë të punësuarve të ri, të cilët edhe pse janë të punësuar dhe janë në listën e pagesës, prapsepap, nuk janë të ftuar të kryejnë detyra konkrete, por “rrinë ulur” në shtëpi dhe nuk kanë të caktuar ndonjë pozitë pune konkrete dhe për këtë presin me muaj të tërë, kurse ka raste kur dikush pret edhe me vite.¹¹² Numri i kësaj kategorie të punësuarish vazhdon të rritet edhe më tej duke pasur parasysh punësimet e reja. Nga ana tjetër, josistematizimi i tyre jo vetëm që është i pajustificuar nga aspekti ekonomik, por ndikon edhe në mbijetimin e diskriminimit në shoqëri dhe në cenimin e dinjitetit të tyre duke marrë parasysh faktin se pushteti i konsideron “të panevojshëm”.

Përpilimi i Programit për punësimin e pjesëtarëve të bashkësive bazohet në analizën e kryer të Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë dhe në informacionet e pranuar nga planet vjetore të ministrive dhe organeve tjera të aparatit shtetëror, si dhe në të dhënat e pranuar nga ndërmarrjet publike për përfaqësimin e bashkësive etnike jo shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë përpilimit të Programit janë marrë parasysh edhe rekomandimet e dala nga Strategjia për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, si dhe rekomandimet e Planit Strategjik të Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ku janë përmbajtur masat dhe aktivitetet për përmirësimin e përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë.¹¹³ Sekretariati merr masa dhe aktivitete konkrete për realizimin e Strategjisë për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë të bashkësive jo shumicë në Republikën e Maqedonisë, si dhe Planin Vjetor për punësimin e bashkësive etnike i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Në kontekst të përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë në administratën publike dhe shtetërore, sipas të dhënave të Sekretariatit, gjatë vitit 2009 dhe fillimit të vitit 2010, ka pasur shpallje të konkurseve për punësim të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë në vend dhe janë realizuar 777 punësime të pjesëtarëve të bashkësive etnike jo shumicë. Në procedurë e sipër janë edhe 250 punësime të reja të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë më të vogla etnike (Turq, Romë dhe të tjerë).

¹¹² Punësime masovike në ngarkesë të shtetit, Vreme, 20.08.2010 .

¹¹³ <http://siofa.gov.mk/mk/index.php?news=135>

Në këtë drejtim, sipas të dhënave të Sekretariatit, gjatë vitit 2009, ka pasur shpallje të konkurseve për punësime të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë në vend dhe janë punësuar gjithsej 470 realizues, nga të cilët 301 me arsim të lartë dhe 106 me arsim të mesëm. Sipas Raportit të BE-së për përparimin e RM-së për vitin 2010, përfaqësimi i bashkësive jo shumicë në administratën publike ka arritur në 29%.¹¹⁴

2.1.3. Rrëfime të rasteve

Nga shembujt praktik të theksuar në Raportin për punën e Avokatit të Popullit për vitin 2009, e veçojmë rastin në të cilin është konstatuar diskriminim. Në fakt, një qytetar në parashtresën e dorëzuar Avokatit të Popullit ka theksuar se është punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes si person aktiv ushtarak dhe se mendon se diskriminohet në bazë nacionale, gjegjësisht se përkatësia etnike e tij ka qenë pengesë për realizimin e masave stimuluese.¹¹⁵

Avokati i Popullit, duke vepruar në bazë të parashtresës ka rekomanduar ndalim të diskriminimit në të gjitha bazat, si dhe të drejtën e garantuar ligjore dhe kushtetuese për barazi të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Pas rekomandimit të Avokatit të Popullit, parashtruesi është shpërblyer me shtatë ditë pushim për mundin e bërë dhe për rezultatet e realizuara në funksionimin dhe aftësimin luftarak të njësisë së tij.

Më tej, APM ka pasur parashtresë nga një grup i qytetarëve të cilët kanë treguar për shkelje të drejtave nga marrëdhëniet e punës. Ato janë informuar se do tu ndërrohet vendi i punës nga një organ shtetëror në tjetrin, edhe që ka ndodhur.

Pas ndërmarrjes janë informuar se duhet ta japin provimin përgatitës, pas të cilit iu është dhënë vendim për lëshim nga puna duke iu referuar nenit 99 alineja 2 nga Ligji për marrëdhënie pune, me të cilin parashihet se nuk e kanë kryer me sukses punën provuese.

Duke pasur parasysh këtë që tha, APM ka konstatuar se vendimet për lëshim nga puna janë të paligjshme dhe se i gjithë rasti nuk përmban elemente të diskriminimit, për të cilin kanë thënë parashtruesit. Për këto shkaqe, APM ka ngritur në procedurë dhe kanë kërkuar rishqyrtim të plotë të procedurës, ndërsa i kanë këshilluar kërkuesit që të kërkojnë edhe mbrojtje gjyqësore me qëllim të mos lëshojnë afatet gjyqësore.

¹¹⁴ Komisioni Evropian, Raporti mbi Përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2010, KOM(2010)660

¹¹⁵ Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2009, cituar më lartë në fusnotën 105.

Edhe pas këshillimit të dhënë, organi nuk i ka pranuar ankesat e parashtresve të parashtresës, por gjykata i ka pranuar kërkesat e tyre paditëse dhe i ka kthyer në punë.

Për fat të keq, në praktikën e Avokatit të Popullit, të rralla janë parashtresat e sferës së diskriminimit në bazë etnike në sferën e punësimit, gjë që tregon se, për shkak të arsyeve të përmendura më lartë në këtë hulumtim, numri i rasteve të këtilla nuk domethënë të jetë i vogël në jetën e përditshme.

2.1.4. Përfundime dhe rekomandime

Përfundimet

2.1.1. Diskriminimi në marrëdhëniet e punës është një nga format më të përhapura të diskriminimit. Një pjesë e rasteve në këtë sferë janë edhe në bazë të përkatësisë etnike.

Nga aspekti i legjislacionit, Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (LPMD) dhe Ligji për Marrëdhënie Pune (LMP) e sanksionojnë diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike në marrëdhëniet e punës dhe ofrojnë mbrojtje solide nga diskriminimi. Prapëseparë, mbetet që më shumë të punohet në zbatimin efikas të këtij legjislacioni.

2.1.2. Krahas ndalesës për diskriminim, për përmirësimin e gjendjes ndikon edhe parimi kushtetues për përfaqësimin e drejtë dhe të barabartë të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë në administratën publike. Ky parim kushtetues zbatohet edhe në ligje tjera, kurse deri më tani në administratën shtetërore janë punësuar 25% të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë.

2.1.3. Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë kujdeset për realizimin efikas të parimit për përfaqësim të drejtë dhe barabartë. Sekretariati në periudhën e fundit njëvjeçare ka realizuar rreth 1.000 punësime në administratë pikërisht me ndihmën e këtij parimi.

2.1.4. Megjithatë, perceptimi i qytetarëve është se diskriminimi është më i shpeshtë pikërisht gjatë punësimit (dy herë më shumë mendojnë se ka favorizim të disa bashkësive etnike gjatë punësimit, veçanërisht në sektorin shtetëror), ndërsa 81% prej tyre nuk e arsyetojnë këtë.

Rekomandimet

2.1.1. Nevojitet respektimi i vazhdueshëm i parimit për përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, sidomos në disa institucione shtetërore ku përfaqësimi

është i ulët. Këtu përfshihen edhe institucionet në nivelin lokal, ku bashkësia shumicë bëhet pakicë. Gjithashtu, punësimet e realizuara me këtë parim duhet të theksohen më me cilësi, përkatësisht të caktohen funksionet në të cilat punësohen këto pjesëtarë.

- 2.1.2. Kujdes të veçantë duhet pasur në diskriminimin etnik gjatë punësimit në sektorin privat. Në këtë sektor ekzistojnë mundësi më të mëdha për diskriminim të fshehur, sidomos në pjesën e seleksionimit të lirë të kandidateve për ndonjë vend pune të caktuar. Duhet të insistohet në zbatimin konzistent të LMP-së në pjesën që ka të bëjë me mbrojtjen nga diskriminimi.
- 2.1.3. Duhet të bëhen analiza përkatëse që të konstatohet se në cilat sfera duhet të zbatohen masa pohuese. Posaçërisht, nevojitet të ndërmerren masa për përmirësimin e punësimit të Romëve si bashkësi më pak e përfaqësuar. Rritja e punësimeve të Romëve do të duhet të ndikojë pozitivisht në pozitën e tyre shoqërore, sidomos në drejtim të zbutjes së varfërisë.

2.2. ARSIMI

Diskriminimi në arsim është i njohur pothuaj në çdo shoqëri. Megjithatë, ai nuk paraqitet në formë të njëjtë. Diku diskriminohen personat në mundësinë që të kenë qasje deri te programet dhe institucionet e caktuara arsimore, diku diskriminimi paraqitet në pikëpamje të gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi dhe në cilën gjuhë është shkruar literatura që përdoret, diku diskriminimi në arsim paraqitet në formë të segregacionit fizik të nxënësve nga grupe të ndryshme etnike; ndonjëherë edhe qasja e kuadrit mësimor ndaj nxënësve nuk është i njëjtë, gjegjësisht mund të jetë diskriminues.

Diskriminimi mund të kryhet nga ana e shtetit dhe institucioneve të tij ose nga individë. Në rastet kur diskriminimi është kryer nga individët, përgjegjësia e shtetit është që ta pengojë dhe ta sanksionojë të njëjtën. Në numër të madh të rasteve diskriminimi ndodh për shkak të prezencës së stereotipave dhe paragjyqimeve ndaj individëve ose ndaj pjesëtarëve të një grupi të caktuar.¹¹⁶ Maqedonia nuk paraqet përjashtim në këtë fushë. Diskriminimi në fushën e arsimit ekziston në RM, krahas tjerave edhe në bazë të përkatësisë etnike. Forma e paraqitjes së diskriminimit është specifike, që është lëndë e këtij hulumtimi.

¹¹⁶ Doracak për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2.2.1. Rregullativa ligjore

Në Maqedoni diskriminimi kufizohet në numër të madh të fushave, duke përfshirë edhe arsimin. Kjo del nga rregullativa adekuatë ndërkombëtare dhe e vendit, e cila i promovon parimet e jo diskriminimit, tolerancës dhe afrimit të ndërsjellë dhe pranimi në kuadër të sistemit edukativo-arsimor. Gjithashtu ekziston rregullativë ligjore e cila parasheh mekanizma të caktuar dhe e sanksionon diskriminimin nga më shumë aspekte në jetën shoqërore, mes të cilave gjendet edhe e drejta e arsimit si e drejtë e njeriut.

Nga rregullativa ndërkombëtare, numër i madh i instrumenteve e garantojnë të drejtën e arsimit, si edhe qasjen e barabartë deri te e njëjta. Kështu do të numërojmë Deklaratën universale për të drejtat e njeriut (neni 7 dhe 26);¹¹⁷ Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (CERD, neni 7);¹¹⁸ Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (MPESKP, neni 13 dhe 2);¹¹⁹ Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në arsim (neni 1);¹²⁰ Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (neni 28);¹²¹ Konventa për të drejtat e personave me handicap (neni 24);¹²² Deklarata për të drejtat e personave të cilët i përkasin pakicave nacionale ose etnike, religjioze, dhe gjuhësore (neni 4, alineja 4)¹²³; KEDNJ (neni 14),¹²⁴ Protokollin 1 neni 2 dhe Protokollin 12 drejt KEDNJ,¹²⁵ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale (neni 6 dhe 12);¹²⁶ Rekomandimi Rec (2009)4 i Komitetit të Ministrave deri te shtete anëtare për arsimimin e romëve dhe udhëtarëve.

Në këto instrumente, në mënyra të ndryshme, qaset drejt të drejtës për arsimim. Megjithatë, në përgjithësi, së pari garantohej e drejta e arsimit për të gjithë, e dyta, ndalohej diskriminimi mbi cilëndo qoftë bazë, duke përfshirë edhe përkatësinë etnike, në qasjen deri te arsimimi. Instrumentet të

¹¹⁷ Deklarata universale për të drejtat e njeriut, Asambleja e Kombeve të bashkuara, 10 dhjetor 1948, <http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Language.aspx?LangID=mkj>.

¹¹⁸ CERD, e cituar më sipër, fusnota 3.

¹¹⁹ MPESKP, e cituar më sipër, fusnota 12.

¹²⁰ Konventa kundër diskriminimit në arsim, e miratuar në Asambleenë e UNESCO në Paris, më 4 dhjetor 1960, ndërsa ka hyrë në fuqi më 22 maj 1962. Mund ta gjen në ueb faqen http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=12949&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html#ENTRY.

¹²¹ Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, e cituar më sipër, fusnota 13

¹²² Konventa për të drejtat e personave me handicap, Kombet e Bashkuara, 13 dhjetor 2006, <http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=259>

¹²³ Deklarata për të drejtat e personave që i takojnë pakicave nacionale ose etnike, religjioze dhe gjuhësore, Asambleja e Kombeve të bashkuara, 18 dhjetor 1992, <http://www.ohchr.org/english/law/minorities.htm>

¹²⁴ KEDNJ, e cituar më sipër, fusnota 14.

¹²⁵ Protokollin 12 drejt KEDNJ, e cituar më sipër, fusnota 15.

¹²⁶ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, e cituar më sipër, fusnota 16.

cilat kanë të bëjnë me pakicat e garantojnë edhe mundësinë e arsimimit në gjuhën amtare (Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, neni 14). Gjithashtu, disa instrumente mundësojnë ndërmarrjen e masave afirmative me qëllim që disa grupeve tu sigurohet gëzimi efektiv i të drejtave të garantuara (CERD, neni 2.2).

Nga rregullativa e vendit duhet të theksohet veçanërisht Ligji për arsim fillor (neni 2);¹²⁷ Ligji për arsim të mesëm (neni 3);¹²⁸ Ligji për arsim të lartë (neni 108.4)¹²⁹ Ligji për tekste shkollore (neni 3);¹³⁰ Ligji për inspektim arsimor (neni 2);¹³¹ Ligji për Byronë për zhvillimin e arsimit (neni 5)¹³² dhe Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.¹³³ Në këto ligje ekzistojnë dispozita të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin, ndërsa shumë e rëndësishme është që këto ligje plotësohen me LPMD. Në të vërtetë, LPMD aplikohet edhe në fushën e arsimit, me çka plotësohen të gjitha zbrazëtitrat eventuale të cilat ekzistojnë në ligjet tjera, ndërsa të tillë ekzistojnë. LPMD në mënyrë konzistente e defnon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe indirekt, shqetësimin dhe viktimizimin (nenet 6-10); parasheh mundësi për ndërmarrjen e aksioneve afirmative (neni 13) dhe mundësia për përdorimin e gjuhës së pjesëtarëve të cilët nuk janë shumicë në procesin arsimor (neni 15.8); parasheh edhe procedurë të veçantë gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi (neni 34-41). Dispozitat e këtilla nuk ekzistojnë në ligjet e veçanta të cilat kanë të bëjnë me arsimin, me çka në këtë aspekt, LPMD paraqitet si i vetëm.

2.2.2. Vlerësimi i gjendjes në shkollat

Në Maqedoni, mësimi në sistemin edukativ arsimor zhvillohet në disa gjuhë. Mësimi i rregullt zhvillohet në gjuhën mësimore maqedonase, shqipe, turke dhe serbe. Bashkësitë tjera, siç është ajo vllahe, boshnjake dhe rome, mësimin e rregullt në sistemin edukativ arsimor e ndjekin në gjuhën maqedonase ose në ndonjërin nga gjuhët tjera. Këto bashkësi gjuhën e tyre amtare dhe kulturën e mësojnë përmes lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllëve, boshnjakëve dhe romëve që fillon të zhvillohet sipas zgjedhjes së prindërve të nxënësve nga klasa e tretë e deri në fund të arsimit fillor.

¹²⁷ Ligji për arsim fillor, i cituar më sipër, fusnota 51.

¹²⁸ Ligji për arsim fillor, i cituar më sipër, fusnota 52.

¹²⁹ Ligji për arsim të lartë, i cituar më sipër, fusnota 53...

¹³⁰ Ligji për tekste shkollore, Gazeta zyrtare e RM, nr. 98/08 dhe 99/09

¹³¹ Ligji për inspektim arsimor, Gazeta zyrtare e RM, nr. 52/05 dhe 148/09

¹³² Ligji për Byronë për zhvillimin e arsimit, Gazeta zyrtare e RM, nr. 37/06, 142/08 dhe 148/09

¹³³ LNMD, i cituar më sipër, fusnota 7.

Në territorin e Republikës së Maqedonisë ka gjithsej 341 shkolla fillore. Në ato mësimi realizohet në katër gjuhë mësimore, në gjuhën maqedonase, shqipe, serbe dhe turke. Prej tyre, në 241 (70,6%) organizohet mësimi në një gjuhë mësimore, prej të cilave në 185 (77%) – në gjuhën maqedonase, në 55 (22,8%) – në gjuhën shqipe dhe në 1 (0,4%) – në gjuhën turke.

Nga numri i përgjithshëm i shkollave (341), në 85 (25%) – mësimi zhvillohet në dy gjuhë mësimore, prej të cilave në 59 (69%) – mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe shqipe, në 20 (23,5%) – në gjuhën maqedonase dhe turke dhe në 3 (3,5%) shkolla – në gjuhën maqedonase dhe serbe.

Mësimi në tre gjuhë zhvillohet në gjithsej 15 (4,4%) shkolla. Prej tyre 13 (86,6%) mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke dhe 2 (13,3%) – në gjuhën mësimore maqedonase, shqipe dhe serbe¹³⁴.

Në raport me numrin e nxënësve sipas përkatësisë etnike, vijojnë të dhënat nga MASH në tabelat më poshtë.

Gjendja lidhur me nxënësit, numri i përgjithshëm i nxënësve të cilët e ndjekin mësimin nga lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura

	<i>Num. i përgj. i nxënësve</i>	<i>Nxënës në lëndën zgjedhore</i>	<i>%</i>
Boshnjakë	2014	377	18,71 %
Vlleh	307	716	/
Romë	10.551	2.191	20,76 %

Gjendja lidhur me nxënësit, numri i përgjithshëm i nxënësve të cilët e ndjekin mësimin në gjuhën e vet amtare

	<i>Num. i përgj. i nxënësve</i>	<i>Nxënësit të cilët e ndjekin mësimin në gjuhën amtare</i>	<i>%</i>
Serbë	1.771	274	15,47%
Turq	9.047	3.390	37,47% ¹³⁵

Nga të dhënat në tabelat mund të vërehet se ekziston % e ulët/e vogël e nxënësve pjesëtarë të bashkësive të cilët e ndjekin mësimin e rregullt ose mësimin zgjedhor në gjuhën e vet amtare. Për këtë shkak paraqitet nevoja nga aplikimi konsekuent i procedurës për informim të prindërve për mësimin e rregullt dhe zgjedhor në gjuhën e bashkësive nga ana e shkollave.

¹³⁴ Gjendja në arsimin fillor të fëmijëve të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, qershor 2010.

¹³⁵ Ibid.

Sa i përket gjendjes me kuadrin mësimor, duke pasur parasysh përkatësinë e tyre etnike, situata është si vijon:

Gjendja lidhur me kuadrin mësimor, numrin e përgjithshëm të arsimtarëve dhe numrin e arsimtarëve pjesëtarë të bashkësive

Përkatësia etnike	% e bashkësisë nga % e përgjithshme e popullatës në RM	Numri i arsimtarëve pjesëtarë të bashkësive	% e atyre arsimtarëve të inkuadruar në mësim
Bosnjakë	0,84%	50	0,35%
Vlleh	0,47%	/	/
Romë	2,66%	24	0,16%
Serbë	1,77%	/	/
Turq	3,85%	366	2,57%
Numri i arsimtarëve në arsimin fillor			14.189

Nga tabela mund të vërehet se ekziston % shumë e ulët e arsimtarëve pjesëtarë të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, të cilët janë të inkuadruar në procesin e rregullt edukativ arsimor, duke pasur parasysh përfaqësimin procentual të këtyre bashkësive në popullata e përgjithshme në Maqedoni dhe numrin e përgjithshëm të arsimtarëve të inkuadruar në mësimin e rregullt.

Në raport me librat shkollor, deri në vitin e kaluar (2008/09) ekzistonte problem serioz rreth përfshirjes së të gjitha lëndëve me tekste shkollore në gjuhën e bashkësive. Këtë vit shkollor Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pajtim me projektin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, siguroi tekste shkollore për të gjitha lëndët në arsimin fillor në gjuhën mësimore turke dhe për një pjesë të lëndëve të cilat zhvillohen në drejtimet e gjimnazit në shkollimin e mesëm. Gjithashtu janë siguruar edhe librat shkollor të domosdoshëm për lëndët në gjuhën mësimore serbe. Në raport me lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e Vllehve, boshnjakëve dhe romëve, për herë të parë këtë vit shkollor 2010/11 Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi dorëshkrime për librat shkollor për klasën e tretë, të katërt dhe të pestë për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllehve dhe romëve, për boshnjakët akoma nuk janë siguruar për shkak të interesimit të dobët të autorëve për dorëzimin e dorëshkrimeve të veta për tekste shkollore. Të gjitha këto tekste shkollore të cilat janë siguruar këtë vit gjenden në fazën e përkthimit dhe shtypit¹³⁶.

¹³⁶ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria për zhvillimin dhe avancimin e gjuhës së pjesëtarëve të bashkësive.

Për nevojat e këtij hulumtimi, pikë nisjeje ishte Doracaku për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë, i përgatitur nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me Qendrën Nacionale Rome nga Kumanova.

Sipas rezultateve të tyre janë prezantuar pikëpamjet lidhur me termin e diskriminimit të gjitha subjekteve të inkuadruar në sistemin edukativo-arsimor të prezantuara më poshtë.

- 1. Drejtorët dhe shërbimet pedagogjike-psikologjike në shkollat** – në shumicën e shkollave ku u mbajtën takimet e punës me drejtorët dhe shërbimet profesionale del se një numër i vogël i shkollave në programet vjetore për punë të shkollave, planifikojnë aktivitete për kultivimin dhe zhvillimin e dallimeve dhe vlerave multikulturore. Këto çështje shpesh i përpunojnë në kuadër të disa lëndëve mësimore (shpesh përmendet lënda nga *edukimi qytetar*) dhe gjatë shënimit të kremtimeve të ndryshme nacionale dhe fetare dhe ditës së shkollës. Dobësi të veçantë paraqet ajo që shkollat nuk kanë informata për fëmijët të cilët janë në moshë shkollore, ndërsa nuk janë të përfshirë me sistemin edukativo-arsimor. Një pjesë prej tyre theksuan se informatat për fëmijët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim në klasën e parë i marrin nga përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve, të cilët punojnë në fushën e arsimit. Implementimin e masave afirmative, një numër i madh i shkollave, rregullisht i realizojnë gjatë regjistrimit të nxënësve romë në shkollat e mesme, në pajtim me kushtet konkurruese të cilat i cakton Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe aktivitetet e projektit të shoqatave të qytetarëve për dhënien e bursave dhe mentorimin e nxënësve romë të shkollave të mesme.
- 2. Arsimitarët/profesorët** – presin që aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me kultivimin e vlerave multikulturore dhe tolerancës të planifikohen në programin vjetor të shkollave. Aktivitetet që planifikohen ti përfshijnë aktivitetet mësimore dhe jashtë mësimi dhe aktivitetet e projekteve. Në krahasim me diskriminimin në shkolla, arsimtarët/profesorët mendojnë se nuk është me përmasa brengosëse. Më shpesh përmendet diskriminimi social për shkak të gjendjes së vështirë socio-ekonomik, veçanërisht te pjesëtarët e bashkësisë rome.
- 3. Inspektorët arsimor** – kompetencat dhe autorizimet e inspektoratit arsimor janë në nivel lokal dhe shtetëror dhe janë të ndara në mënyrë

adekuate. Në nivel lokal, një pjesë të kompetencave dhe autorizimeve i kanë inspektorët e autorizuar komunal arsimor, ndërsa në nivel shtetëror, një pjesë të kompetencave dhe autorizimeve i kanë inspektorët arsimor shtetëror. Parashikimet tregojnë se ka trend të fuqishëm drejt përfshirjes së plotë të popullatës rome në procesin edukativo-arsimor edhe krahas problemeve me mungesën e dokumentacioneve personale për një pjesë të tyre. Mbajtja e tyre në procesin edukativo-arsimor është përmirësuar, por akoma brengos fakti për largimin e parakohshëm, veçanërisht largimi në kohë nga shkolla për shkak të emigrimit të familjes në kërkesë për punë, në kohën e punëve stinore. Arritjet e fëmijëve romë përmirësohen, por akoma janë të ulëta në krahasim me arritjet mesatare të nxënësve në shkolla. Paragjykimet dhe stereotipat janë prezente, por është i pranishëm trend i rënies.

4. **Prindërit** – të gjithë prindërit të cilët u përfshinë me anketën, theksuan se informatat rreth regjistrimit të fëmijëve të tyre në shkollimin fillor dhe të mesëm, i marrin gjegjësisht informohen në vetë shkollat dhe përmes medieve. Në pjesën e njohjes së të drejtave dhe obligimeve të tyre si prindër përfunduar se gjysma e të inkuadruarve shumë mirë i njohin të drejtat dhe obligimet e veta, deri sa, të tjerët aspak nuk dinë për të drejtat dhe obligimet e tyre. Në përgjithësi prindërit janë të kënaqur nga raporti i arsimtarëve ndaj fëmijëve të tyre dhe rregullisht marrin pjesë në mbledhjet prindërore. Kur paraqitet ndonjë problem më së shpeshti i drejtohen drejtorit, shërbimeve profesionale dhe vetë kujdestarëve të klasës ose udhëheqësve të klasës.
5. **Nxënësit** – nga anketa me nxënësit përfunduar se prindërit janë të interesuar dhe i mbështetin fëmijët e tyre edhe krahas kushteve të këqija socio-ekonomike, me të cilat ballafaqohen çdo ditë. Nxënësit theksuan se prindërit e tyre pa kurrfarë problemi u lejojnë të shkojnë në shkollë. Të gjithë nxënësit theksuan se kanë shokë në shkollë nga të gjitha bashkësitë etnike. Në përgjithësi, janë të kënaqur nga raporti i arsimtarëve ndaj tyre dhe çdo herë kur kërkojnë ndihmë, e marrin të njëjtën. Pjesa më e madhe e nxënësve nuk ndjekin mësim plotësues, pasi që nuk organizohet në shkollë, e atje ku është i organizuar, nuk marrin pjesë me vullnetin e tyre.

2.2.3. Rrëfime të rasteve

a) Rasti i Strugës

Për këtë pjesë të hulumtimit u shfrytëzua studimi i rastit – Strugë, i bërë nga ana e Misionit të OSBE në Shkup, për nevojat e hulumtimit Moshë, Kontakti, Perceptimet – Si shkollat i formojnë marrëdhëniet mes bashkësive etnike, të botuar në janar të vitit 2010.

Qyteti i Strugës u zgjodh si studim i rastit duke i marrë parasysh të dhënat e marra për nivelin e lartë të ndjenjave armiqësore mes nxënësve – dy bashkësitë më të përfaqësuara etnike, maqedonasit dhe shqiptarët. Qëllimi është të jepet pasqyrë e indikatorëve individual me qëllim të shihen se cilat janë shkaqet e mundshme për nivelin e lartë të tensionit mes nxënësve nga të dy bashkësitë.

Siç u tha më sipër, në Strugë pothuaj të gjithë pjesëtarët e grupit të njëjtë etnik të cilët janë përgjigjur në pyetjen se ndaj cilit etnikum kanë **ndjenja negativ**, dhanë përgjigje të njëzëshme, do të thotë pjesa dërmuese e maqedonasve kanë shprehur perceptime negative ndaj shqiptarëve dhe anasjelltas. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se pak më shumë se gjysma e nxënësve (nga të dy etnikumet) aspak nuk janë përgjigjur në pyetjen. Kjo është e dhënë interesante dhe mund të thotë se ata frikësohen ta shprehin mendimin e tyre, duke marrë parasysh tensionet etnike të cilat ndodhin në qytet gjatë vitit të kaluar shkollor (2008/09).

Edhe pse jetojnë dhe mësojnë në mjedise të përziera etnike, nxënësit maqedonas dhe shqiptarë, relativisht kanë **kontakt të ndërsjellë**. Vetëm rreth një e treta (30,8% nga maqedonasit dhe 34,9% nga shqiptarët) janë deklaruar se kanë kontakte të pastra të ndërsjella, deri sa numri më i madh i tyre kanë kontakte të rralla ose aspak nuk kontaktojnë. Edhe kontaktet me grupet tjera etnike janë të rralla (veçanërisht me romët), që flet për atë se nxënësit zakonisht janë të mbyllur në kuadër të grupit të vet etnik dhe kontakteve të ndërsjella, me siguri, paraqiten si rezultat i nevojës së jashtme (për shembull, ngjarje në kuadër të shkollës), e më pak i iniciativës personale.

Pjesa më e madhe e nxënësve nga të dy grupet etnike (88% maqedonas dhe 74% shqiptarë) **shkaqet për armiqësitë në shkollë** i shohin në ndikimin e partive politike. Megjithatë, dukshëm më shumë shqiptarë se sa maqedonas (63%

përkundër 21,7%) mendojnë se një nga shkaqet kryesore janë dallimet kulturore mes etnikumeve. Dy faktorët e rëndësishëm janë të ndryshëm sipas natyrës së vet, ku faktori i parë është i jashtëm dhe jashtë nga ndikimi/kontrolli i nxënësve, ndërsa i dyti i brendshëm, por i komplikuar për ta tejkaluar.

E dhënë tjetër që bie në sy është niveli i ndryshëm i **pranimit të frikës se përbërja e përzier etnike në shkollat kontribuon ndaj marrëdhënieve më të mira ndëretnike**. Deri sa numri më i madh i nxënësve shqiptarë (73,3%) pajtohen me këtë qëndrim, më pak se një e treta (28,6%) nga maqedonasit e ndajnë këtë mendim. Edhe krahas kësaj, shumica (82% maqedonas dhe 80% shqiptarë) kanë deklaruar se do të merrnin pjesë në aktivitete me shokë shkolle nga nacionalitetet tjera. Megjithatë, edhe krahas motivimit për pjesëmarrje në aktivitete ndëretnike, nxënësit në numër të madh (*43,6%) mendojnë se shkolla nuk ndërmerr masa për avancimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike, qëndrim që është i përfaqësuar veçanërisht mes maqedonasve. Kjo përqindje është dukshme më e lartë në krahasim me pjesën tjetër nga ekzemplari, edhe pse bëhet fjalë për qytet ku tensionet ndëretnike ishin më të shprehura në periudhën e kaluar.

Është e rëndësishme e dhëna se rreth gjysma e nxënësve nga të dy etnikumet kanë deklaruar se kanë dëgjuar **komente ofenduese nga ana e arsimtarëve** të dërguara ndaj grupeve tjera etnike. Megjithatë, perceptimi lidhur me ndikimin e këtyre komenteve mbi formimin e qëndrimit personal për grupet tjera etnike është i ndryshëm, do të thotë pjesa më e madhe e shqiptarëve në krahasim me maqedonasit mendojnë se komentet e arsimtarëve kanë ndikuar në formimin e qëndrimit të tyre personal. Është i ngjashëm rasti edhe me **presionin nga ana e shokëve të shkollës** të mos shoqërohen me nxënës nga grupet tjera etnike, i cili është më prezent te nxënësit shqiptarë.

Në përgjithësi, qëndrimet e nxënësve nga Struga dallohen në më shumë aspekte nga pjesa tjetër e ekzemplarit. Ata kanë deklaruar se më shpesh dëgjojnë komente ofenduese nga ana e arsimtarëve, më shpesh kanë presione nga nxënësit që mos të shoqërohen me moshatarë nga etnikume tjera, në shkallë më të madhe si faktorë kryesor i llogarisin partitë politike dhe mënyrën e menaxhimit me shkollat për tensionet ndëretnike dhe në përqindje më të vogël në krahasim me pjesën tjetër nga ekzemplari mendojnë se shkolla ndërmerr masa për ballafaqimin me tensionet. Këto të dhëna flasin për gjasa e së vërtetës se një pjesë e rëndësishme e perceptimeve negative janë shkaktuar

nga faktorë të jashtëm, të cilët në mënyrë sistematike mund të ndryshohen, por mbi të cilat vetë nxënësit kanë ndikim shumë të vogël¹³⁷.

b) Regjistrimi në shkollën e mesme të mjekësisë

Vitin e kaluar shkollor (2009/10), problem aktual ishte regjistrimin në shkollën e mesme shtetërore të mjekësisë “Pançe Karagjovov” në Shkup. Në të vërtetë, prindërit dhe nxënësit shqiptarë, vlerësonin se janë të diskriminuar me jo lejimin nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës që të ketë tetë paralele në gjuhën mësimore shqipe, siç ka pasur në vitin paraprak shkollor (2008/09).

“Vitin e kaluar kishim tetë paralele në këtë shkollë. Edhe këtë vit kërkua që të hapen tetë. Nuk do të bisedojmë më me autoritet kompetente, të cilët na endin të presim akreditimin e paraleleve të reja, për të cilat tani kuptuam se leja duhet të pitet nga Qyteti Shkupit”, na deklaroi Enver Miftari, përfaqësues i prindërve – shqiptarë¹³⁸. Regjistrimi i nxënësve – shqiptarë në shkollën e mjekësisë i ngriti në këmbë institucionet, të cilët shumë shpejt edhe jashtë konkursit u lejuan gjysmë maturantëve të regjistroheshin në tre paralele të reja në shkollën e mesme “Zef Lush Marku”.

c) Gjuha maqedonase nga klasa e parë

Në shkollimin fillor gjysmëvjetori i dytë nga viti i kaluar (2009/10) gjithashtu filloi me rezistencë të bashkësisë shqiptare dhe një pjesë të asaj turke ndaj vendimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për vendosjen dhe të mësuarit e gjuhës maqedonase nga klasa parë për nxënësit pjesëtarë të bashkësive.

Izet Mexhiti, kryetar i komunës së Çairit, tashmë kishte vendosur që të bojkotohet mësimi në shkollat fillore në këtë komunë, sepse sipas tij fëmijët-shqiptarë ngarkohen edhe me një lëndë: “Shqiptarët nuk janë kundër të mësuarit të gjuhës zyrtare të shtetit, këtë nuk e kontestojmë. Mendojmë se një gjuhë e re, e tretë, do ti ngarkonte nxënësit e klasës së parë. Ata edhe ashtu mësojnë edhe gjuhë amtare dhe gjuhën angleze. Vetëm për shkak të kësaj ne jemi kundër vendimit të ministrisë”. Peticioni u nënshkrua në Shkup, Gostivar, Tetovë, Strugë dhe në atë ka edhe nënshkrime të maqedonasve të cilët solidarizoheshin – tha dje Valon Bela, kryetar i organizatës joqeveritare “Realiteti”.

Në mbledhjen e fundit para pushimeve verore, Gjykata kushtetuese e pezulloi vendimin e ministrit të Arsimit, Nikolla Todorov, me të cilin nxënësit e klasës

¹³⁷ Moshka, kontakti, perceptimet – Si shkollat i formojnë marrëdhëniet mes bashkësive etnike, misioni i OSBE në Shkup, janar 2010, fq.56 Studim i rastit - Struga

¹³⁸ Utrinski vesnik - <http://utrinski.mk/?ItemID=A6E834E3F2FB0A4C9AAC4078D9B175D9>

së parë nga bashkësitë pakicë duhej gjatë mësimit fakultativ ta mësojnë gjuhën maqedonase. Vendimi i këtillë i Gjykatës ka të bëjë me faktin se Ligji për arsim fillor parasheh që bashkësitë pakica, gjuhën maqedonase ta mësojnë nga klasa e katërt. Gjykata kushtetuese e anuloi pikën 2 nga vendimi, pasi që konstatoi se në këtë dispozitë caktohet që në planin mësimor, nga klasa e parë deri në të tretën në shkollat fillore, të vendoset lënda e gjuhës maqedonase për nxënësit nga bashkësitë jo shumicë me fond javor prej dy orëve, gjegjësisht 72 orë fond vjetor. Dispozita e tillë në situatë kur Gjykata vërtetoi se, sipas nenit 42 alineja 5 nga Ligji për arsim fillor, është paraparë mësimi i gjuhës maqedonase për nxënësit nga pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e realizojnë në gjuhën dhe alfabetin ndryshe nga gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik, të fillojë në klasën e katërt, me arsimtar adekuat për lëndën.

Në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe tashmë është bojkotuar udhëheqja e dyfishtë ditarit, edhe pse sipas ligjeve për shkollim fillor dhe të mesëm, evidenca pedagogjike udhëhiqet edhe në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe. Inspektorët arsimor shtetëror kanë regjistruar shkolla ku orët evidentohen vetëm në gjuhën shqipe, por deri më tani nuk është dënuar asnjë drejtor.”¹³⁹

ç) Forma verbale dhe joverbale të diskriminimit

Drejtorët e shkollave të cilët u përfshinë me këtë hulumtim, marrëdhëniet e ndërsjella, komunikimin dh sjelljen mes nxënësve dhe arsimtarëve i vlerësojnë si shumë të mira. Gjithashtu, edhe arsimtarët mendojnë se këto marrëdhënie janë shumë të mira, që përputhet edhe me mendimin e prindërve.

Të gjithë drejtorët e shkollave janë përgjigjur se në shkollën e tyre ka sistem të zhvilluar për zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve dhe ky sistem shpesh funksionon përmes zhvillimit të bisedimeve individuale me nxënësit nga ana e kujdestarëve të klasës dhe udhëheqësve të klasës, shërbimeve profesionale dhe sipas nevojës inkuadrohen edhe prindërit, por vetë drejtorët potencojnë se nuk janë të kënaqur plotësisht nga funksionimi i këtij sistemi dhe se në të ardhmen duhet të mendohet për forma të tjera të organizimit, të cilat do ta përmirësojnë komunikimin mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe do të zvogëlohet numri i konflikteve. Arsimtarët, si edhe drejtorët, mendojnë se sistemi ekzistues duhet të zhvillohet me forma të reja, me çka do të përmirësohej efikasiteti në zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në shkollë. Nga ana e prindërve, 36% nga të anketuarit, janë përgjigjur se nuk dinë nëse ekziston sistem i tillë në shkollat ku mësojnë fëmijët e tyre.

¹³⁹ Nova Makedonija

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=1910107462&id=9&setIzdanie=21880>

Në raport me mendimin e nxënësve, drejtorëve, arsimtarëve edhe prindërit theksuan se e njëjta merret parasysh vetëm ndonjëherë. E njëjta ka të bëjë kur bëhet fjalë edhe për propozimet që i japin nxënësit, ndërsa të njëjtat kanë të bëjnë me ndonjë nevojë të tyre.

Drejtorët e shkollave (62,5%) janë përgjegjës se nxënësit nga grupet e marginalizuara në mënyrë të mjaftueshme janë të inkuadruar në aktivitetet gjatë orës dhe aktivitetëve jashtë mësimi. Arsimtarët (23,5%) dhe prindërit (18%) vlerësojnë se këta nxënës nuk janë mjaft të inkuadruar.

Në pajtim me gjithë këtë mund të konstatohet se në kuadër të kësaj kategorie ekziston komunikim dhe sjellje e mirë mes arsimtarëve dhe nxënësve, por duhet të punohet më shumë në përmirësimin e efikasitetit të sistemit ekzistues për zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në shkollat dhe të rritet inkuadrimi i nxënësve nga grupet e marginalizuara në aktivitetet gjatë orës dhe aktivitetëve jashtë mësimi.

d) Diskriminimi në qasjen ndaj nxënësve përmes procesit mësimor

Drejtorët e shkollave (62,5%) kanë deklaruar se asnjëherë nuk shpërfillen dituria dhe përvoja e nxënësve, ndërsa (37,5%) janë përgjegjës se kjo ndodh rrallë. Lidhur me të njëjtën (35%) nga arsimtarët vlerësojnë se kjo ndodh ndonjëherë, ndërsa nga prindërit e anketuar (36%) gjithashtu mendojnë se ndonjëherë ndodh e njëjta.

Brengosëse janë rezultatet e fituara nga pyetja, nëse në shkollë ka programe dhe metoda të veçanta për tejkalimin e barrierave gjuhësore për ata nxënës të cilët e ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga ajo amtare? Përqindje të madhe (75%) nga drejtorët janë përgjegjës se nuk ekzistojnë programe dhe metoda të tilla në shkollat e tyre. Të ngjashme janë edhe rezultatet e fituara nga ana e arsimtarëve. Gjithashtu (76,5%) kanë deklaruar se nuk ekzistojnë programe të tilla. Prindërit (27%) janë përgjegjës se nuk ka programe të tilla, ndërsa (45,5%) nuk dinë nëse ekzistojnë programe dhe metoda të tilla në shkollat ku mësojnë fëmijët e tyre.

Gjithashtu brengosin edhe rezultatet e fituara, sipas të cilave (62,5) nga drejtorët janë përgjegjës se arsimtarët nuk janë të trajnuar për metoda, forma dhe teknika për punë me nxënësit të cilët i përkasin grupeve të marginalizuara. Njëlloj me këtë, bile edhe % më e lartë (76,5%) nga arsimtarët janë përgjegjës se nuk janë të trajnuar.

Interesante janë rezultatet në krahasim me pritjet dhe vlerësimin nga ana e arsimtarëve për nxënësit të cilët i takojnë grupeve të marginalizuara. Në këtë pjesë (45,5%) nga drejtorët e shkollave janë përgjigjur se ndonjëherë ndodh që arsimtarët aplikojnë kritere të ulëta për vlerësimin e nxënësve nga grupet e marginalizuara, për shkak të pritjeve të ulëta nga këta nxënës, që ndikon në arritjet dhe rezultatet e tyre, ndërsa kjo është e dukshme gjatë kalimit nga mësimi klasor në ato më të lartat ose nga arsimi fillor në atë të mesëm. Në pyetjen e njëjtë, bile (70,5%) nga arsimtarët janë përgjigjur pozitivisht, gjegjësisht se kjo ndonjëherë ndodh. Në të kundërtën, prindërit janë të bindur se kjo ndodh ndonjëherë pasi që (91%) të anketuarve janë përgjigjur me “po, ndonjëherë ndodh”.

Gjendja në shkollat në këtë pjesë është brengosëse, pasi që mund të konstatohet se ndonjëherë dituria dhe përvojat e nxënësve shpërfilllet, nuk ka programe dhe metoda për tejkalimin e barrierave gjuhësore për ata nxënës të cilët e ndjekin mësimin në gjuhë tjetër nga ajo amtaria, arsimtarët nuk janë të trajnuar për metoda, forma dhe teknika për punë me nxënësit të cilët i takojnë grupeve të marginalizuara dhe ndonjëherë ndodh që arsimtarët të aplikojnë kritere të ulëta për vlerësimin e nxënësve nga ato grupe, për shkak të pritjeve të ulëta nga këto nxënës, që ndikon në arritjet dhe dituritë e tyre, ndërsa kjo është e dukshme gjatë kalimit nga mësimi klasor në atë më të lartat ose nga arsimi fillor në atë të mesëm.

dh) Përrjashtimi nga aktivitetet mësimore dhe jashtë mësimore

Në pjesën e përrjashtimit nga aktivitetet mësimore dhe jashtë mësimore në procesin edukativo- arsimor, 37,5% të drejtorëve të shkollave janë përrgijgjur se nxënësit dhe prindërit nuk janë të informuar sa duhet për mundësitë për in kundrimin e sërishëm në procesin edukativo-arsimor, nëse nxënësi para kohe e ka braktisur shkollimin ose për shkaqe tjera nuk e ka kryer në kohë. Në krahasim me të njëjtën 29,5% nga arsimtarët gjithashtu mendojnë se prindërit nuk janë të njoftuar sa duhet. Në të kundërtën 73% të prindërve janë përrgijgjur se nuk dinë për këto mundësi sa duhet.

Obligimet dhe rregullat për veprimin gjatë shqiptimit dhe zbatimit të masave adekuate pedagogjike ishte pyetja e ardhshme që na intereso i të kuptojmë sa nxënës dhe prindër janë të njoftuar me të njëjtën. Nga ana e drejtorëve, përrqindje e lartë 87,5% janë përrgijgjur se nxënësit, prindërit dhe arsimtarët janë të njoftuar me obligimet dhe rregullat për veprim gjatë shqiptimit dhe

zbatimit të masave adekuate pedagogjike. Në krahasim me të njëjtën, 29,5% nga arsimtarët kanë deklaruar se nuk janë të njoftuar sa duhet, ndërsa te prindërit 63,5% prej tyre kanë deklaruar se nuk janë të njoftuar sa duhet me të njëjtën.

Në krahasim me inkuadrimin e prindërve në planifikimin dhe organizimin e punës në shkolla, 62,% të drejtorëve në shkolla janë përgjigjur se prindërit janë të inkuadruar mjaft. 23,5% nga arsimtarët vlerësojnë se prindërit nuk janë të inkuadruar dhe 23,5% se prindërit nuk janë të inkuadruar në mënyrë të mjaftueshme. Vetë prindërit, 27% prej tyre kanë deklaruar se nuk janë të inkuadruar, 18% se nuk janë të inkuadruar në mënyrë të mjaftueshme dhe 9% se aspak nuk janë të inkuadruar në planifikimin dhe organizimin e punës në shkollë.

Në këtë pjesë, përgjegjësit në shkolla më shumë duhet ti informojnë prindërit rreth mundësive për inkuadrimin e sërishëm në procesin edukativo-arsimor nëse nxënësi para kohe e ka braktisur shkollimin ose për shkaqe të tjera nuk e ka përfunduar në kohë, për obligimet dhe rregullat për veprim gjatë shqiptimit dhe zbatimit të masave adekuate pedagogjike dhe të sigurojnë inkuadrim më të madh të prindërve në planifikimin dhe organizimin e punës në shkolla.

e) Ndarja e nxënësve romë në sistemin edukativo arsimor

Rezultatet që i fituam në këtë pjesë të hulumtimit, gjithashtu flasin për gjendjen brengosëse që ka të bëjë me nxënësit romë. Në të vërtetë, 62,5% nga drejtorët e anketuar janë përgjigjur se në shkollat e tyre nuk organizohet, mësim grupor ose individual për ata nxënës, të cilët nuk e njohin sa duhet gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi. Të njëjtën e pohuan edhe arsimtarët e anketuar, prej të cilëve 88% u përgjigjën se nuk organizohet lloj i këtillë i mësimit në shkollat e tyre. Prindërit janë përgjigjur se nuk organizohet ose nuk dinë për mësim të këtillë.

Në pyetjen e ardhshme, 25% nga drejtorët e shkollave janë përgjigjur se nxënësit romë grupohen në paralele të njëjtë, nga ana e arsimtarëve 11,5% e mendojnë të njëjtën, ndërsa kjo te prindërit është 27%. Në vijim të pyetjes paraprake na interesonte se me kë nxënësit romë ulen më shpesh në bankë. Nga drejtorët e anketuar bile 50% u përgjigjën se nxënësit gjithnjë ulen në bankën e njëjtë me nxënës tjerë të cilët po ashtu janë romë, ndërsa 37,5% janë përgjigjur se kjo ndodh rrallë. 29,5% të arsimtarëve janë përgjigjur se kjo gjithnjë është kështu, ndërsa 70,5% se kjo ndodh vetëm ndonjëherë. Gjithashtu

edhe 45,5% nga prindërit kanë deklaruar se nxënësit romë gjithnjë ulen në një bankë me romë të tjerë.

Në fund, 37,5% të drejtorëve të anketuar janë përgjigjur se nxënësit në paralele shpërndahen sipas përbërjes etnike, 47% nga arsimtarët dhe 27% nga prindërit kanë dhënë përgjigje të njëjta për këtë pyetje.

2.2.4. Përfundime dhe rekomandime

Përfundime

- 2.2.1. Rregullativa për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi etnik në arsim është gjithëpërfshirëse. Kjo rregullativë i përfshinë si ligjet nacionale, ashtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë, të cilat Maqedonia i ka ratifikuar. Këto akte juridike dhe instrumente ndërkombëtare e ndalojnë diskriminim në qasjen deri në shkallë të caktuar të shkollimit, diskriminimi i cili është rezultat i veprimit të institucioneve arsimore, por parashihen edhe masa për ruajtjen e identitetit përmes procesit arsimor.
- 2.2.2. Nga ana formale, nuk vërehet diskriminimi etnik në qasjen deri te institucione ose programe të caktuara. Megjithatë, është fakt se (duke marrë parasysh gjuhën mësimore), disa prindër vendosin (ose janë të detyruar) ti shpijnë fëmijët në shkollë në ndonjë komunë tjetër (për shkak të gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi), që ndikon në qasjen deri te shkollimi dhe mund të jetë shkak për paraqitjen e ndarjes së nxënësve nga bashkësitë e ndryshme.
- 2.2.3. Për përdorimin e gjuhës së bashkësive, në shkollimin fillor, pjesëtarët e disa bashkësive mësojnë në gjuhën amtare (shqip, turqisht, serbisht). Pjesëtarët e bashkësisë shqiptare e përdorin gjuhën amtare në të gjitha nivelet e shkollimit.
- 2.2.4. Problemi me tekstet shkollore mbetet. Vërehen aktivitete të caktuara të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për tejkalimin e këtij problemi, por të njëjtat duhet të vazhdojnë me temp të fuqishëm dhe me më shumë aktivitete, veçanërisht për tekstet shkollore të cilat kanë të bëjnë me nxënësit pjesëtarë të bashkësive, pasi që në mësimin e gjuhës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë, problemi me tekstet shkollore është më i madh.
- 2.2.5. Nxënësit, por edhe vetë shkollat, nuk kujdesen shumë për aspektet multikulturore të shoqërisë maqedonase. Paraqitet edhe nevoja nga harmonizimi i përmbajtjes së lëndëve, të cilët janë pjesë e punës edukativo-arsimore, ndërsa janë të shkruara në gjuhë të ndryshme. Kjo ndikon dhe

mund të kontribuojë që të zhvillohen stereotipa të gabuar për pjesëtarët e bashkësive tjera etnike.

- 2.2.6. Në procesin arsimor vërehen ndarje fizike të nxënësve në bazë etnike. Kështu, për shembull në Strugë nxënësit e bashkësisë shqiptare dhe maqedonase janë të ndarë në shkollë në turne të ndryshme. Sa edhe të besohet se me këtë është zgjidhur problemi, megjithatë metoda është e gabuar, duke marrë parasysh se me këtë edhe më shumë i mbyll nxënësit në bashkësitë e tyre me ndjenja negative për pjesëtarët e bashkësive tjera.

Rekomandime

- 2.2.1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet sa më shpejtë të fillojnë me zbatimin e Strategjisë së posa miratuar për shkollim të integruar.
- 2.2.2. Duhet të shpejtohet përfshirja e lëndëve me literaturë adekuate në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi.
- 2.2.3. Tekstet shkollore të cilat përdoren në punën edukativo-arsimore, duhet më shumë ti kushtojnë kujdes jetës multikulturore në Maqedoni dhe është e domosdoshme harmonizimi i përmbajtjeve të gjitha lëndëve, pa marrë parasysh në cilën gjuhë është shkruar teksti shkollor, me fokus të veçantë të respektimit të diversifikimit, respektimit të pjesëtarëve të bashkësive tjera, kultura e tyre e veçantë, gjuha, religjioni, etj. Ndarja fizike e nxënësve nuk duhet të praktikohet. Në vend të kësaj, bil edhe më shumë, nxënësit nga bashkësitë e ndryshme duhet të mësojnë lëndë të caktuara së bashku, si gjuha e huaj, ushtrimet fizike ose informatike. Në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi të afrohen dhe ti eliminojnë stereotipat negative dhe paragjykimet të cilat ndoshta ekzistojnë.
- 2.2.4. Në vazhdimësi duhet të ndiqet gjendja e romëve në procesin arsimor. Veçanërisht duhet të kihet kujdes të mos paraqitet ndarja e tyre në paralele të veçanta ose shkolla dhe nuk do të ketë diskriminim nga kuadri arsimor.
- 2.2.5 Prindërit duhet të jenë të informuar për mësimin e rregullt dhe zgjedhor në gjuhën e bashkësisë.

2.3. TË MIRAT DHE SHËRBIMET

Fusha, të mirat dhe shërbimet, nënkupton përfshirje të gjerë të veprimeve dhe interaksionit mes njerëzve në ofrimin e të mirave (shitja e mallrave të ndryshme) ose në ofrimin e shërbimeve (nga shërbimi në restorant dhe kafenetë, përmes shërbimeve bankiere dhe financiare, deri te shërbimet komunale si instalimi i rrjetit elektrik ose të ujës-jellësit etj.). Ndonjëherë, krahas të mirave dhe shërbimeve, në definicionin ceken edhe objektet (facilities), por në tekstin e mëtejshëm, ato do të nënkuptojnë si pjesë e të mirave ose shërbimeve.

Në BE, Direktiva racore, theks i veçantë i është vënë strehimit (shitja e shtëpive dhe banesave), por në përgjithësi, nuk ka definicione ose numërime të veçanta të mirave dhe shërbimeve të cilat janë lëndë e rregullimit ligjor. Gjithashtu, nuk bëhet dallim nëse të mirat dhe shërbimet sigurohen me pagesën e kompensimit ose janë pa pagesë – mbrojtja nga diskriminimi sillet njëlloj ndaj të dyjave.

Për shkak të zhvillimit historik të dukurisë së diskriminimit, në legjislacionin anti diskriminues, si dhe vëzhgimin ndërkombëtar të kësaj çështje, disa fusha si punësimi, shkollimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësore trajtohen veçmas, edhe pse një pjesë e madhe prej tyre mund të klasifikohen si të mira dhe shërbime. I tillë është rasti edhe me këtë hulumtim, e kështu këto fusha, si edhe çështja e medieve janë përfshirë në kapituj të veçantë, deri sa në këtë pjesë flitet për të mirat dhe shërbimet tjera, te të cilat është më karakteristike dukuria e diskriminimit.

Më së shpeshti, nën të mira dhe shërbime në kontekst të diskriminimi, mendohet për:

- qasja deri te objektet dhe sipërfaqet publike (ministrinë, agjencitë shtetërore - si kadastra, serviset tjera publike, por edhe sheshet, parqet etj.);
- qasja deri te shërbimet me karakter publik, si energjia elektrike, uji, ngrohja qendrore, shërbimet elektro-telekomunikimi (TV, interneti, telefoni, programet kabllorike etj.);
- përdorimi i transportit publik dhe qendrat transportuese (stacionet hekurudhore dhe të autobusit, aeroportet, etj.);
- qasja deri te objektet/ambientet për rikrijim, sport dhe argëtim (stadiume, pishina, klubet, restorantet);
- pjesëmarrje e lirë në tregun e patundshmërive/objekte për strehim;
- vendosja në hotele, motele, bujtina;
- qasja deri te shërbimet financiare (bankiere), duke përfshirë edhe huazimet, kreditë dhe angazhimet tjera financiare (hipoteka, sigurimi, skemat pensionale).

Në shqyrtimin e situatës në Maqedoni, me interesim janë edhe rastet që vijojnë:

- qasja deri te organet gjyqësore (gjykata, prokuroria, avokatë) dhe trajtimi prej tyre (ofrimi i shërbimit, kohëzgjatja e procedurës, konsistenca e vendimeve);
- sigurimi i sigurisë (intervenimet e policisë, veçanërisht në raste të tensioneve dhe konflikteve etnike, për shembull në gara sportive ose protesta);
- trajtimi në grumbullimin e tatimeve dhe taksave tjera, si dhe çështja e denacionalizimit;
- qasja nga sfera e urbanizmit dhe infrastrukturës (kadastra, çështja e pronave, fondet për ujë dhe rajonet e pazhvilluara etj.);
- qasja deri te subvencionet në fushën e bujqësisë;
- trajtimi i nevojave kulturore (mbështetja e produksionit: publikime; shfaqje teatrore dhe filma; institucione – teatro, shtëpi të kulturës, muze; përmendore de shënime të tjera) të bashkësive etnike.

Diskriminimi në të gjitha këto raste, mund të manifestohet në më shumë mënyra:

- refuzimi që ti ofrohet shërbimi ndonjë personi të caktuar (për shkak të përkatësisë etnike);
- të mos sigurohet prodhim (e mira) ose shërbimi me kualitet të njëjtë ose me çmim të njëjtë, siç do të bëhej për person nga bashkësia tjetër etnike;
- të ofrohet shërbimi në mënyra ose kushte të ndryshme për bashkësi të ndryshme etnike.

Për shqyrtimin e situatës me diskriminimin nga fusha e të mirave dhe shërbimeve, para se të analizohet gjendja në Maqedoni, do të shërbehemi me disa shembuj nga praktika ndërkombëtare, sa për ilustrim.

Me siguri rasti më i njohur i diskriminimit në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve është ai me Roza Parks, afro-amerikane e cila në autobus në vendin Montgomeri (Alabama, Shtetet e Bashkuara të Amerikës), ka refuzuar t'ia lëshojë vendin një të bardhi dhe të ulet në pjesën për zezakët. Këtu kemi të bëjmë me diskriminim racor, por në rregullativën ligjore, baza racore dhe etnike trajtohen bashkë. Arrestimi i saj më 1.12.1995, solli deri te bojkotimi i transportit të autobusëve në atë vend, nga popullata e përgjithshme zezake (rreth 42,000 persona) në zgjatje prej 381 ditësh, kur Gjykata Supreme e SHBA-ve miratoi vendim, me të cilin ndarja e këtyllë në autobusë është kundër kushtetutës. Në vitin 1999

Kongresi¹⁴⁰ i SHBA-ve e ka autorizuar kryetarin, ti dorëzojë medalje të artë për kontributin e saj ndaj kombit, duke e quajtur “gruaja e parë e të drejtave qytetare” dhe “nëna e lëvizjes së lirisë”.

2.3.1. Rregullativa ligjore

Mbrojtja ligjore nga diskriminimi gjatë ofrimit të mirave dhe shërbimeve është relativisht e re. Në rregullativën tonë ligjore është vendosur me miratimin e Ligjit për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (LNMD).¹⁴¹ Edhe pse në dispozitën kushtetuese (neni 9) për barazi të gjithë qytetarëve, nuk përmend fusha (vetëm disa nga kryesoret), me çka nënkuptohet mbrojtja gjithëpërfshirëse nga diskriminimi (në të gjitha lëmit), mbrojtja eksplicite deri tani sigurohej vetëm në fushën e punësimit.

Në nivel të Bashkimit Evropian, për momentin mbrojtja në fushën e Të mirave dhe shërbimeve është paraparë vetëm për bazat e përkatësisë racore dhe etnike (BE Direktiva racore), në nenin 3, pika X).¹⁴² Komisioni Evropian përgatitë direktivë të re, ku mbrojtja nga diskriminimi do të jetë gjithëpërfshirës (më së paku për gjashtë bazat dhe fushat deri tani të caktuara të punësimit, arsimin, mbrojtjes sociale dhe sigurimin e të mirave dhe shërbimeve).¹⁴³

Siç u përmend në hyrje, në LNMD, është siguruar mbrojtja në fushën e Të mirave dhe shërbimeve. Neni 4 thotë: *“Ky ligj aplikohet nga ana e të gjitha organeve shtetërore, organeve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale, personave juridik me autorizime juridike publike dhe persona juridik dhe fizik nga fusha e:*

1. ...

7. Qasja deri te të mirat dhe shërbimet;...”

Mund të përfundohet se formulimi në Ligjin për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, jep bazë të mjaftueshme për mbrojtje në fushën e Të mirave dhe shërbimeve, që për momentin është më e gjerë në krahasim me atë evropianen. Nuk është specifikuar (si edhe në pjesën më të madhe të vendeve të BE)

¹⁴⁰ Public Law 106-26 nga data 4.5.1999, e marrë nga www.gpo.gov më 31.10.2010

¹⁴¹ LNMD është cituar më sipër, fusnota 7.

¹⁴² Direktiva racore e BE, e cituar më sipër në fusnotën 5. Në nenin 3, pika X thuhet se “Direktiva do të aplikohet për të gjithë personat, edhe nga sektori publik edhe nga ai privat, duke përfshirë edhe organet publike, lidhur me: ... qasjen dhe furnizimin me të mira, të cilat janë të kapshme në opinion, duke përfshirë edhe strehimin”.

¹⁴³ Propozim direktiva e BE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë mes personave pa dallim të fesë ose bindjes, handicapit, moshës ose orientimit seksual, (Proposal for a Council Directive on implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of religion or belief, disability, age or sexual orientation, SEC(2008) 2180), 2 korrik 2008. Direktiva mund të gjendet në ueb faqen e BE <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52008PC0426:EN:NOT>.

për cilat të mira dhe shërbime mendohet, e mund të komentohet se dispozitat për mbrojtje janë gjithëpërfshirëse.

2.3.2. Vlerësimi i situatës

Siç është konstatuar më sipër, numri i vogël i rasteve të paraqitura të diskriminimit deri te institucionet kompetente nuk jep mundësi për analizë më thelbësore të gjendjes sipas bazës (në këtë rast diskriminimi etnik) dhe fushave (të mira dhe shërbime). Për këto shkaqe, mund të flitet vetëm për observime dhe pikëpamje të përgjithësuara të trendeve të caktuara nga kjo fushë, pa konstatim të padyshimtë të prezencës së diskriminimit, veçanërisht në formën strukturore.

Qasja deri te objektet publike, sipërfaqet dhe ambientet për sport dhe rekreim. Kryesisht, nuk ka diskriminim të vërejtur nga ky lloj. Nuk janë vërejtur raste të ndalimit të qasjes ose mbajtjes së ndonjë ngjarjeje (duke përfshirë edhe protestat) të personave nga ndonjë bashkësi e caktuar etnike (p.sh. protestë e shqiptarëve etnik me rastin e publikimit të Enciklopedisë maqedonase, ose protesta e romëve para Delegacionit të BE me rastin e largimit të romëve nga Franca).

Gjithashtu, nuk ka ndalesë të dukshme/të theksuar për qasje të personave nga ndonjë bashkësi e caktuar etnike deri te ndonjë objekt publik (organ i administratës shtetërore, stadium/sallë dhe tjera). Kjo nuk e përjashton mundësinë nga veprimi diskriminues i individëve (me vullnetin e tij ose si politikë e fshehur e organizatës e cila i siguron shërbimet), si në shembullin me pishinën në kompleksin Biser, në komunën e Aerodromit, i cili është përpunuar me më shumë hollësi në kapitullin e ardhshëm.

Në mediumet përmenden gjoja raste të diskriminimit ndaj shqiptarëve etnik për regjistrim në Fakultetin Ekonomik¹⁴⁴ në Shkup dhe për shmangien e banjës së Dibrës “Capa” në projektin qeveritar Pushim banje për 10.000 pensionist¹⁴⁵. Në rastin e parë, bëhet fjalë për lëshim në formularin për paraqitje – në të cilin nuk ka pasur opSION shqiptar për caktimin e përkatësisë etnike (në të vërtetë nuk është diskriminimi në krahasim me ofrimin e vetë shërbimit – paraqitja, ose dhënia e testit, por trajtimi nuk është i barabartë në bazë të përkatësisë etnike). Qëllimi në shembullin e dytë është i pasaktë, pasi që banjat e Dibrës kanë qenë një nga katër banjat e kyçura në projekt.¹⁴⁶ Megjithatë, mbetet të kontrollohet edhe një herë distribuimi i shfrytëzuesve (pensionistëve)

¹⁴⁴ “Realiteti” e akuzoi kryeministrin për diskriminim, Makfaks nga 24.08.2010

¹⁴⁵ Projekti qeveritar i shmangu Bankat e Dibrës, Alsat-M televizioni nga 08.08.2010

sipas përkatësisë etnike, nëse është mbajtur llogari për përfaqësim adekuat të bashkësive etnike.

Shfrytëzimi i transportit publik dhe qendrave transportuese (stacionet hekurudhore dhe të autobusit, aeroportet dhe tjera).

Në pjesën e parë, në përgjithësi nuk ka rast të evidentuar të diskriminimit, as në bazë të përkatësisë etnike, ose mbi ndonjë bazë tjetër dhe gjithashtu as në institucionet, e as në mediumet. E njëjta është edhe me vendosjen në hotele, motele, bujtina.

Pjesëmarrja në tregun e patundshmërisë / objekte për strehim.

Këtu mendohet për të drejtën që të jetohet në cilin do qoftë vend/lagje sipas zgjidhjes personale. Në Maqedoni nuk ka ndarje aktive në vendbanimet në bazë të përkatësisë etnike, por ka perceptim për fusha dominuese për të jetuar të një bashkësie të caktuar etnike (p.sh. romët në Shuto Orizari, shqiptarët në Çair etj.). Gjithashtu, nuk ka diskriminim të dukshëm gjatë shitblerjes së objekteve (veçanërisht banesa për të jetuar), në kuptimin e parapëlqimit të ndonjë bashkësie etnike (të vetën) gjatë shpalljes së mbledhjeve. Megjithatë, ka perceptim për disa trende në këtë fushë, si për shembull shitja e shtëpive/banesave në Çair/Fusha e Topanës/Shkup Veri, ku ka shpërngulje të maqedonasve etnik, ndërsa vendosje të shqiptarëve etnik. Derisa kjo zhvillohet sipas kushteve të tregut (çmimi i njëjtë për të gjithë të interesuarit, pa marrë parasysh përkatësinë etnike) dhe pa detyrim, nuk bëhet fjalë për diskriminim. Në disa legjislacione (p.sh. ajo britanike), në detaje përshkruhen situatat ku mund të ndodhë diskriminimi dhe si ai sanksionohet, dhe çka nuk llogaritet për diskriminim. Për shembull, nëse ka marrëveshje të drejtpërdrejtë për shitblerje (pa shpallje), nuk mund të flitet për diskriminim, pa marrë parasysh se kush është blerësi.

Rast i veçantë me interes në Maqedoni është projekti Banesa sociale¹⁴⁷ (për grupet në nevojë, etj.) nga ana e Qeverisë. Disa herë deri më tani, u ndanë mbi 500 banesa të tilla, me anë të konkursit të hapur, ndërsa në 2 vendimmarrjet e fundit, u përdor sistemi i ndarjes së automatizuar të banesave. Vetë sistemi flet për mungesë të ndikimit të njeriut në vendimmarrje dhe diskriminimin e mundshëm. Megjithatë, në rastin e ndarjes së banesave të tilla në Shtip, sipas shoqatës “Çerenja”, edhe pse në konkurs janë paraqitur 50 familje rome, dhe asnjëra prej tyre nuk mori banesë, flet për diskriminim të mundshëm. Kjo kërkon nevojë për kontroll të sërishëm të kriterëve sipas të cilave është udhë-

¹⁴⁶ Ministri Bajrami me pensionistët e parë në Banjat e Dibrës – Capa, Makfaks, 06.02.2010

¹⁴⁷ U shpërndanë 102 banesa sociale në Gjoçe Petrov, Qeveria e RM, www.vlada.mk, 01.11.2010

hequr procedura, si dhe kontaktimi në nivel lokal , që të kontribuohet drejt qëllimit të vetë projektit – shfrytëzues të fundit të jenë grupet në nevojë, siç është ajo rome.

Organet e jurisprudencës (gjykatat, prokuroria, avokatët) dhe trajtimi nga ata (dhënia e shërbimit, gjatësia e procedurës, konsistenca e vendimeve).

Në maj të këtij viti, pati protestë të 43 organizatave qytetare, të cilat kërkuan pezullimin e rasteve të Hagës dhe lirim të akuzuarve në rastet e Brodecit dhe Sopotit, si dhe kundër projektit Shkupi 2014. Kualifikimet ishin se bëhet fjalë për procese politike dhe diskriminim të akuzuarve sepse janë shqiptarë etnikë.

Ekziston perceptim në opinion (p.sh. shfaqja e dramës e përgatitur në bashkëpunim me Avokatin e Popullit), se procedurat në gjykatat për personat nga bashkësitë jo shumicë (si shqiptarët, romët, turqit etnik) zgjatin më gjatë dhe ndonjëherë me qëllim zvarriten. Megjithatë, gjatë hulumtimit nuk mund të gjendej mbështetje për pohimin e tillë.

Këtë vit pati edhe ankesë¹⁴⁸ të burgosurve romë për kushtet ku qëndrojnë dhe sjelljen e nëpunësve, që menjëherë u demantua dhe u arsyetua me kushtet në përgjithësi shumë të këqija në disa nga burgjet (duke përfshirë edhe burgun më të madh – Idrizova), por se nuk ka trajtim të ndryshëm – gjegjësisht diskriminim ndaj të burgosurve të ndryshëm, veçanërisht jo në bazë të përkatësisë etnike.

Siguria (intervenime të policisë).

Në Maqedoni, si shoqëri pas konfliktit, është e rëndësishme pyetja edhe për sjelljen e policisë, gjegjësisht trajtimi i bashkësive të ndryshme etnike gjatë intervenimeve të policisë. Kjo veçanërisht ka të bëjë me rastet e tensioneve dhe konflikteve etnike, për shembull të garave sportive ose protestave.

Derisa kjo ishte çështje jashtëzakonisht e ndjeshme në vitet e para pas konfliktit, inkurajon fakti që shumë pak ose pothuaj aspak nuk ka raste të akuzave ndaj policisë për diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në disa vitet e fundit.

Një shkrim në mediumet, gjatë arrestimit të një shqiptari etnik, pas vrasjes së pjesëtarit të njësisë Alfa, është titulluar në formë pyetëso: Policia a i diskriminon shqiptarët?¹⁴⁹ Gjatë kësaj janë dhënë më shumë argumente se nuk ka pasur qasje selektive në baza etnike gjatë operacionit të policisë.

¹⁴⁸ Romët nga Idrizova ankohen për diskriminim, TV A1, 08.03.2010

Është komentuar edhe rasti i Nerezit,¹⁵⁰ të përleshjes së grupit të tifozëve të popullatës lokale, ku është konstatuar se policia ka mundur dhe është dashur të ndërhyjë më shpejt në mbrojtje të popullatës – kryesisht shqiptarë etnik.

Megjithatë, dominon përshtypja për përmirësimin e punës së policisë dhe për përshëndetje aksionet e policisë për shkatërrimin e kriminalitetit, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të aktorëve dhe përparim i dukshëm në përmirësimin e ndjenjave për siguri të qytetarëve në këto dhjetë vitet pas konfliktit.

Financat.

Në këtë pjesë u përqendruam në një nga stereotipat për diskriminim në bazë të përkatësisë etnike, kushtimisht thënë – ana e kundërt, s e pjesëtarët e bashkësive etnie jo shumicë më pak ose aspak nuk kontribuojnë në buxhetin e shtetit (nuk i paguajnë tatimet, taksat, bile edhe llogaritë për shërbime komunale), ndërsa gjatë kësaj nuk janë sanksionuar. Në të vërtetë, sipas një hulumtimi të OSBE-së për shkallën e decentralizimit, janë krahasuar komunat sipas të ardhurave për kokë banori. Komunat më të mëdha me popullatë shumicë nga bashkësitë tjera etnike (për shembull si Tetova dhe Gostivari), nuk janë në grupin me të ardhura më të mëdha (ku janë komunat Qendër, Gjevgjeli, Dojran, por edhe Sopsishti, me mbi 3,000 denarë/banor), e as në atë me të ardhura më të vogla (Vrapçishti, Zajazi, por edhe Bosillova, me mbi 1,000 denarë/banor). Me kufizim të vogël, se në çdo komunë ka edhe pjesëtarë të bashkësive tjera etnike (pasqyrat nuk janë sipas përkatësisë etnike), megjithatë nuk mund të flitet për diskriminim në kuptimin e stereotipit të përmendur, do të thotë mund të përfundohet se ka pjesëmarrje adekuata edhe nga qytetarët nga të gjitha bashkësitë etnike në buxhetin e RM.

Nga ana tjetër, vite të tëra është i dukshëm dispariteti në pjesëmarrjen e bashkësive tjera etnike (jashtë maqedonasve) në sektorin financiar (marrja e kredive). Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP) që ekziston mbi 10 vjet, punon në nxitjen e pjesëmarrjes së pakicave në tregun e shërbimeve financiare dhe qasjen e tyre deri te kreditë, shënon vetëm 7% pjesëmarrje nga bashkësitë etnike në numrin e përgjithshëm të shfrytëzuesve të saj. Por edhe kjo është përparim në krahasim me vitet në fillim. Në mënyrë plotësuuese, në disa vitet e fundit u përmirësua (ose rrumbullakua) edhe mbulimi i rajoneve ku janë dominues bashkësitë tjera etnike, me ekspozitura të më shumë bankave (veçanërisht më të mëdhatë), me çka u mundësua qasja më e lehtë.

¹⁴⁹ Policia a i diskriminon shqiptarët?, BBC Maqedoni, 24.12.2008

¹⁵⁰ Agim Nuhiu dhe Bekim Kadriu, Raport për rastet e diskriminimit në Maqedoni në vitin 2009 dhe 2010, "Meseçina" Gostivar, 2010.

Urbanizmi / infrastruktura.

Gjatë muajit gusht¹⁵¹ të këtij viti Realiteti e akuzoi Qeverinë për diskriminim ekonomik të shqiptarëve etnik, që menjëherë u demantua me shembuj për investime në objekte infrastrukturore (duke përfshirë edhe ndërtesën e Universitetit Shtetëror të Tetovës, por edhe rrugë dhe objekte sportive) në vendet e banuara me popullatë dominuese me shqiptarë etnik.

Në korrik ishte aktuale edhe çështja e financimit të ujësjellësit dhe kanalizimit në Haraçinë, për të cilën Qeveria ka ndarë 154.000 euro, sipas kryetarit të komunës Batri Bajrami të pamjaftueshme për realizimin e projektit dhe akuzoi për diskriminim të komunës nga ana e Qeverisë (e me këtë edhe në mënyrë indirekte edhe për diskriminim në bazë etnike).

Nevojitet analizë më serioze e buxhetit të Republikës së Maqedonisë që të shihet distribuimi më i saktë i mjeteve për investime kapitale, me çka do të fitohej edhe vlerësim më i afërt për përfitimet e bashkësive të ndryshme etnike (pasi që në çdo intervenim të madh, gjithsesi ka përfitim për bashkësinë më të gjerë, gjegjësisht më shumë etnikume). Megjithatë, duke marrë parasysh shembujt e cekur, mund të konstatohet se nuk ka diskriminim sistematik në bazë të përkatësisë etnike (mjetet në shumën të rëndësishme janë siguruar për bashkësitë ku jetojnë shqiptarët etnik), ndërsa në perceptimet për shpërndarjen e mjeteve qartë ndikojnë shumë faktorë. Në këto raste më shumë mund të flitet për diskriminim të mundshëm në bazë të përkatësisë etnike, më saktë raporti pushtet-opozitë.

Subvencionet në fushën e bujqësisë.

Më 13.07.2010, partia Demokracia e Re, përmendi për përfaqësim jo të barabartë të shqiptarëve etnike në Ministrinë e Bujqësisë (vetëm 0.7% prej 2,600 të punësuarve)¹⁵², duke dyshuar edhe në distribuimin e subvencioneve për bujqësinë, të cilat këtë vit arritën në 100 milionë euro. Megjithatë, në analizën e TV Sitel nga 27.10.2010 r., janë publikuar 10 shfrytëzuesit më të mëdhenj individual për vitin 2009, ku sipas emrave, shumica nuk janë pjesëtarë të bashkësisë shumicë etnike. Gjithsesi, duke marrë parasysh numrin e madh të shfrytëzuesve (nuk është publikuar numri i saktë, por vlerësohet në mbi 25,000 persona), ky nuk është ekzemplar reprezentues, por duke marrë parasysh shumën, mund të përfundohet se nuk ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në shpërndarjen e subvencioneve.

¹⁵¹ OJQ Realiteti i dorëzoi Grueskut mirënjohje për diskriminim, Alsat-M, 06.08.2010 r.

¹⁵² DR: Qeveria i diskriminon shqiptarët edhe në bujqësi, Forum prej 13.07.2010 r.

Nga ana tjetër, në analizën e njëjtë përmenden edhe 10 personat më të mëdhenj juridik shfrytëzues të subvencioneve, të cilët marrin pjesë me shuma dhjetëfish më të mëdha të subvencioneve të marra (6% na subvencionet e përgjithshme për vitin 2009), nuk ka asnjë ekonomi bujqësore nga rajoni i Pollogut. Duke u distancuar se bëhet fjalë për persona juridik dhe është e mundur pjesëmarrje edhe në pronësinë dhe si dorë pune e pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike (jo shumicë), megjithatë në mënyrë plotësuese duhet të shihen shkaqet për këtë – nëse mënyra e organizimit të sipërfaqeve dhe ekonomive bujqësore në atë rajon (për shembull, parcela më të vogla ose kryesisht prodhimtari individuale).

Gjithashtu, në rastin e dëmshpërblimit të familjeve të goditura nga moti i keq në vitin 2009, në komunat e Demir Hisarit, Novacit, Pprilepit, Shtipit dhe Probishtipit, edhe pse pjesa më e madhe e shfrytëzuesve të ndihmës janë nga fshatrat të banuar kryesisht me maqedonas etnike, duke i përfshirë edhe fshatrat nga rajoni si Rudare Tursko, lagjja Draç mbi lumin Zletovica, të cilat janë të banuara me turq dhe romë etnik.

Kultura.

Ministria e Kulturës, krahas mirënjohjeve për vendin kryesues në realizimin e përfaqësimit të drejt të bashkësive etnike në Maqedoni, mund të lavdërohet edhe për qasjen e tillë në programin e balancuar vjetor¹⁵³ për punën dhe financimin e institucioneve dhe projekteve. Edhe pse nuk janë cekur buxhete konkrete për aktivitete individuale, lë përshtypje lista për mbështetje dhe kujdes të veçantë zë përfaqësimi adekuat i bashkësive të ndryshme etnike në program.

Nga ana tjetër, është kritikuar edhe kremtimi për liberalizimit të vizave,¹⁵⁴ për shkak të mospjesëmarrjes së artistëve shqiptar në ngjarjen në e organizuar në sheshin e qytetit. Po ashtu, pati edhe kërkesë për të marrë pjesë në kualifikimet për këngën e Eurovisionit në gjuhën shqipe, që nuk u pranua.

Në këtë grup (por mundet edhe si lëndë e denacionalizimit ose të urbanizimit) mund të shqyrtohet edhe kërkesa e Bashkësisë Islame Fetare për pronësinë dhe udhëheqjen e objekteve nga trashëgimia kulturore islame (si për shembull Kapan Ani, Bezisteni etj.), të cilat edhe pse janë religjioze, ndikon në mënyrë indirekte edhe në marrëdhëniet ndër-etnike. Në të vërtetë, BIM mendon se Qeveria e favorizon KOM-in dhe deri sa atyre prona iu është kthyer qëmoti, lëndët për të cilat BIM ka shtruar kërkesë që para vitit 2004, akoma nuk janë zgjidhur.

¹⁵³ Programi vjetor për realizimin e interesit nacional në kulturë, Ministria e Kulturës, 2010, mund të gjendet në www.kultura.gov.mk

¹⁵⁴ „Zgjoju“: Diskriminimi kulturor në kremtimin e liberalizimit, Alsat-M, 19.12.2009

2.3.3. Rrëfime të rastit

Duke marrë parasysh vetëdijen relativisht të ulët për çështjen e diskriminimit në përgjithësi, por edhe inkuadrimi eksplicit në fushën Të mirat dhe shërbimet në ligjin e miratuar për jo diskriminim para do kohe, nuk janë vërejtur shumë raste të diskriminimit në këtë fushë.

a) Romët në kafe bar

Me siguri rasti më i eksponuar (edhe pse nuk është paraqitur deri te institucionet kompetente si Avokati i Popullit, pasi që bëhet fjalë për sektorin privat, e as deri te gjykatat) është ai me ndalimin për qasje në kafe barin në Qendrën Tregtare në Shkup për pjesëtarët e bashkësisë etnike rome (duke përfshirë edhe sqarimin eksplicit se përkatësia e tyre etnike/racore është shkak për ndalsën për hyrje në objektin dhe jo shërbimin). Pas publikimit të rastit në medime, qasja iu lejua personave të njëjtë në lokal, kur përsëri erdhën me ministrin e Financave Trajko Sllaveski.

b) Qasja selektive në pishinë në komunën e Aerodromit

Një nga rastet më të eksponuar në medime¹⁵⁵ u shënua në gusht të vitit 2009, në pishinë Biser në komunën e Aerodromit, ku disa personave të caktuar nuk iu ishte lejuar hyrja në pishinë.

Edhe pse objekti është me karakter publik, me të cilin ekonomizon firmë private, e cila mund të sjellë rregullore të veta për shfrytëzimin e objektit, duke përfshirë edhe kufizimin e qajes dei te objekti vetëm për persona me kartelë anëtarësi. Por, këto kufizime duhet të shpallen publikisht, të kapshme për tu parë për të gjithë personat të cilët dëshirojnë të kenë qasje dhe të aplikohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë të interesuarve. Dhe gjithsesi, këto rregulla nuk guxojnë të jenë diskriminuese mbi bazë të përkatësisë etnike, e as mbi ndonjë bazë tjetër.

Në rastin konkret, disa persona të cilëve nuk u lejua qasja, kanë deklaruar se këtë e kanë bërë sepse janë shqiptarë, boshnjakë ose romë dhe se kjo është bërë me kontrollimin e dokumenteve për identifikim personal, të cilin e kanë kërkuar në hyrje. Pronari ka deklaruar se nuk ka diskriminim, por se bëhet fjalë për respektimin e rregullave të higjienës në pishinë dhe se kthehen prapa të gjithë personat të cilët nuk kanë pajisje adekuate (peshqir, kostume banje etj.), ndërsa shumica prej tyre janë maqedonas etnik. Gjatë vizitës së Avokatit

¹⁵⁵ Diskriminimi në bazë nacionale në pishinë Biser, A1, 20.08.2009 r.

të Popullit dhe inspektorëve për mbrojtjen e të dhënave personale, është demonstruar prezenca e persona prej më shumë bashkësi etnike.

Megjithatë, mund të flitet për sjellje diskriminuese, pasi që edhe me sqarimin e pronarit për kritere për hyrje në objekt, nuk ka bazë që nga qytetarët të kërkohet të identifikohen dhe se kjo ndikon në vlerësimin nëse mund ose jo të hynë dhe ti shfrytëzojnë shërbimet e pishinës.

2.3.4. Përfundime dhe rekomandime

Përfundime

- 2.3.1. Pengimi i diskriminimit në pjesën e qasjes deri te të mirat dhe shërbimet për herë të parë përfshihet me ligjin e ri NPD. Kjo bëhet edhe për shkak të Direktivës racore të BE, ku të mirat dhe shërbimet, duke përfshirë edhe strehimin, në mënyrë të rreptë janë numëruar në fushat ku ndalohet diskriminimi në bazë të përkatësisë racore dhe etnike.
- 2.3.2. Diskriminimi në qasjen deri te të mirat dhe shërbimet merr shumë forma të dukurisë. Shpesh herë ekziston perceptim se ekziston diskriminim në qasjen deri te të mirat dhe shërbimet, por faktikisht nuk bëhet fjalë për diskriminim. Këtë e vërtetën qëndrimi i përgjithshëm se qytetarët nuk e njohin diskriminimin, por mendojnë se çdo mohim i donjë të drejte do të thotë diskriminim. Nga ana tjetër, kjo e vërtetohet edhe qëndrimin se diskriminimi vështirë dëshmohet.
- 2.3.3. Mosparaqitja e rasteve të diskriminimit reflektohet edhe në pjesën e qasjes deri te të mirat dhe shërbimet. Përveç paraqitjes së rasteve në pjesën e qasjes deri te objektet me karakter publik (restorante, klube, pishina), për fushat tjera nuk janë paraqitur raste të diskriminimit.
- 2.3.4. Nuk ekziston evidencë e mjaftueshme për diskriminim mbi bazë të përkatësisë etnike të mirave dhe shërbimeve. Ky fakt ndikon në vështirësinë e mundësisë së dëshmimit të diskriminimit. Përshtypje e përgjithshme është se diskriminimi etnik në këtë pjesë nuk është sistemor, gjegjësisht bëhet fjalë për raste të përkohshme dhe sporadike. Kjo kryesisht është për shkak të raportit të tregut (shërbimet paguhen, e pastaj interesi ekonomik të mos diskriminohet).
- 2.3.5. Kjo fushë është e volitshme edhe për paraqitjen e diskriminimit indirekt. Kjo është veçanërisht për shkak të faktit se ekzistimi i vendbanimeve me popullatë dominuese nga njëra ose përkatësia tjetër etnike.

Rekomandime

- 2.3.1. Nevojitet edukimi i të punësuarve në vendet ku ekziston potencial për diskriminim (pishina, sportele, restorante, të punësuar në banka, agjenci për patundshmëri, operatorët e celularëve, furnizues me energji elektrike etj.);
- 2.3.2. Gjatë realizimit të projekteve të mëdha, duhet të kihet kujdes ndaj karakterit multikulturor të shoqërisë dhe e njëjta të reflektohet në vetë projektin, do të thotë ato të mos kenë efekt jo proporcional ndaj pjesëtarëve të një grupi të caktuar etnik (diskriminimi indirekt). Këtu veçanërisht mendohet për “rregullat e lojës”, të jenë fer dhe të arsyeshme, e jo të jenë në pamje neutrale me efekt negativ jo proporcional për pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike. Nevojitet vlerësim paraprak (në fazën e planifikimit të projekteve) i efekteve të projektit ndaj bashkësive etnike. Megjithatë, këtu primare janë dhe duhet të jenë kriteret të cilat vendosen për shërbimin adekuat, ndërsa përkatësia etnike duhet të analizohet, por jo edhe të jetë pjesë e kriteve.

2.4. MBROJTJA SOCIALE DHE SHENDETESIA

Pjesëmarrja efektive e personave të cilët i takojnë bashkësive etnike në jetën ekonomike dhe sociale është njëllë e rëndësishme, si dhe pjesëmarrja e tyre në jetën publike, në pajtim me parimet e Kartës Sociale Evropiane dhe Kartën Sociale të Reviduar Evropiane.

Pjesëmarrja në jetën sociale dhe ekonomike mbulon një spektër të gjerë të çështjeve, nga qasja deri te kushtet adekuate për strehim, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore (sigurimi social dhe beneficionet sociale), deri te shërbimet për mbrojtje sociale dhe qasja deri te puna. Këtë, mes tjerash, e kërkon shteti që ti mënjanojë pengesat për këto persona që të kenë qasje të barabartë deri te shërbimet nga kjo fushë.

Siguria sociale e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë sigurohet përmes sistemeve për *sigurim social* dhe *mbrojtje sociale*. **Sigurimi social** është sistem i masave i cili siguron siguri nga rreziqet: sëmundje, amësia, pleqësia, invaliditeti dhe vdekja, ndërsa realizohet përmes sistemit të sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore, sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor dhe sistemit në rast të papunësisë. Këto sisteme në masë të madhe financohen nga kontribute të cilat paguhen nga bruto rrogat e të punësuarve, ndërsa sipas nevojës deficite të caktuara mbulohen nga buxheti i shtetit.

Mbrojta sociale e qytetarëve u siguron ndihmë sociale dhe shërbime sociale në raste të nevojës, gjegjësisht kur nuk janë në gjendje që vetë ta realizojnë sigurinë e tyre sociale. Për dallim nga sigurimi social, mbrojtja sociale financohet përmes buxhetit shtetëror. Në kuadër të Qeverisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është organ kompetent për zbatimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Ligjit për punësi dhe sigurim në rast të papunësisë, Ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe Ligji për ndihmë sociale. Kjo ministri e krijon politikën, e propozon kornizën ligjore dhe e kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e aplikimit të ligjeve dhe akteve nënligjore adekuate.

Puna e drejtpërdrejtë realizohet dhe ndihma e qytetarëve distribuohet përmes qendrave për punë sociale, të cilat janë kompetente në rajonin e një ose më shumë komunave. Në territorin e Republikës së Maqedonisë ekzistojnë 27 qendra për punë sociale (lista është dhënë në shtojcë të dokumentit).

Krijimi i sistemit bashkëkohor të mbrojtjes sociale, i cili do të përgjigjet sfidave të kohës së re, njëkohësisht edhe në pajtim me qëllimet qartë të parapara të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Procesi i integritimit evropian kërkon harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë, promovimin e parimeve të udhëheqjes së mirë, transmetimin e praktikave dhe standardeve të mira evropiane. Edhe pse përvojat evropiane flasin për llojllojshmëri të madhe të traditave në fushën e shërbimeve sociale, në krahasim me mënyrat e financimit, rregullimit, udhëheqjes, strukturimit, organizimit dhe menaxhimit, të gjitha vendet evropiane e ndajnë vizionin dhe parimet e njëjta të sistemit të mbrojtjes sociale. Republika e Maqedonisë edhe në proceset e deritanishme reformuese është udhëhequr nga këto drejtime, gjatë kësaj duke mbajtur llogari për kontekstin real socio-ekonomik, nevojat dhe mundësitë. Në këtë kuptim, i harmonizon dokumentet e veta strategjike me standardet e vendosura në: Kartën për të drejtat themelore të Bashkimit Evropian, direktivat 2000/43/EC, 2000/78/EC, 2004/113/EC, me të cilat ndalohej veprimi diskriminues dhe promovohet e drejta e trajtimit të barabartë, si dhe Strategjia për modernizimin e mbrojtjes sociale. Në këtë drejtim, të gjitha dokumentet strategjike nga fusha e mbrojtjes sociale harmonizohen me Programin nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian dhe Planit Aksionar për Partneritet Evropian.

Në bazë të dokumenteve të lartpërmendura, Republika e Maqedonisë në periudhën e kaluar fokusohet në krijimin e kornizës stabile normative, e cila do të sigurojë mbrojtje efektive të drejtave sociale të qytetarëve dhe realizimin e përcaktimit kushtetues të Republikës së Maqedonisë si shtet social. Pasi që bëhet fjalë për fushë komplekse, ku janë gërshetuar më shumë aspekte të politikës dhe nivele dhe aktorë të ndryshëm të sigurimit të shërbimeve, në periudhën e kaluar janë miratuar ose janë në fazën e miratimit disa dokumente strategjike,¹⁵⁶ ku janë definuar një pjesë të qëllimeve për zhvillimin e mbrojtjes sociale.

Të gjitha këto dokumente e imponojnë nevojën që sistemi për mbrojtje sociale në vazhdimësi të forcohet dhe avancohet, si dhe nevoja nga planifikimi strategjik i aktiviteteve të ardhshme në këtë sferë. Në këtë drejtim, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale,¹⁵⁷ Republika e Maqedonisë iu qas përgatitjes së Programit nacional për zhvillimin e mbrojtjes sociale, ku vërtetohen qëllimet, prioritetet dhe drejtimet e zhvillimit të mbrojtjes sociale, të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me masa të politikës aktive sociale, në afat të mesëm (deri 5 vjet) dhe të gjatë (deri 10 vjet).

Qëllimet dhe politikat lidhur me mbrojtjen sociale trajtohen në mënyrë komplekse dhe llogariten si një nga prioritetet kryesore, një pjesë nga këto masa janë përfshirë në sistemin e mbrojtjes sociale, që sipas definicionit tradicional ka të bëjë me “kompensimet në të holla të gatshme dhe shërbimet personale sociale, të siguruar për personat që nuk hynë në asnjërën nga skemat e sigurimit social, pa mjete të mjaftueshme për jetesë për vete dhe për familjen. Në sistemin e mbrojtjes sociale është i pranishëm parandalimi, jashtë institucioneve dhe mbrojtjes institucionale dhe llojeve të ndihmës sociale të mbrojtjes sociale.

2.4.1. Rregullativa ligjore

Me miratimin e Ligjit për mbrojtje sociale (LMS) në korrik të vitit 2009, u vendosën parametra të ri si në përcaktimin e bartësit, ashtu edhe në përcaktimin e lartësisë së ndihmës sociale në të holla, lidhur me madhësinë e amvisërisë dhe kohëzgjatjen e pranimit të ndihmës. Lidhur me ndihmën ekzistuese në të holla, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, si shfrytëzues paraqiten gjashtë kategori të njerëzve qartë të caktuar, të paafte për punë dhe të pasiguruar me mbrojtje sociale.

¹⁵⁶ Programi për zhvillim të mbrojtjes sociale 2011-2021;

Strategjia nacionale për pleqtë 2010-2010;

Programi për realizimin e mbrojtjes sociale për vitin 2010;

Strategjia nacionale për zvogëlimin e varfërisë dhe përjashtimin social 2010-2020;

Programi për infuzion social;

Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018 (i reviduar);

Strategjia nacionale për mbrojtjen nga dhuna familjare 2008-2011.

¹⁵⁷ Ligji për mbrojtje sociale është cituar më lartë, fusnota 49.

Në pajtim me LMS ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe indirekt në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale, etnike, sociale, politike, fetare, kulturore, gjuhësore, pronore dhe shoqërore, paaftësi dhe pre-jardhje në realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale të caktuara me këtë ligj. LMS e definon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe indirekt. Në rastet e diskriminimit të mundshëm, të drejtpërdrejtë ose indirekt, kërkuesi ose shfrytëzuesi i ndihmës sociale ka të drejtë të kërkojë mbrojtje nga organi përkatës. Nëse në procedurën gjyqësore vërtetohet se me kërkuesin ose shfrytëzuesin e mbrojtjes sociale është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 20 dhe 21 të Ligjit për mbrojtje sociale, kërkuesi ose shfrytëzuesi i mbrojtjes sociale ka të drejtë të kërkojë kompensim të dëmit nga kryesi i diskriminimit.

Mbrojtja sociale në kuptimin më të gjerë të fjalës e përfshinë edhe mbrojtjen sociale. Ndalimi i diskriminimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore parashihet me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.¹⁵⁸ Ky ligj ka të bëjë rreptësisht me “të drejtat e pacientëve në shfrytëzimin e mbrojtjes shëndetësore”¹⁵⁹, ndërsa ligji kërkon që këto të drejta (në mbrojtjen shëndetësore) të realizohen pa diskriminim në cilëndo qoftë bazë, duke përfshirë edhe racën (e cila nënkupton edhe përkatësinë etnike).¹⁶⁰

Në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore zbatohet edhe Ligji për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (LNMD). Në të vërtetë, në nenin i cili e rregullon zbatimin e LNMD, rreptësisht thuhet se LNMD zbatohet, krahas fushave tjera edhe në “sigurinë sociale, duke përfshirë edhe sferat e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore”.¹⁶¹ Në këtë mënyrë Ligji për mbrojtje sociale dhe Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, në pjesën e ndalimit të diskriminimit dhe mbrojtjes juridike kundër të njëjtës, janë plotësuar me Ligjin e përgjithshëm për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. LNMD ka dispozita më të plota për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa parasheh procedurë të veçantë gjyqësore për mbrojtje. Në këtë mënyrë, i njëjti zbatohet paralelisht me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, ndërsa mundëson shkallë më të lartë të mbrojtjes.

Në rregullativën, në sferën e mbrojtjes shëndetësore është vërtetuar trajtim i barabartë për të gjithë qytetarët dhe për të gjithë është garantuar qasje deri te mbrojtja shëndetësore në kuadër të mundësive të sistemit. **Grupet në**

¹⁵⁸ Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve është cituar më lartë, fusnota 50.

¹⁵⁹ Ibid, neni 1.

¹⁶⁰ Ibid, neni 5, alineja 2.

nevojë nga aspekti shëndetësor janë definuar përmes dokumenteve të veçanta strategjike dhe politikave shëndetësore, të cilat janë miratuar dhe zbatohen. Këto grupe në nevojë nga aspekti shëndetësor janë: fëmijët dhe adoleshentët, gratë, romët, popullata rurale, personat me sëmundje mentale, personat me invaliditet, personat të cilët jetojnë me HIV/SIDA dhe personat të cilët nuk janë të siguar me mbrojtje sociale mbi asnjë bazë.

Në korniza ligjore të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë inkuadruar në sigurimin e obligueshëm shëndetësor. Me këtë është dhënë mundësia që të plotësohet nevoja për qasje deri te shërbimet shëndetësore duke përfshirë mbrojtjen shëndetësore parandaluese, shëruese dhe rehabilituese të nivel primar, sekondar dhe terciar, ndihma e shpejtë, barërat dhe ndihmesat mjekësore etj. Me ndryshimet e Ligjit për sigurim shëndetësor, të gjithë qytetarëve shtetas të Republikës së Maqedonisë u sigurohet **sigurimi shëndetësor** me pakon e plotë të shërbimeve shëndetësore.

Republika e Maqedonisë në fushën e shëndetësisë ka miratuar një numër të madh të akteve sistematike dhe dokumenteve strategjike. Veçanërisht është e rëndësishme Strategjia shëndetësore e Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2020, që e cakton vizionin drejt avancimit të shëndetit dhe përmirësimit të sistemit shëndetësor, i cili do të përgjigjet nevojave të popullatës, duke përfshirë grupet e marginalizuara dhe që kanë nevojë. Në këtë strategji caktohen masat dhe aktivitetet për forcimin e sistemit shëndetësor, zvogëlimin e mortalitetit dhe morbiditetin të sëmundjet që paraqesin ngarkesë më të madhe për popullatën dhe sistemin.

Qasja deri te shërbimet shëndetësore është vetëm një nga dimensionet e shumta të gjendjes shëndetësore të popullatës; përmirësimi i qasjes së njërës nga hapat kryesore në zvogëlimin e dallimeve shëndetësore mes popullatës dhe grupeve të marginalizuara. Qasja deri te shërbimet shëndetësore është e drejtë dhe parakusht për gjendje të mirë shëndetësore, pa të cilën nuk mund të arrihet inkuadrim i plotë në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Qasja deri te shërbimet shëndetësore është e pacenueshme nga gëzimi i shërbimeve tjera sociale, siç është arsimiti, strehimi, mbrojtja sociale.

2.4.2. Vlerësimi i situatës

Duke marrë parasysh se një pjesë e madhe nga buxheti i shtetit shkon për transferime sociale, duke përfshirë edhe pagesën e ndihmës sociale për një numër të madh të qytetarëve, është e rëndësishme të shqyrtohet si është distribuimi i këtyre mjeteve në bazë të përkatësisë etnike.

Në vazhdim është dhënë tabela me të dhënat për shfrytëzuesit e ndihmës sociale, numri i të cilëve në Maqedoni arrin gjithsej 50,537 amvisëri.

Emri	Gjithsej	-	maq.	shq.	turq	romë	vlleh	serbë	të tjerë
Berovë	582	34	355	0	40	151	0	1	1
Manastir	3.121	162	1.699	194	65	980	5	1	15
Makedonski Brod	823	6	494	1	322	0	0	0	0
Vallandovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vinicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjevgjeli	208	12	153	1	32	5	0	4	1
Gostivar	4.101	151	656	2.276	324	413	0	1	280
Dibër	1.243	143	23	429	225	217	0	0	206
Delleçvë	694	25	575	0	7	85	0	1	1
Demir Hisar	280	2	259	19	0	0	0	0	0
Kavadar	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kërçovë	1.557	1	277	672	197	407	1	2	0
Koçanë	2.048	241	1.380	5	26	386	0	0	10
Kratovë	279	147	115	0	0	17	0	0	0
Kriva Pallankë	1.014	1	868	0	0	143	0	2	0
Kumanovë	7.598	166	2.214	3.963	28	951	1	268	7
Krushevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Negotinë	737	2	492	5	74	131	0	32	1
Ohër	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Prilep	5.374	221	3.549	160	350	921	0	2	171
Probishtip	364	4	352	0	0	1	0	1	6
Radovish	865	383	159	3	305	13	0	0	2
Resnjë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Sveti Nikole	348	348	0	0	0	0	0	0	0
Strumicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Strugë	1.225	2	283	781	10	38	2	0	109

Tetovë	8.830	526	556	7.323	118	276	0	5	26
Veles	2.436	136	1.532	205	121	372	2	6	62
Shtip	852	1	328	0	97	418	5	2	1
Sh - Gazi Babë	2.725	193	477	1.666	29	329	1	29	1
Sh - Karposh	2.720	83	397	1.975	6	238	1	9	11
Sh. - K. Vodë	2.363	273	576	1.140	222	138	2	10	2
Sh - Qendër	1.964	149	111	1.097	139	442	2	7	17
Sh - Çair	2.973	240	320	2.178	47	125	0	22	41
Sh - Sh. Orizari	2.212	111	37	204	7	1.843	1	3	6
Gjithsej	59.537	3.763	18.237	24.297	2.791	9.040	23	408	978

Është dhënë edhe shpërndarja sipas përkatësisë etnike. Është e dukshme se pjesa më e madhe e shfrytëzuesve (mbi 40%) janë shqiptarë etnikë, si dhe atë se maqedonasit etnikë janë vetëm 30% nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve, gjegjësisht se 70% ndihma sociale u shpërndahet pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike në Maqedoni. Vërehet edhe përfaqësimi i madh disproporcional i romëve (15%) në raport me pjesëmarrjen e tyre në popullatën e përgjithshme prej rreth 2%. Në këtë kuptim, marrë në përgjithësi, jo vetëm se nuk mund të flitet për diskriminim lidhur me pakicat etnike në këtë fushë, por edhe mund të konstatohet politika aktive e zbutjes së diskriminimeve të mundshme para-prake që i ka sjellë këto qytetarë në pozitë të pavolitshme. Gjithashtu, duke i shqyrtuar se në ndonjë mënyrë distribuimi i ndihmës zbrapset nga “përfaqësimi juridik”, ka nevojë për hulumtim më të thellë nëse kjo shpërndarje është gjendje shumëvjeçare dhe duke marrë parasysh keqësimin tranzicional të gjendjes edhe për maqedonasit etnik, të kontrollohet nëse ka diskriminim ndaj tyre (gjegjësisht nevoja nga përfshirje e tyre më e madhe si shfrytëzues).

Nga ana tjetër, që në mënyrë gjithëpërfshirëse të mund të analizohet çështja e diskriminimit dhe si shihet në atë nga ana e qytetarëve, është e domosdoshme të verifikohet nëse qytetarët kanë përvojë personale lidhur me diskriminimin, të verifikohet sa e përjetojnë veten si pjesëtarë të grupeve të ndryshme sociale që janë më të ekspozuar ndaj diskriminimit. Kështu, në kuadër të hulumtimit, që të kontrollohet perceptimi i diskriminimit lidhur me realizimin e të drejtave të sigurimit social, u realizua anketa me 43 shfrytëzues të ndihmës sociale (25 romë, 8 maqedonas, 5 shqiptarë dhe 5 nga bashkësitë tjera etnike).

Anketa tregoi se 65% nga të anketuarit mendojnë se ka dukuri të shpeshtë të diskriminimit në Qendrat për punë sociale (QPS) ndaj shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe se kjo në vazhdimësi ndodh me vite. Gjysma e të anketuarve pohojnë se kanë qenë viktimë të diskriminimit. Është karakteristike se pothuaj të gjithë (18 prej 21) prej tyre janë pjesëtarë të bashkësisë etnike rome. Kjo manifestohet përmes raportit personal (sjellja e keqe e të punësuarve, dërgimi nga njëri sportel në tjetrin, ofendimi, deri te përzënia nga ambientet), por rezultojnë edhe me ndërprerjen e ndihmës. Pas konstatimeve të tilla pa të intervistuarit tjerë nga një përfaqësues nga 6 qytete, ku u zbatua hulumtimi, e në të cilat të anketuarit janë përgjigjur se kanë qenë të diskriminuar. Të gjithë personat e intervistuar, shkakun për diskriminimin e tyre veçanërisht e lidhin me përkatësinë e bashkësisë etnike rome. Ata i pohojnë rezultatet për raportin e të punësuarve në sportelet e QPS, si shumë negative (“si mos ketë askush para tyre, sikur të jem dele e zezë, çdo herë janë nervoz me ne romët, më shëtisin nga sporteli në sportel, aspak nuk i kontrollojnë dokumentet vetëm më refuzojnë, nuk më japin informata të mjaftueshme, nuk më japin ndihmë të njëhershme në të holla, nuk na dëgjojnë deri në fund”). Njëri nga të intervistuarit e arsyeton edhe rastin e vet në realizimin e të drejtës për shfrytëzimin e mjeteve financiare për fëmijën e tretë, sepse edhe në kohë ka shkuar në QPS që të shtrojë kërkesë, nëpunësja nuk i ka dhënë formular për plotësim me arsyetim se momentalisht nuk ka formular të tillë. Kur herën e ardhshme i intervistuari ka ardhur në QPS ka qenë i refuzuar pasi që nuk e ka dorëzuar kërkesën me kohë. Për të gjithë këta, sjellja e të punësuarve në QPS as në të ardhmen nuk do të ndryshojë, vetëm ndoshta nëse punësohen romë.

Që të kontrollohet edhe ana tjetër u intervistua edhe udhëheqësi i Departamentit për të drejtat e mjeteve në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Nga numri më i madh i ankesave të marra nga kërkuesit për realizimin e të drejtës për mbrojtje sociale kanë të bëjnë me ndihmën e njëhershme në të holla dhe të ndihmës së përhershme në të holla. Sipas udhëheqësit, mjetet e dedikuara për ndihmën e njëhershme në të holla në vitin aktual janë zvogëluar shumë, kështu që të njëjtat nuk u paguhen personave pa dallim cilës bashkësi etnike i takojnë. Lidhur me ndihmën e përhershme në të holla nga ankesat e marra, 10% janë pranuar në ministri dhe kanë marrë përgjigje pozitive, derisa për 90% nuk ka pasur bazë për zgjidhje pozitive. Lidhur me sjelljen diskriminuese nga ana e disa individëve të punësuar në Qendrat, udhëheqësi pajtohet se një qëndrim i tillë i individëve ekziston, por nuk e ndërlidh me përkatësinë etnike

të shfrytëzuesve të shërbimeve sociale, por edhe me kulturën e përgjithshme dhe edukatën e të punësuarve.

Gjatë hulumtimit janë realizuar intervista edhe me aktorë tjerë relevantë. Shumica mendojnë se ekziston diskriminim në institucionet përkatëse për ndihmë sociale, kryesisht ndaj romëve, për shkak të stereotipave për mënyrën e tyre të jetës, shkalla e arsimit etj. Pajtohen se numri i madh i shfrytëzuesve të ndihmës sociale janë romë dhe se kjo është jo proporcionale me përfaqësimin e tyre në popullatën e përgjithshme, por flet edhe për disparitetin në punësim – ku mbi 70% të romëve janë të papunësuar dhe ka diskriminim ndaj tyre në këtë kuptim.

SHËNDETËSIA

Edhe pse zyrtarisht, tërësisht nuk është vërtetuar për shkaqet e tashmë të cekura, fakt i parëndësishëm është se statusi shëndetësor i popullatës rome është shumë e keqe dhe pothuaj e pakënaqshme në krahasim me popullatën e përgjithshme; për shkak të mënyrës së ndryshme të jetës, shkalla e arsimit dhe llojet e punësimit, te popullata rome paraqitet strukturë e ndryshme e sëmundjeve, dhe historikisht ekziston jetë më e shkurtër drastike – për rreth 10 vjet në krahasim me popullatën e përgjithshme, që sjell deri te dallimet e mëdha në strukturën e moshës mes popullatës rome dhe të përgjithshme në vend – rreth 30% nga popullata rome i takon grupit të moshës prej 0-14 vjet, përkundër 21% te popullata e përgjithshme, derisa vetëm 44% prej romëve janë moshë mbi 65 vjet, përkundër mesatares në Maqedoni për të gjitha grupet etnike e cila është 10,57%; shkalla e vdekshmërisë është 0,74%, shkalla e vdekshmërisë së foshnjave – 13,9 përkundër 0,72% në suaza nacionale, ndërsa indeksi i mbijetesës (numri i të lindurve në 100 të vdekur) është 320,9.

Në fund, e gjithë kjo duhet të shihet edhe në përveshjen me gjendjen e varfërinë në Maqedoni. Për termin **varfëri** përdoret definicioni i Eurostat sipas të cilit: si të varfër llogariten personat, familjet dhe grupe të njerëzve resurset e të cilëve (materiale, kulturore dhe sociale) janë në atë nivel që i përjashton nga mënyra minimale e pranueshme për jetë në vendin ku jetojnë.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në vitin 2008 **përqindja e të varfërve në Republikën Maqedonisë është 28,7%**. Të dhënat e fundit (Raporti i BE) flasin për shkallë mbi 31%. Indeksi i thellësisë së varfërisë për vitin e

njëjtë është 9,2%. Duke i analizuar sipas profilit, grupet në nevojë janë amvisëri me shumë anëtarë, duke pasur parasysh faktin se 47,7% nga të varfrit jetojnë në amvisëri me 5 ose më shumë anëtarë.

Shkalla e **varfërisë te të papunësuarit** është më e lartë dhe është 38%, gjegjësisht 43% nga të gjithë të varfrit janë persona të papunësuar. Këtë e vërteton lidhja dhe ndikimi i papunësisë me varfërinë, me çka zgjidhja e njërit problem ndikon në masë të madhe në zgjidhjen e problemit tjetër.

Arsimi për kokë në amvisëri, gjithashtu, ndikon në numrin e personave të varfër. Analiza e varfërisë për periudhën prej vitit 1997 deri më 2008 tregon se për periudhën njëzet vjeçare shkalla mesatare e varfërisë është 26,3%, gjegjësisht aq është përqindja e qytetarëve të varfër në Republikën e Maqedonisë. Nëse shkalla prej 26,3% krahasohet me numrin e përgjithshëm prej dy milionë banorë del se rreth 526.000 banorë në Republikën e Maqedonisë janë të varfër. Dinamika e varfërisë nuk është vështruar nga aspekti i ngjarjeve të cilat zhvillohen në familjet ose amvisëritë, të cilët kohë më gjatë jetojnë në varfëri, ose janë të papunësuar një periudhë të gjatë, e kështu janë të mundshme edhe gjendje të tjera te qytetarët e përjashtuar nga aspekti social dhe të varfër.

Llogaritet se **varfëria dhe papunësia ndikojnë në përjashtimin social** edhe pse vetë termi i përjashtimit social është më i gjerë nga termi varfëri, që kryesisht sjell deri te mungesa e të mirave materialeve dhe të hollave. Me ndërlidhjen e papunësisë me dimensionet e ndryshme të përjashtimit social shihet natyra shumëdimensionale e fenomenit të papunësisë dhe pasojave të tija materiale, por edhe socio-psikologjike dhe shoqërore. Për llojet e varfërisë është dhënë tabela 1. Personat e papunësuar vlerësohet se jo vetëm që i zvogëlojnë të ardhurat e tyre, por edhe iu shkurtohet rrjeti i marrëdhënieve dhe relacioneve sociale, iu shkurtohen mundësitë reale të cilat ekzistojnë, e me këtë edhe rasti që të integrohen në indin shoqëror.

Papunësia disavejeçare, statusi i pazgjydhur social dhe juridik i kategorive të caktuara të qytetarëve (veçanërisht të paevidentuar në librin e të lindurve, pa kurrfarë dokumentesh, dokumente identifikimi, pasaporta, certifikata, diploma e tjera), pastaj analfabetë, punëtorë nga ndërmarrje të falimentuara, teprice teknologjike, romë dhe tjerë, në mënyrë të drejtpërdrejtë i godet një numër të madh të qytetarëve. Përjashtimi i tyre mund të krahasohet edhe me një lloj të diskriminimit, duke marrë parasysh se ata nuk kanë kurrfarë mundësie

për qasje dhe realizim të më shumë të drejtave, të cilat nuk mund ti realizojnë. Për këto shkaqe formohet i ashtuquajtimi **rreth magjeps i varfërisë-papunësisë-përrjashtim-pa të drejta**, me çka vihet në pyetje statusi qytetar, të drejtat e njeriut, solidariteti, humanizmi dhe tjera.

2.4.3. Përfundime dhe rekomandime

Përfundime

- 2.4.1. Shteti rregullisht duhet ti grumbullojë dhe ti azhurnojë informatat për gjendjen socio-ekonomike dhe arsimore të personave të cilët i takojnë bashkësive etnike, me qëllim që të krahasohet e njëjta me gjendjen e popullatës shumicë. Gjithashtu me rëndësi të madhe për formulimin e politikave dhe masave efektive është të punohet rreth diskriminimit në fushat, siç janë qasja në punësim dhe strehim, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se të dhënat e grumbulluara si rezultat i regjistrimit të popullatës, në përgjithësi janë të pamjaftueshme që të shërbejnë si bazë e shëndoshë për këto politika dhe masa.
- 2.4.2. Pjesëmarrja e personave të cilët u takojnë bashkësive etnike në jetën socio-ekonomike, ndonjëherë është e penguar nga pengesat administrative dhe nga mungesa e ndjeshmërisë të nevojave dhe vështirësive specifike në të cilat hasin këta persona te shërbimet administrative dhe publike.
- 2.4.3. Personat të cilët u takojnë bashkësive të caktuara etnike, mes tjerash romët, shpeshherë janë të ballafaquar me vështirësi të mëdha nga të tjerët në qasjen në tregun e punës, arsimit dhe trajnimit, strehim, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, të cilat sjellin deri te spiralja e përjashtimit nga pjesëmarrja socio-ekonomike. Gratë që u takojnë këtyre bashkësive shpeshherë janë të dobëta ndaj varfërisë dhe përjashtimit social.
- 2.4.4. Kërkesat e panevojshme ose disproporcionale për njohjen e gjuhës me qëllim që të fitohet qasje deri në vende të caktuara pune ose për fitimin e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht në sektorin privat e penojnë qasjen deri te mbrojtja sociale për personat që u takojnë bashkësive etnike.
- 2.4.5. Ndjenja e diskriminimit të shfrytëzuesit e ndihmës sociale është e madhe. Kjo flet për nevojën që të hulumtohen shkaqet e kërcënimit social të këtyre personave. Nga ana tjetër, diskriminimi i tyre mund të jetë i shumëfishtë, dhe atë së pari për shkak të përkatësisë etnike (duke marrë parasysh numrin e madh të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë); dhe e dyta, për shkak të statusit të tyre social.

- 2.4.6. Rreth 70% të shfrytëzuese të ndihmës sociale janë pjesëtarë të bashkësive etnike jo shumicë. Ky është tregues i përjashtimit të përgjithshëm social të pjesëtarëve të bashkësive jo shumicë, veçanërisht asaj rome. Nga ana tjetër, vetë përfaqësimi i lartë, flet për atë se nuk ka diskriminim lidhur me bashkësitë etnike. Përkundrazi, në mënyrë plotësuese duhet të kontrollohet nëse ky raport ka të bëjë me situatën e trashëguar (nëse ky raport zgjat një periudhë të gjatë) dhe nëse kjo është masë aktive për tejkalimin e diskriminimit afatgjatë paraprak në fusha të tjera (si për shembull punësimi), ose kanë ndryshuar kushtet e tranzicionit dhe mund të flitet edhe për diskriminim ndaj maqedonasve etnike – gjithashtu të varfëruar dukshëm në këtë periudhë. Kriteret për fitimin e ndihmës sociale janë vështirësuar. Kjo ka sjellë deri te numri i madh i ankesave (pjesa më e madhe janë pjesëtarë të bashkësive etnike, veçanërisht rome), por me kontrollin është vërtetuar respektimi i kriterëve të caktuara objektive (mbi 90%).
- 2.4.7. Pjesëtarët e bashkësisë rome në përgjithësi kanë status më të keq shëndetësor nga pjesëtarët e bashkësive tjera. Kjo tregon për nevojën nga ndërmarrja e masave për qasje më të lehtë deri te shërbimet shëndetësore të pjesëtarëve të bashkësisë rome. Statusi shëndetësor i romëve është vetëm pjesë e problemit, që flet për ndërmarrjen e masave në të gjitha fushat nga diskriminimi, punësimi, arsimit, ndihma sociale dhe shëndetësia. Vetëm përmes qasjes së plotë mund të ketë përmirësim të pozitës së tyre sociale.

Rekomandime

- 2.4.1. Shteti duhet të ndërmerr masa që më mirë ta përgatisin personelin e shërbimeve dhe institucioneve publike për ndihmë, që të sigurohet plotësimi adekuat i nevojave të personave të cilët u takojnë bashkësive etnike, me anë të trajnimit të specializuar për nevoja specifike të personave, të cilët u takojnë bashkësive etnike, si dhe të problemeve specifike sociale dhe ekonomike, të cilat mund ti prekin personat që u takojnë ndonjë bashkësie etnike më konkretisht (persona të cilët rrezikojnë përjashtim social, ndërsa inkuadrimi i tyre në jetën socio-ekonomike shpeshherë kërkon qasje të targetuara).
- 2.4.2. Shteti duhet të ndërmerr masa efektive që të mënjanojnë përkufizime të ndryshme të panevojshme në qasjen deri te tregu i punës, ndërsa në situatat kur kërkesa për njohjen e gjuhës paraqet kusht legjitim për qasje

deri te vende të caktuara pune, siç janë në shërbimet publike, duhet të vihen në dispozicion kurset për gjuhë, që të pengohet diskriminimi i personave të cilët u takojnë bashkësive etnike.

- 2.4.3. Ndiurma sociale duhet të shpërndahe mbi kriteret objektive. Nëse një grup i caktuar etnik është më i përfaqësuar në Maqedoni, kjo duhet të nxisë që të bëhen analiza pse kjo është ashtu. Në të vërtetë, ndoshta pjesëtarët e grupeve tjera janë të diskriminuar ose ekzistojnë disa faktorët diskriminues të cilët ndikojnë që pjesëtarët e atij grupi të jenë më të përfaqësuar.
- 2.4.4. Rekomandohet ndarja e profilit të punëtorit social në teren, detyra e të cilit është drejtuar nga avancimi i pozitës së individëve dhe familjeve të tyre në kuadër të lagjeve urbane dhe rurale të goditura nga varfëria.
- 2.4.5. Nevojitet inkuadrim më i madh i sektorit qytetar në detektimin, mënjanimin dhe parandalimin e diskriminimit të grupeve në nevojë dhe që janë të përjashtuara në aspektin social në sferën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore.
- 2.4.6. Përpilimi i politikës për vendosjen e mediatorëve shëndetësor romë (MSHR) dhe definimin e profilit profesional, detyrave të punës dhe përfshirjen e aktiviteteve në terren për MSHR. Ky aktivitet është në pajtim me Planin aksionar nacional për shëndetësi, në kuadër të Dekadës për inkluzionin social të romëve 2005-2015.
- 2.4.7. Zbatimi i masave për përmirësimin e qasjes deri te shërbimet shëndetësore përmes lirimt nga participimi për shërbimet shëndetësore në mbrojtjen primare shëndetësore për personat e grupeve në nevojë, veçanërisht romët, një prind në familje, shfrytëzues të ndihmës sociale apo tjetër nga shteti, persona të cilët jetojnë me HIV/SIDA dhe personat që injektojnë droga (PID). Caktimi i statusit të personave të cilët do ta fitojnë këtë lirim duhet të jetë përmes paraqitjes së statusit të tyre në institucionet kompetente.
- 2.4.8. Vendosja e sistemit të evidencës mjekësore, në pajtim me Ligjin e ri për evidencë në shëndetësi, sipas të cilit të dhënat për pacientët do të bëhen në bazë të përkatësisë së bashkësisë etnike, religjionit dhe statusit ekonomik. Në këtë mënyrë, një pjesë nga statistika shëndetësore do të sigurojë informata për veprim të plotë në raport me grupe të caktuara në nevojë dhe nevojat e tyre shëndetësore.

2.5. MEDIUMET

Organizimi i jetës shoqërore publike në shoqëritë multikulturore dhe multietnike në kuptimin e tyre më të gjerë, si dhe informimi, njohja, toleranca dhe bashkëjetesa me grupet etnike, kulturore, religjioze dhe të tjera me identitetet tjetër, në masë të madhe varet nga mediumet. Funkzioni më i rëndësishëm shoqëror i medimeve është në përcjelljen e trashëgimisë kulturore dhe të vlerave shpirtërore. Nga ana tjetër, një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen mediumet është të shkruajnë për rrethimin e tyre, që sa shkon e bëhet më e larmishme, si edhe për njerëzit me të cilët nuk kanë asgjë të përbashkët. Pa marrë parasysh nëse lajmi ka të bëjë me njerëz ose ngjarje me përkatësi tjetër etnike ose religjioze, orientim seksual, grup tjetër social ose status ekonomik, roli i medimeve dhe gazetarëve është që në mënyrë sa më të besueshme ti përcjellin informatat nga ai që e intervistojnë, perspektivën e tij, idetë dhe pikëpamjet në botë, bile edhe atëherë kur dallimet në mendimet janë të pa ndërlidhura. Nga një shoqëri demokratike pritet që të promovojë marrëdhënie të mira mes njerëzve me spektër të ndryshëm të diversitetit, prandaj mediumet kanë rol të rëndësishëm dhe përgjegjësi në paraqitjen e bashkësive të ndryshme në mënyrë objektive dhe të ndershme.¹⁶²

Nëse si pikënisjeje për analizë të kësaj pjese e marrim konstatimin e nxjerrë në fillim se “nuk ekziston më diskriminim më i shprehur juridik dhe tani për herë të parë deri në shprehje vijnë format joformale të diskriminimit”, pohimi i tillë në mënyrë plotësuese e komplikon qasjen metodologjike për interpretim dhe përcjellje shkencore të diskriminimit në mediumet. Para së gjithash të udhëhequr nga profiti dhe interesi material, shtëpi e mëdha mediale me shumë sukses arrijnë ti shmangin normat juridike për ndalesë nga raportimi me bazë diskriminuese dhe përdorin mënyra të sofistikuara që të dërgojnë mesazhe në hapësirën publike, të cilat kanë efekte diskriminuese. Për dallim nga sferat tjera në të cilat ndoshta ka diskriminim (punësimi, arsimi, dhënia e të mirave dhe shërbimeve, mbrojtja sociale etj.) ku gjendja shpesh vlerësohet në pajtim me **kushtet** të cilat i japin njerëzit dhe grupet me identitetet tjetër dhe **pjesëmarrja** ose më thënë më mirë **prezenca** e “tjerëve”, matematikisht vërtetohet me numra ose përqindje, te mediumet vërtetimi dhe vlerësimi për ekzistimin e diskriminimit thjesht nuk mund të realizohet me ndihmën e shkencave dhe metodave ekzakto. Vendosija e termeve si gjeneralizim, stereotipizim, marginalizim, inferioritet, diversifikim, inkuadrim ose përjashtim, para përdorimit të termit të diskriminimit ndihmojnë që më lehtë të kuptohet dhe vërtetohet gjendja e praktikave diskriminuese në sferën mediale dhe përfundimet të cilat

¹⁶¹ LNMD, i cituar më sipër në fusnotën 7, neni 4, pika 3.

¹⁶² Doracak për raportim për diversitetin, David Tuller, Instituti për medime dhe diversitet, 2003 година, fq. 17

miratohen që të vërtetohet vlerësimi i këtyllë që mos të jenë të shpejtuara, rigide dhe të paarsyeshme.

Se është e vështirë të bëhet vlerësim i vërtetë i gjendjes së përgjithshme në shoqërinë multietnike dhe multikulturore si në Maqedoni, nga aspekti i diskriminimit dhe raportimi me bazë diskriminuese treguan edhe komentet dhe përgjigjet e redaktorëve përgjegjës të medimeve më me ndikim në shtet¹⁶³. Në të vërtetë, sipas redaktorëve të medimeve në RM nuk ekziston **diskriminim në medime** dhe **diskriminim gjatë raportimit** të medimeve, derisa për 3 të anketuarit e tjerë diskriminimi ekziston në masë të madhe gjatë raportimit dhe në mediumet.

Për dallim nga pohimi paraprak ku ka ndarje në qëndrimet e bashkëbiseduesve rreth ekzistimit të diskriminimit gjatë raportimit në medime, nga aspekti i rolit që e kanë mediumet në krijimin e vetëdijes publike, ekziston pajtueshmëri se të njëjta anë vend qendror në formimin e agjendës publike. Përkundër numrit të madh të medimeve (në botë) të cilët nuk e pranojnë rolin aktiv në formimin e agjendës publike dhe të cilët dëshirojnë të mbeten në anën pasive duke e sjellë informimin e medimeve si transmetim të sa më shumë informatave, fakteve dhe interpretimeve për ndonjë ngjarje, redaktorët e medimeve në shtet haptazi e pranojnë dhe e theksojnë anën aktive të medimeve në krijimin e agjendës publike dhe definimin e prioriteteve në jetën politike dhe shoqërore. Me këtë, ata jo vetëm që vendosin çfarë është tema e debatit publik, por edhe krijojnë vera dhe i definojnë kategoritë fundamentale sociale¹⁶⁴. Në këtë kuptim, mediumet dhe redaktorët jo vetëm që janë aktorët kryesor në krijimin e vetëdijes kolektive publike, por edhe në mënyrë implicite marrin një pjesë nga përgjegjësia për pasojat dhe efektet nga raportimi i tyre¹⁶⁵.

Që të arrihen qëllimet kryesore në profesionin medial, zbulimi i të vërtetës dhe pavarësia dhe paanshmëria në informimin e medimeve, në shoqëritë multikulturore dhe multietnike me rëndësi të madhe është të kesh ekip redaktorësh, përbërja e të cilit do të krijojë perspektiva të ndryshme lidhur me temat që plasohen. Prandaj është e rëndësishme të dihet konteksti, faktet dhe mendimet e kyçura, pasi që në të kundërtën, është e pamundur në mënyrë

¹⁶³ Për nevojat e hulumtimit u bënë gjithsej gjashtë intervista të thella për aspekte të ndryshme të diskriminimit në mediumet dhe diskriminimin në përgjithësi me kryeredaktorët dhe redaktorët përgjegjës të: Televizionit A1 (Mladen Čadikovski), Televizioni A2 (Aleksandar Čomovski), Sitell (Dragan Antonovski), Dnevnik (Sasho Kokallanov), Alsat M Televizioni (Muhamed Zeqiri) dhe përfaqësuesi i sektorit joqeveritar nga Instituti Maqedonas për Medime (Petrit Saraçini). Në shtojcë të analizës vijon edhe pyetësori sipas të cilit janë bërë intervistat.

korrekte të analizohet vetë situata. Nëse gazetarët dhe redaktorët vijnë vetëm nga mjedis i ngjashëm ose i njëjtë kulturor, informatat të cilat i përcjellin me siguri se do të jenë njëdimensionale. Duke pasur parasysh se marrëdhëniet ndëretnike në shtet dhe raportimi për diversitetin në masë të madhe dhe shumë shpesh janë në fokus të interesimit edhe të medimeve edhe të opinionit të gjerë, ekzistimi i redaksive të cilat e reflektojnë karakterin multi-etnik në informim, do të ishte hap përpara drejt arritjes së idealeve lartë të përmendura në profesionin e gazetarisë.

Në Republikën e Maqedonisë prezantimi i bashkësive të ndryshme etnike në politikën redaktuese më shumë paraqet përjashtim se sa rregull, veçanërisht kur bëhet fjalë për dy bashkësitë më të mëdha etnike, maqedonase dhe shqiptare. Edhe pse, nuk mund të flitet se ekziston diskriminim në bazë të përkatësisë etnike gjatë punësimit në mediumet, si pengesë e shpeshtë me të cilën ballafaqohen gazetarët është mosnjohja e gjuhës së grupit tjetër etnik. Në këtë kuptim, numri më i madh është i gazetarëve shqiptarë në mediumet në gjuhën maqedonase, se sa përfaqësimi i gazetarëve me përkatësi etnike maqedonase në mediumet në gjuhën shqipe. Nga grupet tjera etnike, më shpesh bashkësia etnike serbe dhe vllahe janë në masë të madhe prezent në redaksitë e medimeve (gazetarë dhe redaktorë), derisa përfundimisht pjesëtarët e bashkësisë etnike rome pothuaj edhe aspak të mos jenë të përfaqësuar në medime¹⁶⁶. Gjithsesi se struktura etnike e mediumit nuk është faktor kryesor për përmbajtjen e raportimit, por mbetet element i rëndësishëm për kuptimin dhe kujdesin gjatë raportimit ndaj bashkësive tjera etnike¹⁶⁷. Edhe pse një pjesë e madhe nga mediumet përpiqen ta kultivojnë konceptin qytetar të shtetit, pa dallim se nuk kanë përfaqësues të më shumë bashkësive etnike në këshillin redaktues në medium, “handikapi kryesor te mediumet është se nuk mund të trajtojnë tema dhe probleme nga jeta e përditshme e bashkësive tjera etnike, sepse nuk kanë kontakt të drejtpërdrejtë me kolegët nga etnikumet tjera”¹⁶⁸.

¹⁶⁴ Krijimi i përgjegjësisë mediale në shoqëritë multi-etnike, Pakoja resurse: informata, praktika, standarde dhe rekomandime, Kalina Bozeva dhe Mark Bossanyi, King Baudouin Foundation dhe Inter Ethnic Initiative for Human Rights Foundation (Bulgaria), 2006, fq. 12.

¹⁶⁵ Mediumet a janë krijuar aktiv të mendimit publik, gjatë intervistimit u përmend shembulli me projektin Shkupi 2014 dhe rastet me vdekjen e shpeshtë të lehonave. Edhe pse të dy lajmet u lëshuan në të njëjtën kohë në opinion dhe gjatë kësaj vizuelizimi i projektit Shkupi 2014 në fillim u prit me interesim të madh te një pjesë e opinionit, mediumet (në atë periudhë) arritën që ta kthejnë fokusin drejt problemit me vdekjen e shpeshtë të lehonave. Me këtë shembull mediumet dëshirojnë ta potencojnë pavarësinë në krijimin e agjendës publike nga qendrat politike dhe ekonomike (të fuqisë).

¹⁶⁶ Sasho Kokallanov – Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i Dnevnik, intervista nga data 01.10.2010 për nevojat e hulumtimit. Sipas tij në konkurset për gazetarë nuk paraqiten kandidatët të bashkësive tjera etnike.

¹⁶⁷ Në intervistën u përmend shembulli kur favorizohet grupi etnik serb në televizionin Sitel kur si redaktor i përmbajtjeve informative vjen nga kjo bashkësi etnike.

2.5.1. Rregullativa ligjore

Në pjesën e parë të analizës është dhënë pasqyra detajore e rregullativës ligjore e cila ka të bëjë me anti-diskriminimin. Në mungesë të normave juridike të cilat kanë të bëjnë vetëm me ndalesën nga diskriminimi në medime, është e nevojshme të bëhet krahasim i legjislaturës lidhur me anti-diskriminimin dhe dispozitat të cilat kanë të bëjnë me lirinë e informimit, gjuha e urrejtjes, si dhe respektimin e pakicave nacionale dhe mbrojtjen e gjuhëve të pakicave.

Gërshetimi i standardeve ndërkombëtare për mbrojtje nga diskriminimi dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes paraqet strukturë shumë të ndërlikuar. Liria e të shprehurit, liria dhe pluralizmi i medieve si një nga parimet më demokratike është e garantuar pothuaj në të gjitha kartat e organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, qytetare dhe politike¹⁶⁹. Nga ana tjetër liritë e këtilla nuk paraqesin kategori të pakufizuar dhe absolute. Kufizimet ekzistojnë atëherë kur e drejta e lirisë së të shprehurit konfrontohet me të drejtën e barazisë dhe jo diskriminimin dhe kur ekziston lidhje e qartë mes të shprehurit të mendimit dhe dëmi gjegjësisht pasojat të cilat bëhen me veprimin e tillë. Vendosja e lidhjes së këtillë të drejtpërdrejtë paraqet detyrë shumë të vështirë dhe është sfidë për shumë institucione ndërkombëtare (gjyqësore) që ta dëshmojnë raportin e këtillë.

Në këtë kuptim, veçanërisht është e rëndësishme KEDNJ dhe nenet 10 dhe 14 nga kjo Konventë, ku në nenin 10 shtohen kufizimet e lirisë së të shprehurit në interes të “sigurisë nacionale, integritetit territorial dhe sigurisë publike, mbrojtja nga çrregullimet ose kriminaliteti, mbrojtja e shëndetit dhe moralit, mbrojtja e reputacionit dhe e drejta be të tjerëve etj.”, derisa në nenin 14 nga kjo konventë në mënyrë të drejtpërdrejtë apelohej edhe vendoset lidhje mes “gëzimit të drejtave dhe lirive (liria e të shprehurit mes lirive tjera) do të sigurohen pa diskriminim mbi cilëndo qoftë bazë si ajo seksuale, racore, ngjyra e lëkurës, gjuha, religjioni, mendimi politik ose tjetër, prejardhja nacionale ose sociale, përkatësia e pakicës nacionale, pronësia, lindja ose status tjetër¹⁷⁰.” Standardet dhe rregullat ndërkombëtare të cilat e rregullojnë mbrojtjen nga diskriminimi në medimet gjenden akoma në fillim. Ekzistojnë një numër i

¹⁶⁸ Sasho Kokallanov – Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i Dnevnik, intervista më 01.10.2010 për nevojat e hulumtimit.

¹⁶⁹ Të gjitha dokumentet be përmendura në pjesën e parë nga analiza (Deklarata universale për të drejtat e njeriut, e cituar më sipër, fusnota 115, CERD, e cituar më sipër fusnota 3, KEDNJ me Protokollet, Marrëveshja e BE dhe Marrëveshja për funksionimin e BE, Direktiva racore e BE, e cituar më sipër fusnota 5, dhe dokumente të tjera).

¹⁷⁰ KEDNJ, cituar më sipër fusnota 14, neni 10 dhe 14.

vogël i dispozitave të cilat mund të gjenden në të drejtën ndërkombëtare dhe para së gjithash rregullimi në këtë sferë u është lënë në kompetencë të shteteve në kuadër të legjislaturës nacionale.

Edhe pse dispozitat e BE Direktiva racore vlen edhe për mediumet, si institucione të cilat punësojnë dhe japin shërbime (dispozitat e përgjithshme në nenin 3 nga Direktiva ka të bëjë edhe me mediumet), vetëm në nenin 7 nga Konventa evropiane për televizion tejkuftar¹⁷¹ i cili në mënyrë të drejtpërdrejt ka të bëjë me obligimet e shpërndarësit radiodifuz për ruajtjen e dinjitetit dhe të drejtave fundamentale të “tjerëve”, si dhe ndalesa për nxitje të urrejtjes racore në asnjë vend tjetër në të drejtën ndërkombëtare për pengimin e diskriminimit dhe gjuha e urrejtjes, mediumet nuk janë ndarë si sektor i veçantë. Në versionin e parë të propozimit të direktivave të lartpërmendura në nenin 4 ishte paraparë që “shtetet anëtare (ti) ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme që të sigurojnë se edukatorët dhe të punësuarit në mas-mediumet janë të vetëdijshëm se mbajnë përgjegjësi në rolin arsimor për pengimin e diskriminimit racor dhe religjioz”. Formulimi i këtillë i nenit 4 u hodh poshtë me argumentimin se bëhet fjalë për shkeljen e të drejtës së të shprehurit dhe pluralizmit në medime.

Njëlloj si dispozitat nga Direktiva 2000/43 edhe në nenin 4 nga Ligji për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (LNMD) i cili ka të bëjë me zbatimin e ligjit mbi personat juridik me autorizime publike, përmenden edhe mediumet. Ligji nuk hynë thellë në thelb, natyra e punës dhe rolin të cilin e kanë mjetet për informim publik lë që ndalesa nga raportimi me bazë diskriminuese në mënyrë më të hollësishme të rregullohet në kuadër të ligjit për veprimtari radiodifuzive. Se dispozitat e LNMD nuk prekin në punën dhe raportimin e medimeve, dëshmon edhe neni 14 ku thuhet se liria e të folurit, paraqitja publike, mendimi dhe informimi publik nuk llogariten për diskriminim, gjatë kësaj pa u cekur kufizimet dhe përjashtimet kur liria e të folurit dhe informimi do të jenë të ndaluara me qëllim të pengimit të diskriminimit. Në këtë kontekst duhet të merren parasysh standardet ndërkombëtare të cilat lirinë e kufizimit nuk e absolutizojnë, por në mënyrë plotësuese e kufizojnë me repskeitimn e lirive dhe të drejtave të njeriut, pengimin e gjuhës së urrejtjes, përhapjen e mosdurimit racor, etnike dhe religjioz etj. Megjithatë, rregullimi i kësaj problematike i është lënë ligjit për veprimtari radiodifuzive, i cili do të përpunohet më poshtë në analizë. Roli tjetër i mjeteve për informim publik në ligj është që ta informojnë

¹⁷¹ E kapshme në <http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/132.htm>

opinionin për rastet e diskriminimi, (me kërkesë të Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi – neni 24) dhe shpallja publike e aktgjykimit (me kërkesë të palës së dëmtuar, ndërsa me vendim të gjykatës kompetente – neni 40) në dy rastet dhe atë: 1. deri te shkelja e të drejtës së veprimit të barabartë ka ardhur me ndërmjetësim të medimeve ose 2) informata për veprim e cila e ka shkelur të drejtën e veprimit të barabartë ka qenë e publikuar në medium, ndërsa publikimi i aktgjykimit është i nevojshëm për shkak të kompensimit të plotë për dëmin e bërë ose mbrojtjen nga veprimi i pabarabartë në rastet e ardhshme.¹⁷²

Ligji për veprimtari radiodifuzive¹⁷³ në pjesën për standardet programore, në mënyrë kualitative i vlerëson dhe i obligon mediat në respektimin e parimeve të tolerancës, respektimin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin, jo diskriminimin, barazinë etj. me fokus të veçantë të laramanisë etnike, racore, religjioze dhe sociale,¹⁷⁴ derisa në nenin tjetër qartë dhe pa dyshim është vendosur ndalesa nga programet të cilat “janë orientuar drejt rrëzimit të dhunshëm të rregullimit kushtetues (...) ose të ndezjes së urrejtjes dhe padurimit nacional, racor, gjinor ose religjioz”.¹⁷⁵

Kur bëhet fjalë për promovimin e diversitetit etnik, në pjesën e veçantë nga ligji i është kushtuar servisi publik radiodifuziv, Radio Televizioni Maqedonas (RTM) ka obligime të veçanta dhe të ndryshme ligjore nga radiodifuzerët tjerë. Në të vërtetë, RTM është e obliguar të emetojë një servis televiziv programor në gjuhën maqedonase dhe një servis televiziv programor në gjuhën që e flasin më së paku 20% të qytetarëve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe bashkësisë tjera jo shumicë,¹⁷⁶ si dhe “të krijojë dhe emetojë programe me interes publik me të cilat reflektohet pluralizmi shoqëror dhe kulturor në shtet”.¹⁷⁷

Duke e pranuar dhe promovuar pluralizmin kulturor si interes publik në RM, ligji e detyron servisin publik radiodifuziv të prodhojë de emetojë programe për të gjitha segmentet e shoqërisë pa diskriminim, si dhe të kultivohet identiteti kulturor i bashkësisë, të respektohen dallimet kulturore dhe religjioze dhe të nxitet kultura e dialogut publik, me qëllim që të forcohet mirëkuptimi dhe toleranca e ndërsjellë në funksion të avancimit të marrëdhënieve mes bashkësisë në mjedisin multikulturor dhe multi-etnik.¹⁷⁸ Gjatë kësaj, RTM duhet të sigurojë qasje të barabartë për të gjithë në krijimin e programeve si

¹⁷² LNMD, cituar më sipër fusnota 7, neni 40.

¹⁷³ Ligji për veprimtari radiodifuzive, Gazeta zyrtare e RM nr. 100 nga data 21.11.2005

¹⁷⁴ Ibid, neni 68.

¹⁷⁵ Ibid, neni 69.

¹⁷⁶ Ibid, neni 117.

¹⁷⁷ Ibid, neni 120.

dhe të pengohet “çfarëdo forme të padurimit racor, religjioz, nacional, etnik e tjerë”.¹⁷⁹ Nga aspekti i strukturës etnike të punësuarve në RTM nga gjithsej 776 të punësuar të përhershëm, 97 janë pjesëtarë të bashkësisë etnike shqiptare, 33 janë pjesëtarë të bashkësisë turke, 22 serbe, 4 rome dhe 26 të bashkësive tjera etnike. Të punësuar me marrëveshje në vepër janë 189 persona, prej të cilëve 57 janë të bashkësisë etnike shqiptare.

Në strategjinë për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2012 e përpunuar nga Këshilli për radiodifuzion (KRD), konstatohet se në “TVM2 emetohen rreth 65 orë program në javë në gjuhën shqipe, 17 orë e 30 minuta në atë turke, me nga 1 orë e 30 minuta në atë serbe, rome, vllahe dhe gjuhën boshnjake”.¹⁸⁰ Nëse dhe sa RTM i plotëson obligimet e rregulluara ligjore për mbrojtjen e identitetit kulturor tregon edhe analiza e programeve të RTM për vitin 2010 të përgatitura nga KRD.¹⁸¹ Sipas funksioneve të programit, pjesë më të madhe të kohës në periudhën e vëzhgimit marrin përmbajtjet me karakter zbavitës (63,5%), përmbajtjet informative (26,5%) dhe në fund përmbajtjet edukative (10%). Vërejtje më të madhe të këtij trupi profesional (KRD) për kualitetin e përmbajtjes programore të MTV2 vjen për shkak të mungesës së “tre qasjeve audio-vizuele për angazhim produktional – risitë, eksperimenti dhe kreativiteti”.¹⁸²

Nga programi i përgjithshëm i emetuar prej 130 orëve, 26 minutave dhe 3 sekondave në periudhën e analizuar në maj të vitit 2010, 73,35% (ose 95 orë, 40m dhe 19s) janë program në gjuhën shqipe, 12,67% (ose 16 orë, 31m dhe 53s) në gjuhën turke, derisa në gjuhën serbe, vllahe dhe boshnjake është emetuar program prej rreth 1 ore dhe 30 minuta, që paraqet dika më shumë se 1% nga programi i përgjithshëm i emetuar. Në gjuhën rome është emetuar gjithsej program prej 2 orësh e 26 minutave, që paraqet 1,87% prej programit të përgjithshëm të emetuar. Siç sjell përfundim edhe analiza, “nuk mund të thuhet se ky servis programor i plotëson nevojat kulturore të etnikumeve në RM dhe përmbajtjet e emetuara nuk e nxisin avancimin e marrëdhënieve mes bashkësive”. Nevojitet që përmbajtjet të përkthehen dhe të bëhen më intere-

¹⁷⁸ Ibid, neni 121.

¹⁷⁹ Ibid, neni 122.

¹⁸⁰ Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2012, Këshilli për radiodifuzion, 2007, fq. 60.

¹⁸¹ Analiza krahasuese e programit në serviset e radios dhe televizionit të Servisit publik radiodifuziv të realizuar në periudhën prej 25 deri 31 janar dhe nga 10 deri 16 maj 2010.

¹⁸² Ibid, matjet e bëra në periudhën 10 – 16 maj, fq. 48

sante edhe për bashkësitë tjera, që barrierat gjuhësore të mos mbeten problem kryesor në përcjelljen e këtyre përmbajtjeve.

2.5.2. Vlerësimi i situatës – ndarje në hapësirën mediale

Hapësira mediale në Republikën e Maqedonisë mund të thuhet se nuk paraqet tërësi të integruar, duke e parë sipas përfaqësimit të bashkësive etnike. Mediat në mënyrë relativisht të thjeshtë mund të ndahen sipas kriterëve etnike, gjegjësisht gjuhësore, që në masë të madhe i përcakton edhe përmbajtjet, të cilat janë lëndë e raportimit media. Edhe pse, nuk mund të pohohet se në media të caktuara punësohen gazetarë vetëm nga një bashkësi etnike, megjithatë mund të thuhet se hapësira mediale “e ndjek” ndarjen mes dy bashkësive më të mëdha etnike në vend: maqedonase dhe shqiptare. Duke e vështuar në këtë mënyrë, mund të pohohet se kuadri gazetar është i shpërndarë në të ashtuquajturat media “shqiptare” dhe “maqedonase”.¹⁸³ Mediume të bashkësive më të vogla etnike ekzistojnë, por ato shpesh janë mediume lokale elektronike, të orientuara në zbatimje, pa program të zhvilluar informativ. Përjashtim të rëndësishëm nga kjo fotografi është televizioni “Alsat-M” – shembull i cili do të përpunohet në fund të kësaj pjese.

Krahas “shpërndarjes” së këtillë të kuadrit gazetaresk, politika redaktuese e programit informativ e plotëson ndarjen e këtillë. Raportimi që andej grupit të vet etnik (ose grupeve) shpesh është sporadike dhe varet nga madhësia e ngjarjes ose situatës për të cilën raportohet. Mungon mbulimi i rrëfimeve të vogla dhe të përditshme të bashkësive tjera etnike, veçanërisht në kuptim të ndarjes “maqedonase-shqiptare”. Raportimi media, në këtë kuptim pothuaj gjithnjë është për ngjarje më serioze politike, incidente dhe gjendjen e sigurisë. Fotografinë e këtillë mediale e ushqen perceptimi për ndarjen e shoqërisë. Në raportin e EKRN, për shembull, theksohet se mediumet “raportojnë për ngjarje në shumë mënyra të ndryshme varësisht nga ngjyra e tyre etnike”.¹⁸⁴

Mediumet në Maqedoni, e në këtë rast kjo më shumë ka të bëjë me ato elektronike, janë një gjuhësore. Nga gjithsej 77 televizione komerciale në RM, gjithsej 13 televizione emetojnë program vetëm në gjuhën shqipe, prej të cilave njëra është nacionale, njëra rajonale, njëra nacionale përmes satelitit, derisa televizionet tjera janë lokale. Dy televizione rajonale emetojnë program në gjuhën rome dhe maqedonase, njëra nga televizionet rajonale është në gjuhën boshnjake dhe një televizion lokal me program në gjuhën maqedonase,

¹⁸³ Komisioni Evropian për pengimin e racizmit dhe jotolerancës, Raporti për “Ish republikën jugosllave të Maqedonisë” (Strasbur: 15 korrik, 2010), 31.

¹⁸⁴ Ibid. 30

turke dhe shqipe.¹⁸⁵ Kjo e përcakton publikun qëllimor në bazë të gjuhë, ndërsa në kontekstin maqedonas kjo ka rëndësinë e vet në përcaktimin e publikut në bazë të etnikumit. Kështu, përmbajtjet në gjuhët e bashkësive tjera etnike mbeten të pakapshme për publikun, i cili nuk i kupton gjuhët ose e zotëron në nivel adekuat. Gjendja e këtillë ndihmon në mirëmbajtjen e publikut të ndarë, që rezulton prapa në agjendën e medimeve, të cilat në atë rreth dhe programi i vet dhe politika redaktuese e krijon në varësi nga publiku personal.¹⁸⁶ Ky përfundim lehtë mund të zgjerohet edhe jashtë programit informativ të medimeve elektronike, të cilat në epokën digjitale të emetimit lehtë mund të zbatojnë shumë gjuhësi për fillimi në përkthimin e përmbajtjeve zbatimëse etj. Kjo do të niste proces të tranzicionit nga medime një gjuhësh drejt medimeve parciale shumë gjuhësh, të cilët do ti drejtohen publikut të gjerë. Në mënyrë të ngjashme, botime elektronike të medimeve të shtypura lehtë mund të transformohen në portale shumë gjuhësh, me çka publiku do ti tejkalojë kufijtë gjuhësore, gjegjësisht etnike.

Në këtë kuptim, mediumet, përmes politikës së tyre redaktuese, kuadrit gazetaresk, por edhe grupit qëllimor në ndonjë mënyrë janë përcaktuar në kuptimin etnik. Një nga përjashtimet është “Alsat-M” televizioni, i cili është servis nacional, i cili në përmasa të caktuara emeton përmbajtje dygjuhësore (shqip dhe maqedonisht) dhe atë të programit të vet me karakter të ndryshëm, me çka mundësohen kushtet fillestare për tejkalimin e hendekut mes dy bashkësive më të mëdha etnike, duke i parë si publik televiziv. Redaksinë informative të këtij televizioni e përbëjnë gazetarë nga të “dy blloqet”, e veçanërisht është e rëndësishme se programi informativ është dygjuhësor. Mbetet të shihet nëse edhe ky model do të ekzistojë në hapësirën mediale maqedonase dhe nëse televizionet tjera do ta zbatojnë qasjen e njëjtë.

¹⁸⁵ Nga televizionet në gjuhën shqipe: TV Alsat M (televizion nacional), TV ERA (televizion rajonal), TV ERA SAT dhe TV Alb (shtetërore përmes satelitit), TV Due, Tv Gura, TV Uskana, TV Festa, TV Hana, TV Art kanal, TV Art, TV Koha, TV Super skaj (televizione lokale);

Nga televizionet në gjuhën rome: TV Shutel, TV BTR (televizione rajonale);

Nga televizionet në gjuhën boshnjake: TV Edo (televizione rajonal);

Nga televizionet në gjuhën maqedonase dhe shqipe: TV Kaltrina (televizion lokal);

Nga televizionet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke: TV Zhupa dhe TV Çegrani Media (televizione lokal);

Nga televizionet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe boshnjake: TV Llazhan (televizione lokale);

¹⁸⁶ Përkahtim nga kjo bëjnë sipas matjeve për shikueshmërinë ose leximin e medimeve nga ana e publikut me përkatësi të ndryshme etnike, paraqesin A1 Televizioni dhe Dnevnik. Në të vërtetë, nga intervistat me redaktorët e redaksive kryesore, sipas matjeve për nevoja të brendshme këto dy medime janë në masë të madhe të “konsumuara” edhe nga bashkësia etnike shqiptare ose konkretisht për Dnevnikun, gazeta ka shitur më shumë kopje në Tetovë te pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare për dallim nga bashkësia etnike maqedonase.

2.5.3. Rrëfime të rastit – diskriminimi në paraqitjen mediale

Situata e këtillë e ndarë lë hapësirë për praktika të ndryshme të stereotipizimit gjatë paraqitjes së bashkësive tjera etnike në mediumet. Duke iu drejtuar publikut të caktuar, mediumet në disa raste përdorin gjuhë të cilin bashkësitë etnike e kuptojnë. Komunikimi i tillë media në disa raste bazohet në perspektivë të etnizuar mbi njerëzit dhe ngjarjet. Diskursi i tillë shërben për ruajtjen e identitetit dhe përcaktimin e diversiteti nga bashkësitë tjera etnike. Problemi me këtë praktikë është se shpesh bazohet në proceset e të ashtuquajturit konstruimit të “ndryshmes” gjatë së cilës grupet e ndryshme paraqiten si kërcënim i caktuar. Praktika e tillë është bazë për paraqitjen diskriminuese të personaliteteve dhe grupeve kur raportimi media e përdor diversitetin e tyre në raste kur kjo nuk është e nevojshme, ndërsa me qëllim që të vendos raport degradues ndaj personit ose grupit.

Në Maqedoni nuk mund të thuhet se në mënyrë sistematike zbatohet paraqitja diskriminuese mediale grupeve etnike.¹⁸⁷ Duke e pasur parasysh të kaluarën, aktorë të ndryshëm në Maqedoni janë të kujdesshëm ndaj mënyrës në të cilën publikisht paraqiten grupet etnike. Kjo nuk nënkupton se stereotipizimi nuk ekziston. Aktiviteti shumëvjeçar i shoqërisë qytetar dhe paraqitja e shumicës së bashkësive etnike në sferën publike ka kontribut të dukshëm ndaj gjendjes ku ekziston niveli elementar i korrektesisë politike në komunikimin publik. Megjithatë, ekziston hapësirë e madhe ku mediumet mund ta përmirësojnë praktikën e vet.

Forma më e përhapur e diskriminimit është asocimi i sjelljes së caktuar me bashkësinë e caktuar etnike. Shembull më i shpeshtë në raportimin për sjelljen e devijuar ku aktorëve të veprave penale shpesh u shtohet dhe përkatësia e tyre etnike. Në këtë praktikë diskriminuese është ajo se komunikimi i këtillë media në mënyrë të paarsyeshme shërben për asocim të sjelljes asociale me bashkësi të caktuara etnike, pasi që sjellja e devijuar është prezent në të gjitha grupet shoqërore në shoqëri të caktuara.

Shembull i fundit për praktikën e këtillë mediale është rasti me djaloshin e ri të gjetur të vdekur në ventilimin e një barake të Shkupit. Shumica e medimeve në raportimin e tyre e përcollën edhe “përkatësinë rome” të djaloshit, prezent në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.¹⁸⁸ Përkatësia etnike rome e djaloshit nuk ka kurrfarë lidhshmërie të drejtpërdrejtë me ngjarjen, pa dallim

¹⁸⁷ Ky konstatim është mbështetur edhe nga vlerësimet e kryeredaktorëve për ekzistimin e diskriminimit në shtet

nëse bëhet fjalë për vjedhje ose fatkeqësi. Praktika e MPB-së të inkuadrojë detaje në komunikatën e vet me mediumet, ndoshta duhet të jetë lëndë e ndonjë analize tjetër, por në këtë rast mediumet vetëm e vazhdojnë këtë diskurs. Diskursi i tillë ka rol të dyfishtë. Nga njëra anë ai shërben për kultivimin e fotografisë pozitive për grupet tjera etnike (gjegjësisht grupi etnik i komunikuesit) gjatë së cilës fotografia e konstruktuar për sjelljen negative mbetet karakteristikë e “tjetrit”.

Romët janë cak i shpeshtë i prezantimit diskriminues medial.¹⁸⁹ Një shembull i tillë është artikulli në Veçer i titulluar “Luten romët të mos bëjnë punë jevgu”.¹⁹⁰ Artikulli gazetaresk raporton për gjendjen e sipërfaqeve të gjelbra rreth sheshit “Maqedonia”, ku jetojnë disa familje rome. Që në vetë titullin sugjerohet se edhe krahas përpjekjeve për korrektësi politike të tjerëve, romët janë parapëlqyer të bëjnë punë karakteristike për këtë grup, që gjoja e arsyeton përdorimin e fjalës së shëmtuar – “jevge”. Në gjithë tekstin mungon çfarëdo argumenti që do ta sqaronte pse përkatësia rome e këtyre familjeve është informatë e rëndësishme në këtë raportim media.

Në vetë tekstin janë prezent disa tropi karakteristike, të cilat shërbejnë në procesin e ndërtimit të asaj ndryshe, dhe në të njëjtën kohë edhe diskriminojnë ndaj bashkësisë etnike rome. Pasi që gazetari e përshkruan çrregullimin dhe kushtet e vështira në të cilat jetojnë ai/ajo, e thekson habinë e tij se kjo ndodh në qendër të Shkupit. Gjendja e këtillë, në atë rast identifikohet si jo natyrore dhe jo reprezentuese për qendrën e qytetit, por lë hapësirë kjo të jetë “normale” për pjesët tjera të qytetit ose vendit. Në këtë kuptim, teksti e ndërton fotografinë e “sundimit” të hapësirës nga romët, për të cilët, në orët e komunikuesit edhe kjo siç e ndërton ai ose ajo është problematike të jetë fotografi reprezentuese e kryeqytetit. Okupimi i tillë nga “tjetri” i pengon përpjekjet për paraqitjen e idesë për fotografi të paramenduar normale për shtetin, popullin (popujt) dhe tjera pasi që paraqet, me fjalët e gazetarit, “fotografi të shëmtuar për kryeqytetin”. Kjo fotografi diskurse është forcuar në mënyrë plotësuese në pjesën ku transmetohet brengosja e kalimtarëve të rastit se turistët e kanë detektuar këtë gjendje dhe nuk kanë qenë të kënaqur. Kështu, romët mbeten fajtorë për imazhin e keq

¹⁸⁸ Agregimi i lajmeve: ‘Djaloshi ka dashur të varet në barakë në qendër të Shkupit’, e kapshme në <http://www.time.mk/read/1b9b2db3a4/36092bed8f/index.html>

¹⁸⁹ Për këtë flasin më shumë institucione. Shumica e raporteve të EKRN, Komiteti i Helsinkut. E plotësuar në intervistën me Mihajlo Lahtov hulumtues i kësaj problematike për “Një magazin” nga viti 2009 – kapshme në: <http://www.ednomagazine.com/mk/5/intervju/mihajlo-lahtov-magister-po-covekovi-prava-i-demokratija.html>

¹⁹⁰ ‘Luten romët të mos bëjnë punë jevgjish’, Veçer, 16 korrik 2008, e kapshme në <http://www.vecer.com.mk/default.asp?ItemID=DAB12A4FF4AB06448ECDADBFC57A4E96>

të qytetit që i pengon përpjekjet për normalizimin e fotografisë për shoqërinë para syve të huaja. Gjatë kësaj, në gjithë artikullin mungon çfarëdo përpjekje që të komentohen shkaqet sociale pse këto familje gjenden atje, ndërsa jeta dhe aktivitetet e tyre zëvendësohen me eufemizma cinik si “piknik” dhe “sheti”.

Megjithatë, ekzistojnë edhe shembuj ku mediumet në Maqedoni tregojnë sensibilitet për temat e ndjeshme etnik. Një rast i tillë kontrovers është me enciklopedinë e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve (AMSHA). Mediumet së shpejti e panë disbalancin e enciklopedisë ndaj grupeve tjera etnike, veçanërisht shqiptare dhe në periudhë afatgjate u angazhuan ta mbajnë fokusin e raportimit të tyre ndaj këtij problemi. Gjatë kësaj, u konsultuan të gjitha palët e prekura nga dy bashkësitë më të mëdha etnike, si dhe opinionin ekspert që kontribuoi ndaj raportimit relativisht objektiv, por edhe social. Në këtë rast mediumet luajtën rol të rëndësishëm në opozitën ndaj përmbajtjes problematike të enciklopedisë. Në mënyrë të ngjashme, pjesa më e madhe e medimeve e përpunuan edhe kontekstin etnik të projektit “Shkupi 2014” përmes nxitjes së debatit publik dhe informimit si edhe konsultimi i qëndrimeve të ndryshme të grupeve etnike me rastin e këtij projekti. Me këtë, përfaqësuesve të ndryshëm të bashkësive të caktuara etnike iu siguroa hapësirë mediale që të informojnë për anën e vet.

Rast tjetër i cili meriton vëmendje të veçantë është raportimi i medimeve për incidentin mes një pjese të grupit tifoze të “Komitëve” dhe banorëve të lagjes së Shkupit Nerez, i cili ndodhi në gusht të vitit 2009 dhe disa ngjarje të ndërlidhura të dhunshme që vijuan. Ngjarja inicuese paraqiste përleshje mes grupit tifoze dhe disa banorëve nga lagja e Shkupit Nerez. Vetë ngjarja në vete përmbante potencial të kuptohet si etnik dhe atë si incident mes dy bashkësive më të mëdha etnike në Maqedoni. Për këtë ngjarje pjesa më e madhe e medimeve raportoi relativisht me kujdes, ndërsa pjesa më e madhe e shtëpive të medimeve në masë shumë të matur i kategorizuan grupet në mënyrë etnike, nëse këtë edhe në përgjithësi e bënin. Praktikisht, pjesa më e madhe e medimeve nuk raportoi me shtesat “maqedonase” dhe “shqiptare” as për njërin nga grupet. Bile edhe për incidentet vijuese, një pjesë e medimeve me kujdes i shmangnin kategorizimet etnike të përgjithësuara (maqedonase dhe shqiptare) të aktorëve gjatë raportimit. Përgjithësisht negativ gjatë këtij shembulli ishte raportimi i Netpres¹⁹¹ që është plot me kategorizime etnike dhe praktikë narrative që iu është dedikuar ndaj ndezjes së padurimit.

Gjatë kësaj, pjesëtarët e bashkësive etnike asocohen në mënyrë të paarsyetuar me sjellje të dhunshme të individëve dhe grupeve më të vogla.

Ajo që për fillim duhet të theksohet është se vetë raportimi media i Netpres dallohet nga mediumet tjera në ,kuptim të asaj cili grup e ka nisur sjelljen e dhunshme. Kjo në vete përmban potencial për tendencionizëm të gazetarit. Më tej, për kapisë nisëse të incidentit, gazetari transmeton se ka qenë këndimi i këngëve patriotike maqedonase, që gjoja u ka penguar shqiptarëve nga Nerezi. Ky transmetim i deklaratës së tifozëve pa komentim vijues shërben vetëm për ndërtimin fajit në bazë të padurimit etnik, që pa kthim e ngjyros dhunën në mënyrë etnike. Në raportimin e mëtejshëm, qytetarë e Nerezit në një moment janë quajtur si “qytetarë”, ndërsa në fund të lajmit shihen informata për ndërtimet jolegale në Nerez, të cilat në asnjë mënyrë nuk janë relevante me ngjarjen. Por pasi që bëhet fjalë për xhaminë, ndërtimi i tillë paraqet marker të rëndësishëm gjatë ndërtimit diskursiv të kërcënimit nga grupi kompetitiv etnik.

2.5.4. Përfundime dhe rekomandime

Përfundime

2.5.1. Ekzistimi i medimeve të pastra etnike (nga aspekti redaktues dhe publik) bën që mediumet të jetojnë në bota paralele etnike. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin që e kanë mediumet në shoqëritë multi-etnike dhe nevojën nga toleranca, të kuptuarit dhe njohjen për bashkësitë tjera etnike, me ndarjen e këtillë etnike mediumet kontribuojnë për forcimin e shkallës së mbylljes dhe ksenofobisë të bashkësitë etnike. Në atë kontekst ndryshimet dhe diversifikimi i strukturës gazetareske, e më vonë edhe asaj redaktuese me përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike, edhe pse tani për tani mbetet sfidë, në afat të mesëm dhe të gjatë mund të jenë të dobishme. Se diversiteti paguhet (bile edhe në afat të gjatë) dëshmojnë shembujt e brendeve të suksesshme dhe më të njohura në industrinë mediale (përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike në medime si CNN, BBS e tjera). Obligimi i medimeve nuk është të mos diskriminojnë, por të bëjnë thirrje në vlerat e shoqërisë, që në kontekstin maqedonas do të thoshte promovim i diversitetit, multikulturës dhe multi-etnikes. Vetëm me ndihmën e medimeve mund të preket në mjediset “e pastra”

¹⁹¹ Netpres, ‘Shqiptarët nga nerezi shkaktuan incident të rëndë me grupin tifoz “Komiti”, Netores, 2009, e kapshme në <http://www.netpress.com.mk/vest.asp?id=60572&kategoria=8>

etnike dhe të thyhen stereotipat dhe paragjykimet për “të tjerët” që ekzistojnë në këto mjedise.

- 2.5.2. Nga ana tjetër, duke i pasur parasysh shembujt e përmendur më lartë pozitiv dhe negativ, mund të thuhet se ekziston nivel i caktuar i sensibilitetit të mediumet ndaj çështjeve të ndjeshme etnike. Aktivitetet afatgjate e aktorëve të ndryshëm, si organizatat joqeveritare dhe shoqatat e qytetarëve, qasja deri te sfera politike e bashkësive etnike, faktori ndërkombëtar dhe përvojat nga natyra e ndjeshme e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni. Në këtë kuptim, në krahasim me raportin media ndaj grupeve të tjera të marginalizuara dhe pakicave në shoqëri sipas statusit ose bazës së caktuar, duket se mediumet kanë ndjeshmëri më të madhe për kontekstin etnik. Shembujt e theksuar me reagimin e mediumeve të enciklopedisë së AMSHA, “Shkupi 2014” ose ngjarja në Nerez, e dokumentojnë mirë atë, ndërsa e theksojnë edhe vetëdijen e mediumeve për përgjegjësinë e vet në shoqëri, e drejtuar nga promovimi i harmonizimit dhe tolerancës në marrëdhëniet ndëretnike.
- 2.5.3. Kjo, kuptohet nuk do të thotë se nuk ekzistojnë probleme. Siç ekziston aftësia për njohjen e problemeve potenciale etnike lidhur me grupet e mëdha, kështu mungon ndjeshmëria në rastet me bashkësitë më të vogla etnike, e më shumë gjatë rasteve personale individuale. Raportimi media për personalitete që përfshin kategorizim etnik atëherë kur kjo nuk është e nevojshme për vetë informimin e opinionit, është praktikë e keqe që i ushqen stereotipat në bazë të cilave bashkësitë e ndryshme etnike i paramendojnë të tjerët.
- 2.5.4. Inkuadrimi i bartësve të opinionit publik në kuadër të bashkësive të caktuara individuale gjatë raportimit media do të thotë mundësi që këto bashkësi të jenë subjekt i informimit, e jo vetëm objekte. Kjo rezulton me prezencën e perspektivave dhe qëndrimeve të bashkësive të ndryshme etnike, me ka pasurohet debati publik në mënyrë inkluzive, e në të njëjtën kohë shmanget edhe kuptimi më i thjeshtë i bashkësive etnike si monolite.¹⁹² Në të vërtetë ata edhe nuk janë monolite, ndërsa teoritë moderne e përcaktojnë etnicitetin si rrjet i komplikuar i marrëdhënieve.¹⁹³ Të pasurit vetëdijes për heterogjenen e vetë bashkësive etnike nga fillimi e bën problem përdorimin e kategorive të gjeneralizuara nga tipi i grupit etnik për caktim in e sjelljes së caktuar specifike të individëve dje grupeve që janë lëndë e paraqitjes mediale.

¹⁹² David Tuller, *Prirucnik Za Izvjestavanje O Razlicitostima* (London ;[Beograd]: Media Diversity Institute; Samizdat B92, 2003), 17.

¹⁹³ За повеке види: Rogers Brubaker, *Ethnicity Without Groups* (Cambridge Mass.: Harvard University Press, 2006).

Rekomandime

- 2.5.1. Nevojitet diversifikim i strukturës gazetareske, e më vonë edhe të asaj redaktuese me përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike, për përmirësimin e objektivitetit dhe qasjes së shumanshme gjatë raportimit, por edhe nga aspekti pragmatik për rritjen e profitit të mediumit përmes rritjes së publikut nga bashkësitë e ndryshme etnike.
- 2.5.2. Sensibilizimi i gazetarëve për marrëdhëniet mes dy bashkësive më të mëdha etnike, duhet të zgjerohet edhe në çështjet lidhur me bashkësitë më të vogla etnike. Në këtë kuptim është e nevojshme ngritja e vetëdijes së gazetarëve për ato, si dhe për problemet të cilat kategorizimin etnik, për shembull e supozon si stereotipizim. Në këtë mënyrë duhet të eliminohet asocimi i një sjellje të caktuar devijuese me grup të caktuar etnik dhe efektet diskriminuese të cilat kjo praktikë i supozon në vete.
- 2.5.3. Krahas përmirësimit të praktikës gjatë raportimit media, është i dëshiruar edhe tranzicioni drejt medimeve shumë gjuhësore që do të hapte mundësi për transformim në mediumet multietnike, të cilat nga niveli nacional do tu drejtohen më shumë grupeve etnike, gjegjësisht do ta tejkalonin ndarjen në blloqe, që për momentin është e ndarë në linja mes medimeve maqedonase dhe shqiptare. Drejtimi ndaj publikut kompleks dhe heterogjen do ta tejkalonte gjuhën e thjeshtëzuar që është bazë për stereotipizim dhe prezantim diskriminues i personaliteteve, e veçanërisht grupeve.
- 2.5.4. Në fund, për luftë të suksesshme kundër diskriminimit në mediumet, KRD duhet të ndërmerri masa në drejtim të pengimit dhe dënimit të gjuha e urrejtjes. Në këtë pjesë, ndoshta edhe mediumet e shtypura duhet të jenë nën vëzhgim të KRD, ndërsa nëpër praktikë duhet të kufizohet gjuha e urrejtjes nga fjalimi i cili kritikon, që bëhet me qëllim të zhvillimit të debatit për një çështje të caktuar. Bashkë me këtë, në mënyrë plotësuese duhet të iniciohen ndryshime të Ligjit penal ku do të precizohen këto vepra, ndërsa gjykatat do të ndërtojnë praktikë përmes ndjekjes së praktikës të KEDNJ, punë që është e obligueshme.

3. ASPEKTE TJERA TË DISKRIMINIMIT

3.1. BASHKËSITË MË TË VOGLA ETNIKE

Në këtë pjesë do të bëhet vështrim i shkurtër i gjendjes së bashkësive më të vogla etnike. Një nga shkaqet për këtë është bindja e përhapur, veçanërisht mes pjesëtarëve të këtyre bashkësive, se Marrëveshja kornizë e Ohrit ka të bëjë vetëm me shqiptarët etnik. Nga ana tjetër, ka hulumtim të veçantë në këtë temë, e këtu janë transferuar vetëm disa nga konstatimet e identifikuara në atë raportin dhe të tjera, ndërsa vështrim i veçantë është bërë rreth gjendjes me bashkësinë rome, e cila perceptohet si bashkësia më e marginalizuar dhe më e diskriminuar në të gjitha hulumtimet e deritanishme në këtë temë.

Hulumtimi për integrimin e bashkësive jo shumicë,¹⁹⁴ tregon se nuk është arritur përfaqësimi i drejtë i këtyre bashkësive në administratën qendrore dhe komunale, si dh se ka përfaqësim të pamjaftueshëm të përfaqësuesve të tyre politik në Kuvendin e RM dhe në këshillat komunal. Më tej, këto bashkësi mendojnë se është nënvlerësuar edhe numri i tyre, gjegjësisht se edhe vetë pjesëtarët e këtyre bashkësive, gjatë regjistrimit ose hulumtimeve tjera identifikohen si maqedonas ose shqiptarë etnik. Në mënyrë plotësuese, ka mungesa në fushat e arsimit (mungesa e arsimtarëve dhe teksteve shkollore në gjuhën amtare), ndërsa ekziston perceptimi edhe për masat e pamjaftueshme rreth promovimit të vlerave kulturore dhe sigurimit të kushteve për kultivimin e identitetit kulturor të këtyre bashkësive. Në nivel komunal, edhe pse rregulla për shumicë të dyfishtë (Badenteri) gjatë vendosjes për çështje që i prekin bashkësitë rrallë aplikohet, këto bashkësi e llogarisin për diskriminuese ndaj tyre, për shkak të pamundësisë që vetë të ndikojnë në vendosjen, por për ata vendosin shumica dhe bashkësia e cila është e përfaqësuar me mbi 20% në atë komunë.

Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Maqedonisë për vitin 2010, cekë sjellje diskriminuese të policisë ndaj romëve (raste të sjelljes brutale), ndërsa e vërteton edhe rezultati i përmendur më sipër për përfaqësimin e pam-

¹⁹⁴ Haxhiq-rahiq, D., Haziri, L., Integrimi i bashkësive jo shumicë nën 20% në nivel qendror dhe lokal, përmes legjislaturës juridike në Republikën e Maqedonisë, 2010 r.

jaftueshëm të bashkësive të vogla në administratën publike. Plotësisht, konstatohet se edhe Agjencia e porsaformuar për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive të përfaqësuara me më pak se 20% nga popullata, akoma nuk është funksionale.

Megjithatë edhe vetë formimi i këtij Agjencie dhe rezultatet nga ky dhe të raporteve të cituara, flasin për progres në realizimin e të drejtave edhe të bashkësive më të vogla, përfaqësimin e tyre më të madh në administratën publike dhe pjesëmarrjen më të madhe në vendimet të cilat i prekin.

3.1.1. Romët në sistemin arsimor

Në Republikën e Maqedonisë në procesin edukativ-arsimor, nxënësit romë, edhe krahas mundësisë kushtetuese dhe ligjore për ndjekjen e mësimin të rregullt në gjuhën amtare, akoma një numër i madh prej tyre mësimin e ndjekin në gjuhën maqedonase. Në rajonin e Tetovës ka një numër të caktuar të nxënësve romë, 323 nxënës në shkollimin fillor dhe 107 nxënës në shkollimin e mesëm, të cilët mësimin krahas në gjuhën maqedonase, mësimin e ndjekin edhe në gjuhën shqipe dhe turke. Shkaku për këtë është fakti se në familjet e tyre flitet një nga gjuhët e përmendura dhe prandaj fëmijët e tyre e kanë më lehtë ta ndjekin mësimin në njërin nga gjuhët e përmendura. Gjithashtu, ky problem paraqitet edhe në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë, pasi që në disa rajone romët, duke mos e njohur gjuhën e tyre amtare, e flasin gjuhën turke.

Problem me ndjekjen e mësimin të rregullt në gjuhën maqedonase paraqitet në rajonin e Shkupit-Kumanovës, për shkak se nxënësit romë në familjet e tyre e flasin gjuhën e tyre amtare rome. Këta fëmijë kur nisin në klasën e parë kanë vështirësi të mëdha në kuptimin dhe ndjekjen e mësimin në gjuhën maqedonase, pasi që shumë dobët ose aspak nuk e njohin gjuhën e njëjtë. Për këta nxënës deri tani nuk ka ekzistuar, por në të ardhmen e shpejtë parashihen programe përgatitore për sundimin e gjuhës maqedonase, gjatë fillimit të shkollimit të tyre në pajtim me Strategjinë për sistem të integruar edukativo arsimor.¹⁹⁵ Për tejkalimin e këtij problemi, ndërsa në drejtim të ruajtjes dhe zhvillimit të gjuhës, kulturës dhe traditës së tyre, në të ardhmen duhet të bëhen përpjekje që të hapet katedra ose grup studimi nga gjuha rome në ndonjërin prej fakulteteve adekuate në vend ose tu jepet bursë për të studiuar në ndonjërin nga fakultetet rajonale, të cilët ofrojnë këtë lloj të studimeve. Kjo do të mundësojë që të zgjidhet ky problem dhe më në fund të krijohet

¹⁹⁵ Ministria e Arsimit dhe Shkencës http://www.mon.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=649:integriranoobrazovanie&catid=67:novostimon&Itemid=128

kuadër përmes së cilit bashkësia rome do të mund ta realizojë të drejtën e vet të garantuar kushtuese dhe ligjore për mësim në gjuhën amtare.

Problem i ardhshëm me të cilin ballafaqohen nxënësit romë në shkollimin fillor është largimi nga shkolla, gjegjësisht heqja dorë nga sistemi edukativo-arsimor, i cili veçanërisht është karakteristik në kalimin nga klasa e pestë në të gjashtën.¹⁹⁶

Në vazhdim vijnë të dhënat statistikore për përfshirjen e nxënësve romë në shkollimin fillor dhe të mesëm për disa vite prapa.

Pasqyra e nxënësve të regjistruar romë në klasën e parë në periudhën nga viti shkollor 2005 deri 2010.

<i>Nr. r.</i>	<i>Viti shkollor</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Gjithsej</i>
1.	2005/06	685	671	1.356
2.	2006/07	715	654	1.369
3.	2007/08	782	699	1.481
4.	2008/09	839	833	1.672
5.	2009/10	754	729	1.483

Përqindja e rritjes së nxënësve romë në klasën e parë 8,5%

Pasqyra e nxënësve të regjistruar romë në shkollimin fillor në periudhën nga viti shkollor 2005 deri 2010.

<i>Nr. r.</i>	<i>Viti shkollor</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Gjithsej</i>
1.	2005/06	4.469	3.940	8.409
2.	2006/07	4.441	3.940	8.381
3.	2007/08	5.268	4.882	10.150
4.	2008/09	5.421	5.130	10.571
5.	2009/10	5.528	5.225	10.753

Përqindja e rritjes së përfshirjes së nxënësve romë të regjistruar në shkollimin fillor për periudhën 2005 – 2010 21,7%

Pasqyra e nxënësve të regjistruar romë në shkollimin e mesëm në periudhën nga viti shkollor 2005 deri 2010.

<i>Nr. r.</i>	<i>Viti shkollor</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Gjithsej</i>
1.	2005/06	654	586	1240
2.	2006/07	678	526	1204
3.	2007/08	831	641	1472
4.	2008/09			
5.	2009/10	1054	900	1954

Përqindja e rritjes së përfshirjes së nxënësve romë të regjistruar në shkollimin e mesëm për periudhën 2005 – 2010 57,5%¹⁹⁷

¹⁹⁶ Hulumtimi "Situatat në arsimin fillor të fëmijve pjesëtarë të bashkësisë rome në Republikën e Maqedonisë", Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

¹⁹⁷ Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë.

3.1.2. Politikat nacionale lidhur me romët

a) Strategjia nacionale për romët

Në vitin 2005 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Strategjinë nacionale për romët. Kjo strategji është e fokusuar në më shumë fusha dhe qëllimi i të njëjtës është të përmirësohet standardi dhe kualiteti i jetës së popullatës rome në Republikën e Maqedonisë. Arsimi si segment i rëndësishëm dhe kusht për arritjen e qëllimit të kësaj strategjie merr vend të rëndësishëm në të njëjtin.

b) Dekada për inkuadrimin e romëve 2005 – 2015

Gjithashtu në vitin 2005 Republika e Maqedonisë u bë pjesë e iniciativës ndërkombëtare Dekada për inkuadrimin e romëve 2005 – 2015 e iniciuar nga Banka Botërore dhe Soros, e cila fokusohet në katër fushat prioritare dhe atë:

- Shkollimi;
- Punësimi;
- Strehim;
- Shëndetësia.

c) Plani aksionar për arsim

Pas miratimit të Strategjisë nacionale për romët dhe qasjes në iniciativën ndërkombëtare Dekada për inkuadrimin e romëve 2005 – 2015, u përpiluan katër plane aksionare dhe operative për katër fushat prioritare të përmendura lartë, mes të cilave edhe arsimi.

ç) Konceptioni për edukatën dhe arsimin nëntëvjeçar fillor

Në pajtim me reformat në Ligjin për arsimin fillor dhe Koncepticionin për arsimin nëntëvjeçar fillor, nxënësit – pjesëtarët e bashkësisë rome, fituan mundësi që gjuhën dhe kulturën e vet ta mësojnë gjatë vendosjes së lëndës zgjedhore: Gjuha dhe kultura e romëve. Kjo lëndë fillon të realizohet nga klasa e tretë, deri në fund të arsimit fillor.

3.1.3. Konteksti social i statusit shëndetësor të romëve

Relativisht është pranuar ideja në kontekstet e ndryshme nacionale se statusi i keq shëndetësor të popullata rome bazohet në mungesën e edukimit shëndetësor, gjegjësisht në sjelljen joadekuate shëndetësore të romët. Por, që të mund të kuptohen shkaqet për gjendjen e vështirë shëndetësore dhe statusin jo të barabartë shëndetësor të kësaj bashkësie etnike lidhu me popullatën e përgjithshme,

duhet të shqyrtohen edhe të kuptohen pabarazitë lidhur me strukturat ekzistuese politike dhe ekonomike, të cilat kontribuojnë drejt distribuimit jo të barabartë të resurseve. Refuzimi që të ndryshohet situata *status quo* në mënyrë plotësuese e varfëron edhe ashtu njohjen e kufizuar të situatave nga ana e politikanëve, bartësve të vendimeve dhe krijuesve të politikave, si dhe opinionin i gjerë, lidhur me fotografinë e përgjithshme sociale të faktorëve të cilët ndikojnë në shëndetin e të gjithëve, duke përfshirë edhe romët. Kjo paraqet pothuaj karakteristikë kryesore të përgjigjes zyrtare drejt çështjes së shëndetit të pakicave në botën e zhvilluar.

Në mënyrë plotësuese, problemi thellohet me sfida të caktuara të cilat janë specifike për kontekstet nacional në Evropën Qendrore dhe Lindore, si për shembull: (1) Shkathtësi të pamjaftueshme të zhvilluara për avokim në kuadër të shoqërisë civile – kjo veçanërisht ka të bëjë me avokimin për përmirësimin e shëndetit, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për organizata rome ose jo rome, gjatë së cilës koncepti për shëndetin si prodhim social, e jo vetëm mungesë e sëmundjes ose kujdesit mjekësor akoma është në margjinat pa potencial të dukshëm për popullarizim të afërt. Gjithashtu, numri i shoqërimeve ose rrjetëzimeve mes organizatave rome, ndërsa akoma më i vogël është mes subjekteve rome dhe jo rome; që përndryshe do të ndihmonte për prezantimin më të lehtë të vizionit të ri, alternativ për shëndetin; (2) çështja e përkatësisë etnike dhe frika nga represioni – statusi i pazgjidhur qytetare dhe mospasja e dokumenteve personale, akoma është një pengesë në qasjen e romëve deri te sistemi shëndetësor; gjegjësisht deri te njëri nga mekanizmat për përmirësimin e statusit shëndetësor; megjithatë edhe përpjekjet për evidentimin amë hasin në kuptim të ndryshim nga ana e bashkësisë rome, për shkak të frikës hyrja në sistemet nacionale të evidencës hap mundësi për represion; dhe (3) hapësira joadekuate publike drejt problemeve shëndetësore të pakicave dhe grupeve të marginalizuara – kjo llogaritet për një nga shkaqet kryesuese për statusin e keq shëndetësor të popullatës rome, dhe në masë të madhe shihet në mungesën e vullnetit politik dhe mbështetjes publike për miratimin dhe zbatimin e politikave të nevojshme dhe ndryshimeve të infrastrukturës, si dhe në miratimin e politikave të cilat në mënyrë diskrete, por të drejtpërdrejtë pse jo proporcionale më shumë do ta prekë popullatën rome, në këtë mënyrë duke e diskriminuar, si për shembull sigurimin shëndetësor vetëm për tre fëmijë në familje etj. Por, kjo flet edhe për atë se sa pak popullatë rome ka kontakt me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në krijimin, miratimin dhe zbatimin e politikave në vendet ku romët paraqesin pakicë të rëndësishme.

a) Kultura dhe tradita si faktor në statusin shëndetësor të romëve

Në mënyrë plotësuese të variablave socio-ekonomike, te shumë bashkësi ekzistojnë faktorë të ndryshëm kulturor, shprehi dhe zakone, të cilat kanë ndikim mbi shëndetin e individëve ose bashkësisë. Sëmundja nuk shihet në mënyrën e njëjtë në bashkësi të ndryshme ose në një shoqëri dhe ndryshon në kohëra të ndryshme historike në një grup të njëjtë. Shëndeti dhe sëmundja janë konstrukte sociale të cilat janë të definuara në çdo kulturë. Çdo kulturë krijon alternativa dhe udhëzime të veta terapeutike për tu shëruar. Për këtë shkak është e rëndësishme që sëmundja të shihet si shprehje e komponentit biologjik dhe kulturor. Nëse e marrim parasysh kulturën në procesin e shëndetit/sëmundjes te pakicat etnike, atëherë mund të shihet: si pacientët i pranojnë informatat për shëndetin, si përdoren të drejtat dhe beneficionet që i ofron sistemi shëndetësor dhe si shprehen simptomat, pritjet dhe brengosja rreth sëmundjes.

b) Rreziqet shëndetësore mes romëve

Aspekte të caktuara të kulturës rome ndonjëherë e rrisin rrezikun për sëmundje të caktuara. Për shembull, besimi në pastrimin dhe ritualet rreth të njëjtës kontribuon për rezistencë të imunizimit fëmijëror dhe të rriturit. Izolimi social mund të shkojë deri në ekstreme të tilla (refuzimi të regjistrohesh foshnjat) që trende të dukshme rreth mortalitetit mbeten të fshehura. Izolimi gjithashtu rezulton në pjesëmarrjen e vogël në pasqyrat preventive (për shembull, kontrollet gjinekologjike të cilat janë vështirë të promovohen mes grave rome).

E rëndësishme për Maqedoninë është të theksohet se nuk ekziston hulumtim me të cilin kontrollohet ose vërtetohet nëse në bashkësitë rome në vend janë ruajtur aspektet e kulturës të cilat i ekspozojnë romët në rrezik më të madh për shkak të intervenimeve jo në kohë mjekësore ose në cilën do mënyrë vështirësimin e procedurave të rregullta ose në kohë mjekësore. Përkundër kësaj, jemi dëshmitarë të publikimeve të shumta të cilat me qasje dhe informim anecdote paraqesin se mentaliteti, kultura dhe tradita e romëve në Maqedoni nuk lejon të ngrihet niveli i kujdesit mjekësor, parandalimi ose përmirësimi i gjendjes së përgjithshme shëndetësore në bashkësi.

Krahas gjendjes së pavolitshme në të cilën gjendet sistemi shëndetësor në Maqedoni, mbi statusin shëndetësor të romëve ndikojnë edhe kushtet e pavolitshme të jetës, strehimi joadekuat dhe higjiena ekstreme e keqe në lagjet rome. Statistika nacionale tregon përhapje më e madhe të sëmundjeve ngjitëse

te popullata rome në krahasim me popullatën e përgjithshme, edhe pse pothuaj paraqitja endemike e sëmundjeve të caktuara, për shembull tuberkulozi; të gjithë indikatorët tjerë shëndetësor janë me vlera më të këqija dhe me mundësi të pavolitshme për përmirësim të shpejtë.

Ekziston shkallë e dukshme e raportit diskriminues në kuadër të sistemit shëndetësor, i cili jo gjithnjë në mënyrë të drejtpërdrejt është i drejtuar nga popullata rome, por më shumë paraqet diskriminim të motivuar financiarisht (ai i cili mund të paguajë ka qasje deri te çdo shërbim shëndetësor, qoftë në segmentin privat ose publik të sistemit shëndetësor). Megjithatë, ekzistojnë dëshmi nga romët se punëtorët shëndetësorë i trajtojnë pacientët romë më keq se ata që nuk janë romë si rezultat i diskriminimit.

Nga ajo që u tha më lartë, ndjenja e diskriminimit te pjesëtarët e bashkësisë etnike rome në raport me popullatën jo rome është shumë e shprehur. Edhe pse, në pajtim me ligjet e shumta, në Maqedoni është i ndaluar diskriminimi mbi çfarëdo baze, pjesëtarët e bashkësisë rome në jetën reale nuk janë në mundësi ti realizojnë të gjitha të drejtat e tyre, sias ty vetëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

3.2. DISKRIMINIMI FETAR

Në periudhën nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë deri më sot, vërehet rritje etapore e involvimit të organizatave fetare në procesin politik. Kjo është rezultat i zgjerimit të praktikës fetare te popullata si rezultat i transformimit nga sistemi socialist, që e rritë kapitalin social të organizatave religjioze në jetën publike. Këto dy aspekte – kapitali religjioz dhe social të vetë institucioneve religjioze – lë hapësirë që të formohet mbrehje mes elitave politike dhe organizatave më me ndikim fetare. Mbrehja e tillë nënkupton mekanizma me të cilat establishmenti politik thith legjitimitet nga kapitali i këtyre organizatave, duke i involvuar në jetën politike.

Efekt plotësues kësaj gjendjeje i je shkalla e lartë e korrelacionit mes identifikimit etnik dhe përcaktimit fetar. Gjendja e këtillë është rezultat i trashëgimisë otomane ku identifikimi religjioz ka qenë parim themelor i kategorizimit të popullatës. Kështu, gjatë konstruimit të kombeve, organizatat fetare fitojnë vend të rëndësishëm në fotografinë e identitet nacional. Kështu në mënyrë

plotësuese e forcojnë pozitën e institucioneve religjioze në kohë të sotme. Një shembull i tillë është raporti i dy partive më të mëdha maqedonase që e kanë ndaj Kishës Ortodokse Maqedonase. Në dy dokumentet qendrore për këto parti, ata kanë vend qendror në rolin e ruajtjes së identitetit nacional maqedonas,¹⁹⁸ me çka haptazi e favorizon pra aktorëve tjerë në jetën publike.

Për çdo rast, fitimi i lirive fetare është një nga përfitimet e tranzicionit. Në praktikë, nuk vërehet kufizimi i të drejtës së mësimit fetar dhe praktikizmit të lirë të traditave fetare. Bile edhe në rastet kur është kontestuar regjistrimi i bashkësive të reja fetare (p.sh. POA ose Bashkësia bektashiane), nuk ka ndalesë për praktikizmin e zakoneve fetare të ithtarëve të këtyre grupeve religjioze.

3.2.1. Problematizimi i sekularitetit dhe favorizimi

Situata e këtillë, ku prijësit religjioz janë përfaqësuesit e vetëm të dukshëm të shoqërisë civile gjatë ngjarjeve më të rëndësishme politike, si inaugurimi i Kuvendit ose kreu shtetëror, jep fotografi që është më ndryshe nga sekulariteti i hartuar në shtet sipas Kushtetutës së Republikës. Gjatë kësaj favorizimi i tillë i institucioneve religjioze dhe shoqatat përkundër sekularitetit të rregulluar, lë hapësirë për veprim diskriminues të sektorit publik (para së gjithash institucionet shtetërore) ndaj pjesës së popullatës me ndërlidhje fetare ndaj bashkësive më të vogla religjioze ose ndaj popullatës ateiste.

Në kuptimin formal, ekziston hendek mes rregullativës e cila garanton barazi dhe pluralitet mes organizatave fetare,¹⁹⁹ dhe praktika që vijon. Kështu vend qendror me ndryshimet e Kushtetutës nga viti 2001 marrin KOM, BIM, Kisha Katolike, Bashkësia Ungjillore-Methodiste dhe Hebraike. Çekja e këtillë me emër vetëm e një pjese të bashkësive religjioze në Maqedoni (edhe pse ato janë ndoshta më të mëdhatë), por niveli simbolik tashmë formon një kornizë të caktuar të favorizimit. Edhe më shumë që ideja e vetë nenit në Kushtetutë nuk tregon nevojë nga përmendja të tillë. Vendosija e tillë atje rezulton me një sërë praktikash diskriminuese, me të cilat shumë shpesh prishet pse sekulariteti i punës publike të institucioneve ose e drejta e lirive të mësimit fetar të shoqatave të marginalizuara fetare.

¹⁹⁸ VMRO-Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas, 'Doktrina', 2007 <http://vmro-dpmne.org.mk/Dokumenti/Vrednosti_vmro_dpmne.pdf> [është qasu më 1 maj 2010]; Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë, 'Zgjidhje për Maqedoninë' <http://sds.org.mk/upload/PROGRAMA_PDF_Web.pdf> [është qasur më 1. tetor 2010].

¹⁹⁹ Për këtë u miratua Ligji për pozitën e drejt të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze. Gazeta zyrtare në RM nr. 113/07.

Në të vërtetë, në manifestimet e organizuara nga organet shtetërore, si për shembull fillimi i ndërtimit të objektit me interes publik (autostrada, ndërtesa të institucioneve shtetërore), shpesh pjesë e ceremonive është “shugurimi” i objektit nga persona zyrtar fetare, më shpesh nga KOM. Për Bashkësinë islame në Maqedoni, ky është diskriminim në bazë fetare, por në vend të mos ketë akt të tillë, ata mendojnë se edhe BIM duhet të jetë e ftuar dhe ta zbatojë të njëjtën sipas traditave myslimane. Nga ana tjetër, para do kohe BIM publikisht e mbështeti partinë e porsaformuar politike, e cila “për përgjigje” angazhohet për denacionalizimin e pronave të BIM.

3.2.2. Implementimi i mësimi fetar

Implementimi i lëndës “Mësim fetar” në arsimin fillor në vitin 2007 u prit si akt problematik i pushtetit, shikuar nga aspekti i karakterit laik dhe shumë-fetar i shoqërisë. Paqartësitë në ligjin për arsim, sipas disa analistëve, la hapësirë për krijim arbitrar të programit mësimdhënës me çka plotësisht e problematizoi gjendjen duke e pasur parasysh principin e paanshmërisë.²⁰⁰ Njëkohësisht, Qeveria me fushatë mediale e promovoi idenë për mësim fetar.

Për një pjesë të ekspertëve programet mësimdhënëse të propozuara, janë vlerësuar si “veprim fetar” sepse, sipas tyre, ata përbëhen nga mësim për praktikumin e vet religjionit.²⁰¹ Si dëshmi për këtë janë edhe një pjesë e shkrimeve të gazetarëve ku dokumentohet si mësimi i religjionit sjell deri te “stigmatizimi” i fëmijëve të religjioneve pakicë nëpër klasa.²⁰²

Shkurtë pas miratimit të këtij akti, Gjyqi Kushtetues, e abrogoi implementimin e mësimi fetar si kundër-kushtetues, sepse e cenon ndarjen e mësimi fetar nga religjioni.²⁰³ Me implementimin e mësimi fetar favorizohet popullata religjioze duke e lëshuar qasjen akademike shkencore në sistemin e arsimit shtetëror. Duhet cekur, gjithashtu, se edhe pse implementimi i mësimi fetar u kritikua nga opozita, kërkesa për rishqyrtimin e dispozitës ligjore para Gjyqit Kushtetues u dorëzua nga një parti më e vogël (Partia Liberal-demokrate) me çka dëshmohet ekziston partneritet mes partive më të mëdha dhe institucioneve fetare.

²⁰⁰ Kadriu, Bekim dhe Agim Nuhiu, ‘Diskriminimi në Republikën e Maqedonisë në vitin 2009 dhe 2010, f. 83

²⁰¹ Trajanovski, Zharko, ‘Mësim fetar apo veprim fetar?’, Zombifikim
<http://jasnesumjas.blog-spot.com/2008/09/blog-post_7101.html> [qasje më 1 tetor 2010].

²⁰² Todevska, Aneta, “Mësimi fetar i ndanë fëmijët”, Dnevnik (Shkup, shtator 2008)
<<http://www.dnevnik.com.mk/?itemID=6E8BC55B0BC1ED47B6D5D9A107A9ECE6>>

²⁰³ Gjyqi Kushtetues i RM. Vendimi Nr. 202/2008-0-1 miratuar më 15.04.2009

3.2.3. Ndërtimi i kishës në sheshin Maqedoni

Edhe një shembull për praktikë jo të mirë nga aspekti i diskriminimit fetar është vendimi të ndërtohet kisha “Sh. Konstantin dhe Elena” në sheshin “Maqedoni” në Shkup, si pjesë e projektit “Shkupi 2014”, e cila në opinionin u përjetua si përzierje e shtetit në ndërtimin e objekteve fetare. Pasi që nuk bëhet fjalë për projekt për restaurim apo konservim të trashëgimisë kulturore, iniciativa për ndërtimin e kishës në sheshin e Shkupit, nga aspekti i dialogut fetar, e problematizoi rolin e institucioneve shtetërore por edhe të pushtetit lokal. Kështu, paratë publike të qytetarëve duhej të përdoren vetëm për një grup fetar duke mos i marrë parasysh llojllojshmërinë e popullatës në komunën Qendër dhe në Shkup. Akoma më shumë që kisha ishte e kontekstualizuar në kuadër të projektit “Shkupi 2014” si objekt reprezentativ i identitetit nacional. Qasja e tillë pasqyron hierarkizimin e popullatës sipas përcaktimit të tyre fetar, gjegjësisht në këtë rast i përfaqëson krishterët ortodoks si pasqyre “më e reale” për popullin për dallim nga të tjerët. Kjo situatë e nisi iniciativën për ndërtimin e Burmalit Xhamisë, si orvatje që bashkësia islame të paraqitet si pjesë e shoqërisë në kuadër të ndërtimit të hapësirës “Shkupi 2014”.

Ngjashëm, në komunat ku shumicë janë shqiptarët etnik (por edhe në Shuto Orizare) vërehet ndërtim më intensiv i objekteve fetare myslimane, me përkrahje të hapur dhe publike nga përfaqësuesit e pushteteve komunale. Edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve financimi i ndërtimeve është nga burime private, ndikim dhe pjesëmarrje të pjesërishme ka edhe administrata komunale në ndarjen e tokës shtetërore si lokacion për ndërtim (sh. Komuna e Strugës, komuna e Çairit për Arasta xhaminë, komuna e Gostivarit në vendin e ish tregut të gjelbër) apo edhe ko-financim të objekteve fetare (sh. Komuna Shuto Orizare).

Në rastet kur institucionet publike marrin pjesë në ndërtimin e objekteve fetare, objekt më i shpeshtë i diskriminimit është popullata ateiste, paratë e së cilës përdoren për qëllime fetare. Njëkohësisht, ata institucione publike nuk i përfaqësojnë interesat e tyre, edhe pse kanë obligim të jenë aktorë të pavarur laik.

3.3. DISKRIMINIM I SHUMËFISHTË

Diskriminimi i shumëfishtë paraqitet në raste kur përfaqësuesit e një grupe (për shembull etnike), janë goditur edhe nga ndonjë tjetër aspekt i diskriminimit. Kjo formë më e rëndë e diskriminimit ndikon në izolimin më të madh dhe marginalizimin e përfaqësuesve të këtyre grupeve.

Në Maqedoni, diskriminimi i shumëfishtë i godet në veçanti përfaqësuesit e bashkësive më të vogla etnike, siç janë ajo shqiptare, turke, rome, etj. Kështu, gratë e këtyre bashkësive etnike, pos diskriminimit etnik janë edhe viktima të diskriminimit gjinor. Vetë si shembull, në fushën e marrëdhënieve të punës dhe arsimit, duke e pasur parasysh ekzistimin e pengesave kulturore dhe fetare, gratë e këtyre bashkësive etnike “nuk kanë pasur mundësi të barabartë për punësim dhe arsimim”.²⁰⁴

Diskriminimi i shumëfishtë përfaqësuesit e bashkësive më të vogla etnike i godit edhe nga aspekti i përkatësisë politike. Në fakt, edhe pse numri i të punësuarve në administratën publike nga bashkësitë më të vogla etnike rritet, shihet se bashkësitë etnike proporcionalisht më të vogla, siç janë ajo turke dhe rome, janë më pak të përfaqësuar.²⁰⁵ Kjo mundet të jetë rezultat edhe i përfaqësimit të tyre politik më të vogël në organet e pushtetit. Për këtë shkak, Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ka shpallur konkurs për punësimin e 250 pjesëtarëve të bashkësive etnike më të vogla.

3.4. PËRJASHTIME NGA NDALESA PËR DISKRIMINIM

Secili legjislacion parasheh përjashtime nga diskriminimi. Përjashtimet nga diskriminimi i përfshinë ato trajtime të pabarabarta dhe veprime, të cilat sipas ligjdhënësit dhe për shkak të ekzistimit të ndonjë qëllimi legjitim, nuk merren parasysh dhe përjashtohen nga mundësia për tu trajtuar si diskriminim. Kur flasim për diskriminim etnik, përjashtim bazik nga diskriminimi janë të ashtuquajturat masa afirmative. Këto masa ndërmerren me qëllim që të arrihet barazi reale në praktikizmin e lirive dhe të drejtave të pjesëtarëve të grupeve etnike të cilët në momentin e dhënë nuk janë në pozicion të tillë (më shpesh për shkak të diskriminimit në të kaluarën).²⁰⁶ Një masë të tillë është edhe rritja e numrit të punësuarve në administratën publike të pjesëtarëve të grupeve etnike apo rritja e numrit të pjesëtarëve të këtyre grupeve etnike në arsim. Po këto masa ndërmerren në Republikën e Maqedonisë, kurse baza juridike e këtyre masave është në Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.²⁰⁷ Megjithatë, duhet të kihet parasysh që ata të ndalen me zbatim kur do të arrihet baraspeshë e kënaqshme në përfaqësimin e drejtë, sepse bëhet fjalë

²⁰⁴ State Departamenti Amerikan, Raporti vjetor për RM për respektimin e lirive dhe të drejtave për vitin 2009 <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136044.htm>.

²⁰⁵ Komisioni i bashkësive evropiane, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i Progresit, Bruksel, 14.10.2009, f. 21. Raporti ndodhet në ueb faqen http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/mk_rapport_2009_en.pdf.

²⁰⁶ ZSZD, i cituar më lartë në fusnotë 7, neni 13.

²⁰⁷ Ibid., neni 15, pika 9.

për veprim jo të barabartë (në disa vende, si për shembull Britaninë e Madhe ato janë ilegale, sepse mendohet se pamarre parasysh diskriminimin eventual paraprak, nuk duhet të bëhet baraspeshë me diskriminim të ri, por me eliminimin e diskriminim ekzistues dhe balancim gradual vetëm në bazë të kompetencave).

Pos masave afirmative, si përjashtim nga diskriminimi etnik janë edhe masat të cilat ndërmerren për mbrojtjen e veçantisë së identitetit të bashkësive etnike.²⁰⁸ Kësi lloj masash në Maqedoni janë parapa në më shumë fusha, siç është përdorimi i gjuhës së bashkësisë etnike në sferën private dhe publike, përdorimi i simboleve të bashkësive, mbrojtja e vlerave kulturore nëpërmjet themelimit të institucioneve kulturore dhe arsimore, etj. Këto masa nuk mendohet të jenë diskriminuese, por gjithnjë janë problematike duke e pasur parasysh ekzistimin e numrit më të madh të bashkësive etnike situatat e të cilave dallojnë. Për këtë shkak, gjetja e baraspeshës së mirë është sfidë për çdo qeveri.

Përjashtim nga diskriminimi paraqet edhe realizimi i së drejtës së shprehjes, e cila shprehje mundet të prek në ndjenjat e një bashkësie të caktuar etnike. Megjithatë, sipas standardeve ndërkombëtare, liria e shprehjes nuk është absolute dhe kufizohet po në pjesën e ndalimit të fjalës së urrejtjes apo inicimit të diskriminimit. Për fat të keq, ZSZD këtë përjashtim e parasheh si absolut.²⁰⁹

Pos këtyre dy përjashtimeve, që janë të rëndësishme për diskriminimin etnik, ka edhe numër të madh përjashtimesh tjera nga diskriminimi të cilat kanë të bëjnë në forma tjera por nuk do të analizohen këtu.

3.5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

- 3.1. Nxënësit romë në arsimin fillor nuk ndjekin mësim në gjuhën e tyre amtare. Pos ndjekjes së mësimin në gjuhën jo-amtare, shpesh herë nxënësit rom janë të diskriminuar dhe ka ndarje. Diskriminimi i romëve ekziston edhe në fusha tjera, siç është qasja deri te të mirat dhe shërbimet, shëndetësi, punësim.
- 3.2. Liria e fesë garantohet me sistemin tonë juridik. Njerëzit janë të lirë ta praktikojnë dhe manifestojnë religjionin e tyre, privatisht apo publikisht. Megjithatë, ekziston përshtypja se shteti nëpërmes formave të ndryshme i favorizon religjionet shumicë (ortodokse dhe myslimane), si gjatë ndërtimit

²⁰⁸ Ibid., neni 15, pika 8.

²⁰⁹ Ibid., neni 14, pika 7. Për analizë më të hollësishme shih Doracakun për institucione për implementimin e Ligjit për ndalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, (autorë Tanja Temelkovska Milenkoviq dhe Bekim Kadriu, 2010).

apo restaurimit të objekteve fetare, mos regjistrimit të bashkësive më të vogla fetare apo zbatimit të mësimit fetar.

- 3.3. Përveç për shkak të përkatësisë etnike, kategori e caktuar e personave janë goditur edhe në baza tjera dhe atëherë kemi konceptin e diskriminimit të shumëfishtë. Kështu, romët janë goditë jo vetëm si pjesëtarë të grupit etnik, por edhe për shkak të statusit të tyre shoqëror gjegjësisht përjashimit social. Gjithashtu, te gratë e bashkësive më të vogla etnike paraqiten raste të diskriminimit edhe për shkak të gjinisë së tyre.
- 3.4. Republika e Maqedonisë me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese ka pranuar zbatimin e masave afirmative për arritjen e barazisë faktike të bashkësive etnike (duke e përfshirë përfaqësimin e drejtë në administratën shtetërore). Kjo në sistemin tonë është përjashtim nga diskriminimi dhe si e tillë duhet të zbatohet deri në momentin e arritjes së baraspeshave adekuate.

Rekomandime

- 3.1. Për zgjidhjen e problemit me diskriminimin e romëve, duhet të ndërmerret një qasje komplekse e jo parciale. Sa i përket mësimit në gjuhën amtare duhet të hapet katedër për gjuhë rome prej ku do të dalin kuadrot për mësime në gjuhën rome, të botohen libra për arsim fillestar dhe duhet të trajnohet kuadri mësimdhënës me qëllim që të arrihet qasje më intensive ndaj nxënësve rom. Pos kësaj duhen masa më efektive të ndërmerren me qëllim përmirësimin e përfaqësimit të romëve në institucione, me çka do të ndikohet në reduktimin e të ashtuquajturit diskriminim sistemor ndaj tyre. Nga ana tjetër, duhet të trajnohen edhe kuadro të cilët kanë kontakt me qytetarët me qëllim të përmirësimit të sjelljes së tyre dhe trajtimit të çdo individit njësoj pa diskriminim.
- 3.2. Shteti duhet të jetë neutral ndaj bashkësive fetare. Gjegjësisht, duhet deri në maksimum të respektohet principi i laicizmit të shtetit dhe ndarja e shtetit nga institucionet fetare. Vetëm në këtë mënyrë shteti mundet të ketë qasje të njëjtë ndaj gjithë qytetarëve në Maqedoni.
- 3.3. Për diskriminimin e shumëfishtë duhet të ndërmerren hapa serioze për tu reduktuar dhe apo eliminuar. Për këtë dukuri zakonisht aplikohen të njëjtat forma për reduktim të diskriminimit, megjithatë qasja duhet të jetë më komplekse dhe duhet ti përfshinë gjitha aspektet e goditura. Në përgjithësi, përmirësimi i gjendjes në një pjesë ndikon pozitivisht edhe në përmirësimin e gjendjes në pjesët tjera.
- 3.4. Masat e ndërmarra si aksione afirmative, duhet të jenë të qarta dhe me qëllime qartë të definuara. Të njëjtat duhet të jenë efektive dhe në afat sa më të shkurtër ti eliminojnë shkaqet për diskriminim dhe disbalancin etnik e pastaj të ndërpriten.

4. PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME

Përfundime

- 4.1. Republika e Maqedonisë ka vendosur rregullore dhe mekanizëm adekuat për mbrojtjen nga diskriminimi, duke e kështu edhe diskriminimin në bazë etnike. Pos dispozitave kushtetuese në nenin 9, rregullimin me më shumë ligje (Ligji për marrëdhënie pune, etj), përcaktimin e diskriminimit si vepër penale (në Ligjin penal), përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, kjo fushë u mbyllë me miratimin e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Formimi i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi duhet ta kompletonte edhe vendosjen institucionale.
- 4.2. Po ashtu, për çështjen e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjegjësisht marrëdhënieve ndëretnike në tërësi, Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që dolën nga marrëveshja e përcaktojnë strategjinë e Republikës së Maqedonisë për zgjidhje të këtij problemi. Në dhjetëvjetorin e MKO-s, evidente janë arritjet për përfaqësim të drejtë të bashkësive etnike, si një nga komponentët më të rëndësishëm, si edhe sukseset nga implementimi i dispozitave tjera për zvogëlimin dhe eliminimin e këtij lloji të diskriminimi. Vlerësim i thelluar i implementimit të MKO-s duhet të jetë themeli për formulimin e hapave të ardhshme për mbrojtjen nga diskriminimi në periudhën në vijim.
- 4.3. Në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë, përveç MKO-s dhe përfaqësimi i drejtë, vetëdija për ekzistimin e diskriminimit është në nivel shumë të ulët. Gjegjësisht, diskriminimi nuk njihet nga ana e qytetarëve, por edhe në institucione nuk ekziston vetëdije e mjaftueshme për nevojën e trajtimit të barabartë apo për mbrojtjen nga diskriminimi. Për shembull pjesëtarët e policisë shpesh herë i trajtojnë më keq përdoruesit e drogës, punëtorë seksual apo romët. Gjithashtu edhe gjyqet janë shumë të kujdesshëm kur kanë raste të diskriminimit sepse hyjnë në zonë të panjohur.
- 4.4. Mosnjohja e konceptit të (mos)diskriminimit vërtetohet edhe me faktin që ekziston numër shumë i vogël i rasteve të paraqitura të diskriminimit. Në gjyqe nuk janë evidentuar raste individuale të diskriminimit (ka vetëm

disa iniciativa para Gjyqit Kushtetues për vlerësim të disa dispozitave ligjore të cilat mendohet të jenë diskriminuese), ndërsa te Avokati i Popullit në tre vitet e fundit janë paraqitur 47 raste të klasifikuar si diskriminim. Shpesh herë bazë është përkatësia etnike, kurse fusha më e shpeshtë – punësimi. Megjithatë, këto të dhëna duhet të merren me rezervë për shkak të disa problemeve: numër i vogël i rasteve në përgjithësi për shkak të statistikës adekuate; mos cekja e përkatësisë etnike gjatë dorëzimit të ankesave (vetëm 9 nga 47 rasteve); diskriminim i caktuar i vogël (9 nga 47 raste të zgjedhura, apo 24%).

- 4.5. Po ashtu, në gjitha fushat e jetës shoqërore, në përgjithësi nuk ekziston evidentim i mjaftueshëm për përkatësinë etnike të përdoruesve të përfitimeve të caktuara. Ky fakt e bënë të rëndë nxjerrjen e Përfundimeve relevante për (mos)ekzistimin e diskriminimit etnik. Nga ana tjetër, pamundësia e dëshmimit të ekzistimit të diskriminimit e bënë të rëndë edhe procesin e ndërmarrjes së masave për reduktimin dhe pengimin e së njëjtës. Pyetja është ku duhet të evidentohen ato të dhëna, duke i marrë parasysh dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për vetë-deklarim dhe mos-deklarim për përkatësinë e vetë etnike. Nëse kësaj ja shtojmë edhe Përfundimet paraprake të mosnjohjes së diskriminimit dhe mos paraqitjes së rasteve të diskriminimit, bëhet e qartë se i tërë problemi është i komplikuar dhe kërkon qasje sistematike të zgjedhjes së problemit.
- 4.6. Megjithatë, nga anketa e zbatuar, mundet të përfundohet se Maqedonia nuk ka diskriminim sistematik. Pos rregullores adekuate ligjore, praktika tregon se janë mundësuar mundësi të barabarta dhe qasje për pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike. Po ashtu, me konceptin e përkatësisë së drejtë është arritur nivel prej 25% punësime të bashkësive jo shumicë në administratën shtetërore. Në arsimimin elementar është siguruar mësim në gjuhën amtare për të gjitha bashkësitë etnike. Në bujqësi, 7 nga 10 bujq individual me subvencione më të larta janë nga bashkësitë jo-shumicë. Në sferën sociale, 70% e shfrytëzuesve nuk janë maqedonas etnik.
